Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 4 (96). PRILL 2014. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN

Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

OPINION

Vështrim gjeostrategjik i Rrugës së Arbërit

Nga **AZIS KETA** - FAQE 18

AKTUALITET

Projektet hidroenergjetike kundër natyrës

FAQE 22

OPINION

Ruaj Radikën, për të ruajtur qenien tënde

FAQE 22

NJOFTIM PËR LEXUESIT

Ky numër gazete i kushtohet Prof.dr. Nuri Abdiut, në nderim të punës së tij shkencore dhe intelektuale, si dhe përkushtimit të tij ndaj Dibrës dhe çështjeve që lidhen me të. Të gjitha shkrimet e përgatitura për t'u botuar këtë muaj, do të botohen në numrat në vijim. - *Redaksia.*

DIBRA, TIRANA, SHKODRA DHE PRISHTINA I JAPIN LAMTUMIRËN E FUNDIT MËSUESIT TË POPULLIT PROF.DR. NURI ABDIUT



Dhe lotin kthema, valë…

TIRANË, 29 prill 2014. Shiu që s'resht nuk pengon varganin e kortezhit që përcjell për në banesën e fundit Mësuesin e Popullit, profesor dr. Nuri Abdiun, që u nda nga jeta në të zbardhur të ditës së 27 prillit. Dibra ka zbritur në kryeqytet dhe, bashkë me qindra bashkëkrahinarë të tyre që jetojnë në Tiranë, i prinë ritualit mortor. Nga Shkodra, ku i ndjeri punoi me përkushtim më shumë se 30 vjet në auditorët e Institutit të Lartë Pedagogjik dhe, më pas, të Universitetit "Luigj Gurakuqi" me një kontribut të shquar në përgatitjen e mësuesëve, që, përveç Shkodrës, vinin nga tërë rajoni verilindor, por edhe nga qytetet tjera deri nga Vlora e Saranda.Mes tyre janë edhe ish-studentë, tani profesorë e doktorë shkencash, që vijojnë misionin e nderit të arsimit të lartë. Është dyndur Tirana në këtë ceremoni funebre, prirë nga rektorati i Albanian University, ku profesori i nderuar derisa mbylli sytë dha mësim e drejtoi Departamentin e Psikologjisë.Në kortezh janë bashkuar edhe nga Prishtina, Prizreni, Gjakova e Zhuri i Shtjefen Gjeçovit.Akademinë e Shkencave të Kosovës e përfaqëson, zëvendëskryetari i atij institutcioni të lartë shkencor, akademiku Pajazit Nushi; ndërsa Universitetin e Prishtinës, një nga pedagogët veteranë, professor dr. Agim Vinca. Fjalen e lamtumirës e mbajti profesor dr. Pavli Kongo, Rektor i Albanian University; ndërsa si përfaqësues i qarqeve intelektuale dhe akademike të Prishtinë, foli profesor dr. Agim Vinca.

Tek shkruaj këtë kronikë, më sillën në kujtesë disa vargje të poeteshës Alma Zenellari, kushtuar pedagogut të saj, profesor Nuriut:

"Ma merr k'të brengë merrma me vete
Në mundesh, merrma ankthin tim
Ti thinjë përndritur e gojëembël,
I urt' (si) ati im
…Dhe lotin kthema, valë…".

Korresp. "Rruga e Arbërit"

Speciale në faqet 2-17

Ikja e mikut

cyan magenta yellow black 1

Rruga e Arbërit nr. 96

Lamtumirë, koleg i nderuar, Profesor Nuriu!

Fjala e Prof. dr. Pavli Kongo, Rektor i Albanian University, mbajtur në ceremoninë mortore të Profesor Nuri Abdiut

Me ndjenjë të thellë dhimbjeje, po aq respekti, konsiderate e vlerësimi, përcjellim sot në banesën e fundit, kolegun, bashkëpunëtorin, një nga themeluesit e Albanian University, Profesor dr. Nuri Abdiun.

I shquar dhe i nderuar ka qenë dhe mbetet në kujtesën tone Profesor Nuriu, ashtu dhe kolegëve tanë të Universitetit të Shkodrës, ku, për më shumë se 30 vjet pandërprerë, lexoi leksionet e psikologjisë së përgjithshme, duke qenë një nga drejtuesit kryesorë, qëkur ishte Institut i Lartë Pedagogjik. I paharrur në kohëra do të mbetet profesor Nuriu për kolegët dhe ish- studentët e tij në Universitetin e Tiranës, për ata të Fakultetit Pedagogjik e Filologjik të Universitetit të Tetovës, pasi, siç është vlerësuar nga kolegët, ai ka qenë "Mësues i mijëra mësuesve dhe i disa profesorëve në fushën e psikologjisë e të pedagogjisë".

Nga muaji shkurt 2006 deri në fund të vitit akademik 2011-2012, Profesor Nuriu punoi me përkushtim: pedagog, drejtues i Departamentit të Psikologjisë dhe zv. dekan i Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Albanian University.

Ky bir i denjë i fisit të Abdive, me rrënjë e degë rrëzë Korabit, djali i parë i burrit të zgjuar Aziz Abdia, lindi më 1 shkurt të vitit 1930. Që në vitet e para të shkollimit u dallua për dëshirë, vullnet e këmbëngulje për dituri, çka e dëshmoi në shkollën pedagogjike të Peshkopisë dhe në Institutin Pedagogjik Shtetëror të Moskës, ku kreu studimet e larta, duke u diplomuar për psikologji-pedagogji me vlerësimin "Shkëlqyeshëm"! Në udhët e diturisë vazhdoi suksesshëm dhe meritoi tituj, grada e urdhëra: "Docent", "Doktor i shkencave", Profesor", "Mësues i Merituar" dhe "Mësues i Popullit".

Profesor Nuriu nuk ishte vetëm një nga mjeshtërat e ligjërimit akademik në auditor, por edhe studiues, kërkues shkencor në fushën e psikologjisë dhe të pedagogjisë. Me veprën "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar", botuar më 2002, vlerësohet si pararendës në studimet psikologjike, duke vijuar me monografi, tekste mësimore e botime të tjera. Në fondin e tij studimor përfshihën më shumë se 150 artikuj e dhjetëra kumtesa, mbajtur në sesionet e konferencat shkencore, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Vepra e tij është shtrirë dhe është vlerësuar edhe në strukturat shkencore edhe si nënkryetar i Shoqatës Mbarëkombëtare të Psikologëve Shqiptarë,

Duke i dhënë lamtumirën e fundit në emër të Rektoratit dhe Senatit të Albanian University u shprehim ngushëllimet tona familjes Abdiu, bashkëshortes, vajzave, vllezërve dhe motrave, miqve e dashamirëve të shumtë të ti; Dibrës dhe dibranëve për birin e tyre që i nderoi, veçanërisht Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, që professor Nuriu drejtoi me dituri, urti dhe dinjitet! Ata janë dhe do të jenë krenarë për njeriun e tyre të dashur që, me veprën dhe përkushtimin, gjatë një jetë e tërë në shërbim të çështjes së madhe, arsimit kombëtar, tanimë është renditur në plejadën e intelektualëve që vunë gurthemeli në atë godinë, vatër e diturisë, kulturës dhe e qytetërimit..

I përjetshëm qoftë kujtimi dhe nderimi i Profesor Nuriut!



NEKROLOGJI

Më 27 prill të vitit 2014 pas një sëmundje të rëndë u nda nga jeta "Mësuesi i Popullit", Profesori dhe Doktori i Shkencave Psikologjike, nënkryetari i Shoqatës Mbarëkombëtare të Psikologëve, Kryetari i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" Profesor Nuri Abdiu.

Ai lindi në 1 shkurt të vitit 1930 në fshatin Sohodoll të Dibrës, në një familje të thjeshtë me tradita patriotike. Arsimin fillor, 7 vjeçar e të mesëm e kreu në vendlindje, Kastriot e Peshkopi, ndërsa arsimin e lartë në Institutin Pedagogjik Shtetëror të Moskës, në specialitetin Pedagogji-Psikologji në vitin 1958, ku mori diplomën Shkëlqyeshëm dhe kualifikimin "Pedagog i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë për shkollat pedagogjike, inspektor-metodist për shkollat fillore";

Ai mbart mbi shpatulla një aktivitet të madh në fushën profesionale, pa hequr dorë asnjëherë nga mësimdhënia, të cilën e ka filluar që kur studionte në ish Bashkimin Sovjetik, ku bënte punën e pedagogut të gjuhës shqipe në kurset e gjuhëve të huaja të MP të Jashtme të ish BS.

Sapo u kthye në atdhe, ai u emërua: Pedagog i Psikologjisë dhe i Pedagogjisë në Institutin Pedagogjik Shkodër (1958- 1962), Zv.Drejtor për anën mësimore dhe shkencore dhe përgjegjës i komisionit Psikologji – Pedagogji në Institutin e Lartë Pedagogjik Shkodër (1963-1974);

Në vitin 1973, Komisioni i Lartë i Atestimit Shkencor pranë K.M. i ka dhënë titullin "Docent";

Zv.Drejtor i shkollës së mesme pedagogjike "Shejnaze Juka" Shkodër (1974-1977); Pedagog i Psikologjisë në Institutin e Lartë Pedagogjik, Shkodër (1977-1980); Shef i Katedrës së Psikologji - Pedagogjisë në Institutin e Lartë Pedagogjik Shkodër dhe i degës së Mësuesisë për Ciklin e Ulët (1981-1990). Gjatë kësaj periudhe zhvilloi edhe një cikël leksionesh mbi historinë e mendimit psikologjik shqiptar në kursin njëvjeçar pasuniversitar për psikologji-pedagogji në Universitetin e Tiranës (1982-1988).

Në periudhën 1991-1993 ka punuar Pedagog i Psikologjisë në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër; dhe në shkurt 1993 del në pension.

Në vitin 1991 fiton gradën shkencore "Doktori Shkencave" dhe në vitin 1999 Komisioni i Kualifikimit Shkencor pranë KM, i ka dhënë titullin shkencor "Profesor".

Por ai nuk e pushon aktivitetin e tij mësimdhënës dhe kontributin në fushën e kërkimit, ku zhvillon leksionet e psikologjisë së përgjithshme në Fakultetin Pedagogjik dhe Filologjik të Universitetit të Tetovës (1996-2005) dhe më pas vazhdon të mbajë leksione të psikologjisë së përgjithshme në Universitetin e Tiranës.

Profesor Nuriu angazhohet si Drejtues i Departamentit të Psikologjisë në Universitetin jo publik Albanian University në periudhën gusht 2006–shkurt 2012.

Në mars 2012 deri në fund të vitit akademik 2011-2012 punon si Zv. Dekan për anën shkencore i Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Albanain University.

Ai ka një kontribut të shquar në fushën e botimeve psikologjike e pedagogjike, si: studimi "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar" (gjer më 1939), botuar më 2002 dhe ribotuar më

Profesor Nuri Abdiu bën pjesë në atë plejadë intelektualësh që vunë gurthemeli në arsimin kombëtar dhe luftuan pa ndërprerë për ta përsosur atë, duke kontribuar mbi 50 vjet si pedagog e drejtues, një jetë e tërë në shërbim të çështjes së madhe të arsimit kombëtar.

2010, i cili përbën një kontribut të veçantë në përgjithësimin e përvojës sonë kombëtare në fushën e mendimit psikologjik shqiptar. Më 2007 botoi monografinë "Psikologjia" e Hasan Tahsinit; "Bibliografia e punimeve shqiptare në lëmin e psikologjisë", është botuar më 1986 dhe ribotuar më 2011. Është autor edhe i disa monografive me përmasa më të vogla, të botuara në revista e përmbledhje shkencore. Lista e punimeve shkencore, studimeve, kumtimeve shkencore dhe artikujve arrin në mbi 170 zëra. Shumë prej tyre janë botuar në organe shkencore dhe mbajtur në sesione të ndryshme shkencore, lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, si në Kongresin VI Europian të Psikologjisë (Romë 1999), në Prishtinë, Gjakovë, etj. Është bashkautor në 7 tekste të psikologjisë, 4 për shkollat e larta, 1 për kursin pasuniversitar dhe 2 për shkollat e mesme pedagogjike;

Profesor Nuriu ka qenë anëtar i një numri të konsiderueshëm shoqatash profesionale, këshillash dhe bordesh, me të drejta vendimmarrjeje, që nga vitet e para të aktivitetit të tij. Për gjithë kontributine tij të vyer në fushën e arsimit shqiptar emri i Prof. Nuri Abdiut është një zë i veçantë në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë - 2008). Ai ka pasur statusin e këshilltarit botues në revistën shkencore "European Psychologist".

Në maj të vitit 2006 në krye të një grupi intelektualësh dibranë themeloi Shoqatën "Lidhja e Intelektualëve Dibranë", ku zgjidhet edhe kryetari i saj, i cili do të mbahet mend si kryetari model dhe i përkushtuar deri në momentet e fundit të jetës së tij.

Profesor Nuri Abdiu bën pjesë në atë plejadë intelektualësh që vunë gurthemeli në arsimin kombëtar dhe luftuan pa ndërprerë për ta përsosur atë, duke kontribuar mbi 50 vjet si pedagog e drejtues, një jetë e tërë në shërbim të çështjes së madhe të arsimit kombëtar.

Shkodra dhe Instituti i Shkodrës (sot Universiteti Luigj Gurakuqi) janë vatra të arsimit kombëtar që mbushën Shqipërinë me mësues e mësuese dhe ku, pa dyshim, shquhet, qysh në krye të herës, si smerald, kontributi i padiskutueshëm dhe shumëdimensional i Profesor Nuri Abdiut.

Ai është nismëtari i studimit të historisë së mendimit psikologjik shqiptar, një nga studiuesit më të shquar shqiptar në fushën e psikologjisë, hartuesi i parë i bibliografisë së punimeve shqiptare në lëmin e psikologjisë.

Ai ka mbajtur edhe disa tituj nderi të akorduara nga Kuvendi Popullor si : "Medaljen e Punës", të akorduar më 1968; Urdhërin "Naim Frashëri" të Klasit të I-rë , në vitin 1980; titullin "Mësuesi Merituar", në vitin 1987; dhe titullin "Mësuesi Popullit", akorduar më 1989.

Me ndarjen nga jeta të Profesor Nuri Abdiut, familja dhe miqtë humbën njeriun e tyre më të shtrenjtë, kolegët humbën shokun e tyre të dashur dhe psikologun më të shquar, studentët profesorin e tyre më të nderuar dhe Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" kryetarin e saj model e të përkushtuar. Kujtimi dhe vepra e Profesor Nuri Abdiut do të mbetet e paharruar në jetë të jetëve.

Kryesia e Shoqatës
"Lidhja e Intelektualëve Dibranë"
Tiranë më, 29.04.2014



Prof. dr. Nuri Abdiu vlerësohet si hartuesi i parë i Bibliografisë së punimeve shqiptare në fushat e psikologjisë dhe si hartuesi i historikut të mendimit psikologjik shqiptar që nga vitin '39.

"Prof. dr. Nuri Abdiu është një nga studiuesit më të shquar shqiptarë në fushën e psikologjisë…. "

"Nuri Abdiu, kalorësi i psikologjisë"

Akademik *BEDRI DEDJA*

"Ndiej krenari që në gjirin e popullit shqiptar lindi dhe arriti të afirmohet një studiues i zhvillimit të mendimit psikologjik shqiptar dhe bukurisë zhvillimore të botës shqiptare. Duke përkujtuar dhe nderuar 80-vjetorin e jetës dhe aktivitetit tuaj, ne nderojmë atë personalitet që bëri shumë për mendimin psikologjik dhe zhvillimin e tij por edhe si pedagog universitar i psikologjisë, që keni vënë bazat e këtij mendimi në mësimet e larta të universiteteve shqipfolëse të viteve të gjysmës së dytë të shekullit njëzet, duke u bërë nismëtar i studimit të historisë së mendimit psikologjik shqiptar".

Prof. PAJAZIT NUSHI, zv. kryetari i Akademisë së Shkencave të Kosovës

"Prof. Nuri Abdiu ka qenë dhe mbetet një nga personalitetet e fushës së psikologjisë dhe pedagogjisë, bashkëkohës dhe bashkëpunëtor i akademikëve e profesorëve të shquar Hamit Beqja e Bedri Dedja."

Prof. HAMIT BORIÇI

"Mësues i mijëra mësuesve dhe pse jo edhe i disa dhjetëra profesorëve. Serioziteti në punën hulumtuese, kërkimore e shkencore, as i nxituar, as i vonuar, duke zbatuar një metodologji shkencore në hulumtimet e traditës dhe problemeve psikologjike aktuale, e ka bërë që produktet shkencore të përfunduara t'i pasqyrojë në brendinë e leksioneve dhe seminareve që drejton, me theks bashkëkohor krijues, të cilat vërehen edhe në veprat që ka publikuar vitet e fundit..."

Prof. MUSA KRAJA

Nën drejtimin e LID, ai kishte dy pengje: E para, donte që shoqata të shndërrohej në një frymëzuese të bashkëpunimit sa më të gjerë të dibranëve, kudo që ndodheshin. Ishte i ndërgjegjshëm për dasitë politike në komunitetin Dibran, por kjo nuk duhet të na pengojë të bashkohemi në veprimtari të përbashkëta, ta duam dhe ta respektojmë njëri-tjetrin, ta vlerësojmë punën dhe kontributin e gjithsecilit, jo vetëm për të mirën e Dibrës, por për gjithë vendin.
Së dyti, ai kishte peng çështjen e Rrugës së Arbërit. Pyeste vazhdimisht. Interesohej edhe në telefon. Kur dëgjonte ndonjë lajm në televizor apo në gazeta, na thërriste për kafe dhe kërkonte ta pleqëronim këtë punë. "Ajo rrugë nuk ka filluar akoma, thoshte, dhe për sa kohë ne mund të kontribuojmë të rregullohet më mirë, nuk duhet të kursehemi". Dhe, disa javë para se të largohej nga ne, nënshkroi një letër që iu drejtua qeverisë shqiptare, me shqetësimin e përmirësimit të projektit".

Deri në frymën e fundit profesori ishte në mes dhe në krye të komunitetit dibran, me ne të gjitha pa dallim, nga intelektualët, studentët, mësuesit, të ardhurit nga qyteti e Malësitë e Dibrës, dhe kudo ku ai ishte përhapte frymë paqtimi e të harmonisë, ishte njëlloj indi lidhës që bashkonte, një lloj limfe që lëvizte nëpër të gjithë qenien e komunitetin tonë, me veti shëruese, që freskonte e pastronte në gjakun tonë, çdo shenjë hatëri e qefmbetje, çdo nojmë mërzitje e qejfprishje. Me durimin, mençurinë, fjalën e ëmbël, nëpër të gjithë vallet e kuvendet, përhapte farën e paqes e të harmonisë.

Me të ndjerin Prof. Nuri Abdiu kuptoheshim edhe pa folur. Ndoshta rrënjët e përbashkëta, dibrane, ndoshta edukata familjare; e familjeve tradicionale ku çmohet fjala, nderi, bujaria, na bënin aq të afërt. Por edhe pikëpamjet për jetën, artin, shkencën. Fytyra e tij, fjala, gjesti rrezatonin dritë e mirësi. Ishte i tillë çfarë e kishte emrin, njeri plot Nur. Si dibran që ishte, e njihte mirë traditën popullore, doket, zakonet dhe ia dinte rendin fjalës e muhabetit. Si pedagog kishte takt, kujdes, respekt për njerëzit… Kishim edhe aq shumë fjalë për t'i thënë njëri-tjetrit. Dhe ja, tani, më duhet t'i them dy fjalë për Të, në mungesë të Tij, në këtë ditë me shi. Por, ajme, rrugë tjetër s'ka! E tillë është kjo botë. Herët a vonë, vjen një ditë që gjithçka mbyllet me fjalën: Lamtumirë!

Ikja e mikut



Profesor Nuri Abdiu, në mes, së bashku me anëtarë të kryesisë së Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, me të cilët, takohej më shpesh dhe bisedonte vazhdimisht për çështje dhe problematika që kishin të bënin me veprimtarinë e shoqatës. Në foto: nga e majta në ta djathtë: Hasan Çipuri, Musa Riçku, Shaban Bitri, Edlira Haxhiymeri, Nuri Abdiu, Demir Osmani, Bashkim Lleshi dhe Shpetim Cami.

Nderim mikut të dashur dhe pedagogut të shquar, Profesor Nuri Abdiut (1930-2014)

Nga **AGIM VINCA**

Lajmi për ndarjen nga jeta të Profesor Nuri Abdiut i pikëlloi të gjithë të njohurit, miqtë dhe kolegët e tij jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë e Maqedoni, në mbarë hapësirën shqiptare.

Erdhëm nga Prishtina në Tiranë, ne, miqtë e tij, për t'i dhënë lamtumirën e fundit dhe për t'i thënë dy fjalë miradije për Të, në emrin tonë dhe të gjithë atyre që e kanë njohur.

Për mua Nuri Abdiu ishte një nga njerëzit më të mirë që kam njohur në jetë. Një njeri dhe intelektual i vërtetë, që i kishte shokët të rrallë, si njeri dhe si shqiptar; fisnik dhe fshatar, modern dhe tradicional.

Rrugëtimi i tij në jetë filloi 84 vjet më parë, në Sohodollin lindor, më 1 shkurt 1930.

Në vitet '50 kreu studimet me sukses të shkëlqyeshëm në ish-Bashkimin Sovjetik, në Moskë (1954-1958). Ndërsa gradën shkencore "Doktor i Shkencave" e mori në Universitetin e Tiranës shumë vjet më vonë (1991).

Për merita të dalluara në fushën pedagogjiko-arsimore iu dha titulli i lartë "Mësues i Popullit".

Vite me radhë do të jepte kontributin e vet të çmueshëm arsimor dhe shkencor në Institutin Pedagogjik të Shkodrës (sot Universiteti "Luigj Gurakuqi"), duke qenë njëherësh edhe njëri nga drejtuesit e këtij institucioni.

Fushë e specializimit të tij ishte psikologjia dhe mendimi mbi të.

Mbajti leksione e ligjërata edhe në Universitetin e Tiranës, të Prishtinës dhe të Tetovës; dha kontribut të çmueshëm sidomos në konsolidimin e këtij të fundit (USHT), edhe pse ky kontribut nuk u vlerësua sa e si duhet nga drejtuesit e tij.

Në vitet e fundit të jetës punoi në një nga universitetet më prestigjioze private (jopublike) në Shqipëri, në Universitetin UFO (sot Albanian University), ku drejtonte Departamentin e Psikologjisë, ku dhe e mbylli karrierën e tij profesionale e shkencore.

Tërë jetën ia kushtoi shkollës, arsimit, shkencës, edukimit të gjeneratave të reja.

Profesor Nuri Abdiu ishte mësues, pedagog, studiues. Mbi të gjitha, ai ishte njeri me virtyte të rralla.

Karriera e tij është e gjatë dhe e pasur: një jetë në arsim, mes nxënësve, studentëve, kolegëve...

Autor i shumë artikujve shkencorë e pedagogjikë; i studimeve nga fusha e psikologjisë dhe e pedagogjisë, ndër të cilat vlen të përmenden posaçërisht libri bibliografik mbi studimet në fushën e psikologjisë, studimi gjithpërfshirës mbi historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri në vitin 1939) dhe monografia për Hoxhë Hasan Tahsinin.

Në Shkodër, në Tiranë, në Tetovë e gjetkë, kudo ku punoi e ligjëroi, la përshtypjet më të mira si njeri, si pedagog e studiues.

Prof. Nuri Abdiu është njeri që ka bërë shumë për zhvillimin e arsimit shqip, veçanërisht atij universitar, por kontributi i tij është po aq i madh edhe në avancimin e mendimit pedagogjik e psikologjik shqiptar.

Akademikët Bedri Dedja e Pajazit Nushi, specialistë të fushës, njëri në Tiranë e tjetri në Prishtinë, e kanë cilësuar: "një nga studiuesit më të shquar në fushën e psikologjisë" dhe "kontribues themelor i mendimit psikologjik", në teori dhe praktikë.

Takimi me të ishte jo vetëm përjetim, por edhe festë. Do të mbeten të paharruara ditët e kaluara në Strugë, ku Profesor Nuriut dhe bashkëshortes së tij, zonjës Fitnete, u pëlqente t'i kalonin, tok me miq e shokë, pushimet e verës.

Me orë të tëra kemi kuvenduar këndshëm në brigjet e Liqenit të Ohrit dhe të Drinit të Zi, rrjedha e të cilit të shpie në vendlindjen time dhe të tij, që ishte edhe vendlindja e të parëve të mi.

Me të ndjerin Prof. Nuri Abdiu kuptoheshim edhe pa folur. Ndoshta rrënjët e përbashkëta, dibrane, ndoshta edukata familjare; e familjeve tradicionale ku çmohet fjala, nderi, bujaria, na bënin aq të afërt. Por edhe pikëpamjet për jetën, artin, shkencën.

Fytyra e tij, fjala, gjesti rrezatonin dritë e mirësi. Ishte i tillë çfarë e kishte emrin, njeri plot Nur.

Si dibran që ishte, e njihte mirë traditën popullore, doket, zakonet dhe ia dinte rendin fjalës e muhabetit. Si pedagog kishte takt, kujdes, respekt për njerëzit...

S'ka as dy muaj që folëm bashkë në telefon. E mora nga Prishtina kur mora vesh se po i rëndohej gjendja shëndetësore. Por ai nuk dorëzohej. Nuk e jepte veten. Vetëm kur i thashë se verën që vjen do të shkojmë bashkë në Sohodoll, u emocionua dhe mezi e përmbajti mallëngjimin.

E ndjeva se iu mek zëri i tij i qartë, i ngrohtë e njerëzor, por as ndër mend nuk më shkonte se kjo do të ishte biseda jonë e fundit.

Kishim edhe aq shumë fjalë për t'i thënë njëri-tjetrit.

Dhe ja, tani, më duhet t'i them dy fjalë për Të, në mungesë të Tij, në këtë ditë me shi. Punë tmerrësisht e vështirë!

Por, ajme, rrugë tjetër s'ka! E tillë është kjo botë. Herët a vonë, vjen një ditë që gjithçka mbyllet me fjalën: Lamtumirë!

Lamtumirë, Mik i dashur!

Prehu i qetë në tokën mëmë, që ia blatove tërë jetën!

Qoftë i përjetshëm kujtimi për Ty, i paharrueshmi Profesor Nuri!

(Tiranë, 29 prill 2014, në varrezat e Tufinës)

Iku me pengun e Rrugës së Arbërit...

Nga **MUSA RIÇKU**

Me Profesor Nuriun na lidhi shumë Shoqata e Intelektualëve Dibranë.

Edhe më parë kisha njohje dhe respekt për të, jo vetëm prej prindërve, por edhe prej vetë sjelljes së tij. Një herë në vitet 1983 na u gjend shumë pranë në Shkodër, duke marrë përsipër të ndihmonte bashkëshorten time, Hasijen, për një provim jashtë radhe, pasi kishim njërin djalë të vogël. Pastaj, më bënte përshtypje, se pavarësisht se sa rrallë takohesha, me pyeste për gjithë anëtarët e familjes, emër për emër, si të ishin familja e tij.

Në kohën kur me një grup miqsh po merreshim me themelimin e LID,e takova dhe i propozova ta drejtonte shoqatën. Në fillim nuk pranoi. Por në konsultimet për të gjetur emrin e një kryetari, çdo propozim që vinte, kishte dilema e dyshime, por kur unë propozova emrin e tij, të gjithë ranë dakord. Askush nuk kundërshtoi, përkundrazi, të gjithë u shprehën se do të ishte një nder për dibranët, që këtë shoqatë ta drejtonte Prof. dr. Nuri Abdiu.

Mu desh shumë punë, shumë takime, shumë diskutime, pyetje e përgjigje, dilema të tij për ta marrë këtë detyrë, dhe kur në fund vendosi, më vuri edhe para përgjegjësisë.

Ai ishte aktiv në shoqatë. Donte të takoheshim, pothuajse çdo muaj. Kërkonte mendime. Kërkonte maksimumin për organizimin e një veprimtarie. Ishte i shqetësuar deri sa të mbaronte. Interesohej për çdo detaj, sado i vogël. Dhe merakosej shumë në vetvete kur diçka nuk shkonte, por askujt nuk ia hidhte përgjegjësinë. Nuk ngutej në programimin e veprimtarive të LID, por as nuk donte ti linte gjërat në momentin e fundit.

Takimet për kafe na i linte pranë Universitetit, te kafja e tij. Dhe këtë e bënte se donte të paguante: "Një kafe nga unë", thoshte. Takoheshim edhe në vende të tjera, por kishte raste që kafet na i paguante ndonjë "i panjohur", ndonjë student i tij nga Përmeti a Lushnja, Fier a Vlora, nga gjithë Shqipëria.

Në mbledhjet e kryesisë gjithmonë kërkonte mendim. Asnjëherë nuk vendoste derisa të diskutonte edhe anëtari i fundit i kryesisë. Kam qenë pranë tij gjatë gjithë kohës, dhe asnjëherë nuk vura re te ai inatin, egërsinë, nxitimin. Ishte i qete, pyeste, bindej dhe në fund i bënte konkluziomet si të ishte e mira, pa u fyer askush dhe për të, mirën e të gjithëve.

Një e veçantë e tij ishte se gjithmonë shqetësohej për buxhetin e veprimtarive. Donte që shoqata të mos mbetej pa 2-3 veprimtari në vit, por kjo nuk duhej kushtëzuar me financat. Sa më shumë punë vullnetare, aq më pak shpenzime financiare.

Nën drejtimin e tij, Shoqata ka bërë disa veprimtari të suksesshme, siç kanë qenë Konferenca Shkencore për "Rrugën e Arbërit", "Dibra në sytë e të huajve", sesioni shkencor "Kontributi i Dibrës në Pavarësinë e Shqipërisë", festimet e 70-vjetorit të poetit Naim Plaku dhe shumë veprimtari të tjera që janë organizuar në Tiranë e gjetkë, nën drejtimin e LID apo me bashkëpunimin e saj.

Vitin e fundi e ndjente se shëndeti po i dobësohej. Merrte shpesh në telefon. Takoheshim për kafe, dhe pasi pyeste për shëndetin, pyetja e parë ishte: Çdo bëjmë ndonjë veprimtari? A i ke takuar shokët? Kur do mblidhemi ta pleqësojmë njëherë? Nën drejtimin e LID, ai kishte dy pengje: E para, donte që shoqata të shndërrohej në një frymëzuese të bashkëpunimit sa më të gjerë të dibranëve, kudo që ndodheshin. Ishte i ndërgjegjshëm për dasitë politike në komunitetin Dibran, por kjo nuk duhet të na pengojë të bashkohemi në veprimtari të përbashkëta, ta duam dhe ta respektojmë njëri-tjetrin, ta vlerësojmë punën dhe kontributin e gjithsecilit, jo vetëm për të mirën e Dibrës, por për gjithë vendin.

Së dyti, ai kishte peng çështjen e Rrugës së Arbërit. Pyeste vazhdimisht. Interesohej edhe në telefon. Kur dëgjonte ndonjë lajm në televizor apo në gazeta, na thërriste për kafe dhe kërkonte ta pleqëronim këtë punë. Bashkë me Bashkimin, Demirin, Hysenin, Bujarin dhe shokwt e tjerw, kërkonte mendim dhe donte të dinte nëse shoqata kishte mundësi të bënte diçka. "Ajo rrugë nuk ka filluar akoma, thoshte, dhe për sa kohë ne mund të kontribuojmë të rregullohet më mirë, nuk duhet të kursehemi". Dhe, disa javë para se të largohej nga ne, nënshkroi një letër që iu drejtua qeverisë shqiptare, me shqetësimin e përmirësimit të projektit". Projekti i fundit i tij ishte organizimi i një veprimtarie me rastin e numrit të 100 të Rrugës së Arbërit!

Nga miqtë e tij jam i fundit që kam folur me të. Më 27 prill pasdite fola në telefon. E ndjeva përmes zërit se nuk ishte mirë. Në mesnatë mora lajmin e ndarjes nga kjo botë. Por unë vazhdoj ta kujtoj si në takimin e fundit: i qeshur, plot nur, mirësi dhe dashuri!

In Memoriam

Prof.dr. Nuri Abdiu (1930 – 2014)

Nga **Akademik PAJAZIT NUSHI**
P r i s h t i n ë

Më 27 prill 2014 vdiq gjurmuesi i parë i zhvillimit të mendimit psikologjik shqiptar – Prof. Dr. Nuri Abdiu, profesor i psikologjisë. Profesor Nuri u u varros më 29 po të këtij muaji dhe viti në prani të shumë shokëve, miqve e kolegëve dhe shumë qytetarëve nga Tirana, Dibra, Shkodra, Prishtina. Ka lënë pas vdekjes dokementacion shumë të vlefshëm për zhvillimin e mendimit psikologjik shqiptar me shqyrtim analitik të këtij dokumentacioni. Me këtë i ndjeri Nuri Abdiu ka hapur horizontin e zhvillimit të mendimit psikologjik ndër shqiptarët duke mundësuar plotësimin e zhvillimit të histories së mendimit shkencor të shqiptarëve, si edhe duke mundësuar plotësimin e kurikulumit të psikologjisë universitare, që krahas historisë së zhvillimit të mendimit psikologjik, përgjithësisht, të studiohet edhe zhvillimi i këtij mendimi ndër shqiptarët. Në këtë rrafsh veprat e të ndjerit Nuri kanë formësuar "Antologjinë" e mendimit psikologjik shqiptar, duke ia bashkangjitur zhvilllimit të mendimit filozofik, sociologjik, pedagogjik e antropologjik edhe historinë e zhvillimit mental të shqiptarëve. Deri me angazhimin e të ndjerit Nuri në këtë fushë historia e shqiptarëve përgjithësisht, sidomos historia e zhvillimit të kulturës shqiptare, ka qenë trajtuar pjesërisht në kuadrin e disiplinave të letërsisë, të filozofisë, të pedagogjisë, të sociologjisë, etj.

Prof. Dr. Nuri Abdiu i dha përmasës së theksuar humaniste të pikologjisë edhe dimensionin e thelluar humanist të personalitetit të tij, sepse fytyra etike në të gjitha format e veta ka qenë tipari themelor i personalitetit të këtij psikologu. "Nuri i tij etik" ka qenë dhe mbetet tipari karakteristik i veprimtarisë së përgjithshme të tij në raport me të gjithë të tjerët, qofshin ata fëmijë, nxënës, studentë, kolegë e qytetarë të zakonshëm prej cilitdo vend qofshin.

Profesori, studiuesi e humanisti Nuri Abdiu, së bashku me kolegët e tij, të ndjerët Bedri Dedja e Hamit Beqja i kanë dhënë zhvillimit të psikologjisë në Shqipëri, madje jo vetëm në Shqipëri, vulë karakteristike zhvillimore gjatë katër dekadave të gjysmës së dytë të shekullit njëzet. Kjo dallohet edhe sot, kur secili me formim shkollor mesatar dallon mbështetjen e botëkuptimit, të pikëpamjeve dhe të qëndrimeve të tyre në fiziologjinë e psikologjinë e sistemit nervor të shkollës fiziologjike ruse të Vlladimit M. Behterievit, të Ivan M. Seçenivit, të Ivan P. Pavllovit, etj. Përmasë tjetër e mësimdhënies së psikologjisë nga ana e tyre dhe e teksteve universitare dhe e atyre të shkollave të mesme, është lidhja e ngushtë e psikologjisë me pedagogjinë, duke i dhënë psikologjisë pozicion të domosdoshmërisë së zotërimit të saj për të pasur sukses në zotërimin e përmbajtjeve të disiplinave të pedagogjisë. Fryt i veprimtarisë së përbashkët të tyre është formimi i kuadrit profesionist për sistemin e shkencave të psikologjisë. Vijuesit e kursit të studimeve pasuniversitare nga psikologjia më 1975/1976, që më parë kishin kryer studimet universitare nga gjuha shqipe, biologjia, gjeografia, matematika etj., arritën të doktorojnë në psikologji dhe të udhëheqin departamente të psikologjisë në Republikën e Shqipërisë. Më në fund, grupi i psikologëve të përmendur, sidomos i ndjeri Nuri, me rezultatet e aktivitetit shkencor të tyre na treguan neve dhe gjithë botës se shqiptarët e dhe në sferën e zhvillimeve mentale kanë histori të lashtë dhe në këtë sferë nuk ekzistojnë ndryshime, saqë të jenë të ndarë.

Për këto arsye, para së gjithash vdekja e Profesorit Nuri mbylli një periudhë zhvillimore të psikologjisë mbi të cilin shumë studiues shqiptarë zhvillojnë veprimtarinë profesionale psikologjike në shkolla, klinika, organizata punuese, etj. Studentët e tyre pasardhës, mbi temelin e mësimeve të tyre hapën fillimin e rilindjes së dytë të psikologjisë, duke përvetësuar dhe përpunuar me sukses të arriturat e psikologjisë në shtetet e Evropës Perëndimore dhe të atyre përtej oqeanike.

Pjesëmarrja masive e shqiptarëve nga të gjitha trevat e tyre tregoi si duhet nderuar njeriu që bërë kaq shumë për zhvillimin e mendimit psikologjik shqiptar, që njëkohësisht është kontribut i posaçëm i historisë së zhvillimit të kulturës kombëtare.

Prore i qoftë i lehtë dheu i tokës së Tiranës profesorit e humanistit Nuri Abdiut. U prehsh në nur i paharrueshmi Nuri Abdiu!



Prof. Dr. Nuri Abdiu, duke mbajtur fjalën e tij në konferencën shkencore të organizuar nga LID, "Kontributi i Dibrës në Pavarësinë e Shqipërisë", zhvilluar në Akademinë e Shkencave më 11 nëntor 2012. Foto: B.Karoshi

Ndahet nga jeta Nuri Abdiu, hartuesi i parë i bibliografisë së punimeve shqiptare në psikologji

Nga **ALMARINA GEGVATAJ (ATSH)**

TIRANE, 27 Prill/ATSH/- Prof. Dr. i Shkencave Psikologjike dhe Veterani i Luftës Nacional-çlirimtare, Nuri Abdiu është ndarë sot nga jeta.

Prof Dr. Nuri Abdiu ka mbaruar studimet e larta me Diplomën "Rezultate të Shkëlqyera" në Institutin Pedagogjik Shtetëror të Moskës, për "Pedagogji-PsikologjiI", në vitin 1958.

Me Vendimin nr 26, dt 29.10.1991, Komisioni i Lartë i Atestimit pranë Këshillit të Ministrave i ka dhënë gradën shkencore "DOKTOR I SHKENCAVE" dhe me Vendimin nr. 3, dt. 9.02.1999, i ka dhënë titullin shkencor "PROFESOR". Gjatë periudhës 1951-1958, Prof Dr. Nuri ABDIU ka qenë Referent Konsullor pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Gjatë periudhës 1958-1993 ka qenë Pedagog dhe Zv.Drejtor në Institutin e Lartë Pedagogjik Shkodër.

Gjatë periudhës 1997-2006 ka qenë Drejtues i Departamentit të Psikologjisë në Universitetin Jo Publik "Albanian University".

Lista e punimeve shkencore, studimeve, kumtimeve shkencore dhe artikujve të hartuara dhe zhvilluara nga Prof. Dr. Nuri Abdiu arrijnë në mbi 160 zëra. Shumë prej tyre janë botuar në organe shkencore dhe mbajtur në sesione të ndryshme shkencore, lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, si në Kongresin VI Europian të Psikologjisë (Romë 1999), në Prishtinë, etj.

Prof. Dr. Nuri Abdiu është hartuesi i parë i Bibliografisë së punimeve shqiptare në lëmin e psikologjisë (botuar më 1985.). Është bashkautor në 7 tekste të psikologjisë, 4 për shkollat e larta, 1 për kursin pasuniversitar dhe 2 për shkollat e mesme pedagogjike. Ka botuar 3 monografi: "Bibliografia e punimeve shqiptare në lëmin e psikologjisë", botuar më 1986.

Vepra e tij kryesore, që përbën një kontribut të veçantë në përgjithësimin e përvojës sonë kombëtare në fushën e mendimit psikologjik shqiptar, është studimi i tij "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar (gjer më 1939)", botuar më 2002. Eshtë autor edhe i disa monografive, të botuara në revista e përmbledhje shkencore. Më 2007 botoi monografinë "Psikologjia e Hasan Tahsinit". Prof. dr. Abdiu la në proces tekstin "Mbi historinë e Psikologjisë shqiptare".

Prof. Dr. Nuri Abdiu ka qenë: Anëtar i Këshillit Shkencor të Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër deri më 1993; Anëtar i Komisionit Kombëtar për "Çështjet e Pedagogjisë dhe të Psikologjisë" të Ministrisë së Arsimit, 1959 – 1993; Anëtar i Redaksisë së "Buletinit Shkencor" të ILP Shkodër deri më 1993; Anëtar i Kolegjiumit të redaksisë së Revistës "Arsimi Popullor", 1966-1967; Anëtar i Komisionit të Posaçëm të Mbrojtjes së Disertacioneve, 1987-1994; Anëtar i Redaksisë së fushës së kulturës, shkencës, arsimit për Enciklopedinë Shqiptare; Anëtar dhe zv.President i Shoqatës Mbarëkombëtaretë Psikologjisë; Anëtar i Bordit të Konsulentëve të Revistës Shkencore "European Psychologist" që botohet në Hamburg, Gjermani, 1996 – deri më sot. Kryetar i Komisionit të Psikologjisë të Universitetit të Tetovës si dhe Kryetari i shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë".

Prof. Dr. Nuri Abdiu ka marrë këto Tituj Nderi:

- Presidiumi i Kuvendit Popullor, me Dekretin nr. 4446, datë 10.10.1968 e ka dekoruar me "Medaljen e Punës";

-Presidiumi i Kuvendit Popullor, me Dekretin nr.6224, datë 29.9.1980, i ka dhënë Urdhërin "Naim Frashëri" të KLASIT TË PARË;

-Presidiumi i Kuvendit Popullor, me Dekretin nr. 7183, datë 22.12.1987, i ka dhënë titullin "MËSUES I MERITUAR";

-Presidiumi i Kuvendit Popullor, me Dekretin nr. 7336, datë 18.11.1989, i ka dhënë titullin "MËSUES I POPULLIT".

Lista e punimeve shkencore, studimeve, kumtimeve shkencore dhe artikujve të hartuara dhe zhvilluara nga Prof. Dr. Nuri Abdiu arrijnë në mbi 160 zëra. Shumë prej tyre janë botuar në organe shkencore dhe mbajtur në sesione të ndryshme shkencore, lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, si në Kongresin VI Europian të Psikologjisë (Romë 1999), në Prishtinë, etj.

Prof. Dr. Nuri Abdiu është hartuesi i parë i Bibliografisë së punimeve shqiptare në lëmin e psikologjisë (botuar më 1985.). Është bashkautor në 7 tekste të psikologjisë, 4 për shkollat e larta, 1 për kursin pasuniversitar dhe 2 për shkollat e mesme pedagogjike. Ka botuar 3 monografi: "Bibliografia e punimeve shqiptare në lëmin e psikologjisë", botuar më 1986.

Vepra e tij kryesore, që përbën një kontribut të veçantë në përgjithësimin e përvojës sonë kombëtare në fushën e mendimit psikologjik shqiptar, është studimi i tij "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar (gjer më 1939)", botuar më 2002.

Homazh për simbolin dibran!

Nga **SHPËTIM CAMI**

Paraditen e ditës së dielë po udhëtoja drejt Strugës, kur mora lajmin! Po shoqëroja një delegacion të EURAG, të përbërë nga 13 shtete, për një vizitë në qytetin e Strugës. Pas vizitës në Strugë, delegacioni vazhdoi rrugën për në Ohër dhe në Shën Naum, ndërsa unë u ktheva për në Tiranë. E ndjeja për detyrë të isha pranë familjes dhe të afërmve të profesorit në këto momente dhimbjeje njerëzore.

E ndjej përsëri për detyrë t'i them opinionit dibran dhe mbarëshqiptar, mbresat e mia për Prof. Nuriun, një nga emblemat e fisnikërisë, urtësisë dhe mençurisë dibrane.

Kisha dëgjuar shumë për Prof. Nuriun, që nga vëllai im Emin Cami, ish student i profesorit në Institutin Pedagogjik në Shkodër në vitet 1965-1967 e derisa mora pjesë në mbledhjen e parë themeluese të Lidhjes së Intelektualëve Dibranë në vitin 2006, në të cilën e zgjodhëm me unanimitet Kryetar të Lidhjes.

E njoha më shumë profesorin kur ndoqa studimet master në Albanian University. Pinim shpesh çaj së bashku dhe diskutonim për Dibrën dhe dibranët. Po përgatisja një studim për shkencat politike në Shqipëri, në bashkëpunim me dy profesorë nga organizata ndërkombëtare e shkencave politike dhe më duheshin disa të dhëna rreth numrit të studentëve të shkencave politike në këtë universitet. Ja shpreha kërkesën dhe shqetësimin për pamundësinë e marrjes së këtyre të dhënave. Më mori përnjëherësh për krahu dhe shkuam së bashku në sekretari. Për pesë minuta i mora të gjitha statistikat. Gëzonte një respekt të jashtëzakonshëm.

Në korrik 2009 morëm pjesë në 100 vjetorin e Kongresit të Dibrës, në Dibër të Madhe si dhe në qytetin e Peshkopisë , ku bëmë disa foto së bashku tek busti i Skënderbeut. Fjala e profesorit ishte e thjeshtë, e matur dhe kuptimplotë.

Në dhjetor 2009, kur u bënë zgjedhjet e Shoqatës më propozoi anëtar të kryesisë së Lidhjes dhe në tetor 2012, më propozoi sekretar të përgjithshëm. Dëshironte të takoheshim shpesh. Për shkak të angazhimeve të shumta që kisha, ndonjëherë edhe më kritikonte se e telefonoja dhe e takoja rrallë. Me profesorin në krye zhvilluam disa aktivitete me vlera historike, ku do të veçoja simpoziumin për kontributin e dibranëve në pavarësinë e Shqipërisë si dhe koncertin për ditëlindjen e poetit dibran Naim Plaku, në të cilin na nderuan edhe shumë shqiptarë nga Maqedonia së bashku me Ali Ahmetin. Ai kishte ardhur në nder të kontributit të profesorit në hapjen për herë të parë të Universitetit Shqip në Tetovë

Në dilemat e mia për të zgjedhur midis fushës akademike dhe asaj politiko-administrative para disa vitesh, e pyeta profesorin se cilën alternativë të zgjidhja. M'u përgjigj menjëherë, pa u menduar gjatë: fushën akademike. Ashtu bëra në atë moment. Ishte një këshillë më vlerë dhe mësova shumë. Më ndryshoi jeta. Ky ishte profesor Nuriu. Të ndryshonte jetën. Jo vetëm mua, por çdo dibrani që kërkonte mbështetje tek ai.

Më 7 mars 2013, i jam mirënjohës kryesisë së Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, e cila më besoi mua të moderoja një aktivitet më rastin e 7 Marsit. Ia kushtonim Mësuesit të Popullit, nderit dhe krenarisë dibrane, Prof. Nuriut. Sa shumë kërkesa për të folur për të madhin dibran. Sa të vështirë e pata! Isha vërtet i emocionuar kur ia dhashë fjalën mes tingujve të violinës si cicërima zogjsh, i rrethuar nga tufa me lule. Ato lule m'u kujtuan edhe sot, kur i vendosëm një kurorë tek shtëpia e tij e përjetshme, në emër të Lidhjes së Intelektualëve Dibranë.

U prehsh në paqe profesor!

** Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Intelektualëve Dibranë*



Profesor Nuri Abdiu ishte vazhdimisht i angazhuar për Rrugën e Arbërit. I vetëdijshëm se për këtë çështje nuk është bërë akoma sa duhet, ishte i gatshëm të bisedonte dhe shkëmbente mendime me të gjithë ata që jepnin kontributin e tyre. Në foton më sipër, mes një grupi intelektualësh dibranë në Hotel Tirana. Nga e djathta në të majtë: Sulejman Tomçini, Musa Riçku, Demir Osmani, Gëzim Alpion, Nuri Abdiu, Flutura Osmani dhe Hysen Uka. Takimi u zhvillua në kuadrin e bashkërendimit të punëve për një rezultat sa më maksimal në lobimin për Rrugën e Arbërit. (Maj 2013. Foto: B.Karoshi)

Na iku një shkencëtar, një burrë Dibre…

Nga HYSEN UKA, BUJAR KAROSHI

Na iku edhe një burrë Dibre… Na iku Nuri Abdiu, prindi, vëllai, mësuesi, shoku, miku, profesori, shkencëtari… Na iku një njeri, një njeri në plotësinë kuptimore të kësaj fjale…

Profesor Nuriu i kish marrë të gjitha gradat e shkencës, plot grada e ofiqe të pushtetit e politikës, por gradat për të cilën ne e kujtojmë sot dhe do ta kujtojmë përgjithmonë, do të jenë gradat më të larta si njeri, një gradë universale, vlerat e së cilës shkëmbehen e çmohen kudo, në botën mbarë ku frymon shoqëria njerëzore.

Nga Moska në Bruksel, nga Nairobi (Kenia) në Amerikë e Kanada, kudo shkeli e piu një kafe, profesori ynë Nuri Abdiu, la shijen dhe aromën e njeriut të mirë. Ishte dhe mbetet vlerë e vërtetë e fjalës njeri, ndaj dhe boshllëku e dhimbja që lë ikja e tij, është e madhe, mbush me dhimbje e lë në dëshpërim një rreth shumë të madh njerzish, jo vetëm në Dibër e Tiranë, në Shkodër e Shqipëri, por në mbarë trojet ku shqip i drejtohet burri-burrit "tunjatjeta!".

Zbrazëtia e ikjes tuaj, i paharruari mësuesi ynë do na dhembë gjatë, por shembulli dhe modeli yt do të na udhëheqë përgjithmonë. Edhe ata që do të vijnë në paskohësinë tuaj, ata që nuk do të kenë fatin të të shohin e të të takojnë kurrë, ata që do të lindin pas jetës tënde tokësore, tashmë që ti nget në përjetësi do të të kujtojnë e do ta çmojnë shembullin, modelin që na le.

Për ne dhe për ata, i paharruari profesor, do të mbetesh model për urtësin, mençurinë, për dijet që krijove si punëtor i shkencës, embëlsinë dhe aromën e njeriut të vërtet. Për këto e shumë vlera të tjera, do të kujtojnë më krenari e me nderim dhe do të përpiqen të të ngjajmë, e të shtojnë vlerat mbi shembullin tënd, të shtojnë dijet mbi thesarin e dijeve që na le ti.

Ne po të përcjellim sot në një ditë lulesh i pa harruari profesor Nuriu, në këtë ditë prilli, kur edhe qielli, sikur po vajton, nuk do të të japë më dritë për sytë e tu, ndriçimi i diellit nuk do të lodroi më me flokët dhe ballin tënd fisnik, peleria e dritës së kësaj bote nuk do të derdhët më supeve të tua, ngohtësia e jetës nuk do të rrjedhë nëpër rremat e jetës së trupit tënd.

Por dritën dhe nurin e diellit, i nderuar profesor, ashtu si e meritove në mes të gjallëve, na e le këtu, me bujari e të shumëfishuar ndër ne, në veprën dhe mendimin tënd.

Dhe e di i shtrenjti ynë profesor, besoj se në atë botë do të kesh një shqisë për të na dëgjuar ne që të deshëm aq shumë e që s'do mund të të harrojmë kurrë, tek të mbajmë në supet tona në arkmortin e zymtë, drejt qytetit të përjetësisë në Tufinë, para kortezhit të gjatë, që rëndon nga dhimbja dhe solemniteti, mua më shkojnë sytë përtej, aty ku hapet gryka shkëmbore e Shkallës së Tujanit, andej nga shpejt shpresojmë të shtrihet e të fluturojë e bukura jonë Rruga e Arbërit. Rruga për të cilën ti punove e u përpoqe aq shumë së bashku me ne, në çdo hap deri në fund. Kujtoj takimin e fundit para dy javësh, tek shtëpia juaj, kur veç për botimet, shoqatën, dibranët etj, në fund, deshe të heqësh merakun edhe për Rrugën e Arbërit. "- Hë, a kemi ndonjë haber nga qeveria për Rrugën…?". Duke të përcjellë sot, kësaj ane, ku nesër do të kaloj Rruga e Arbërit, ne gjithmonë do të të kujtojmë, për mundin, për përpjekjet, për ëndrrën e papërmbushur që more me vete. Besoj, se ndër pengjet që merr njeriu me vete, ky është pengu që gjatë nuk do të tretet. Të premtojmë se do të punojmë pa u lodhur për të mirën dhe zhvillimin e Dibrës, mësuesi ynë.

Deri në frymën e fundit profesori ishte në mes dhe në krye të komunitetit dibran, me ne të gjitha pa dallim, nga intelektualët, studentët, mësuesit, të ardhurit nga qyteti e Malësitë e Dibrës, dhe kudo ku ai ishte përhapte frymë paqtimi e të harmonisë, ishte njëlloj indi lidhës që bashkonte, një lloj limfe që lëvizte nëpër të gjithë qenien e komunitetin tonë, me veti shëruese, që freskonte e pastronte në gjakun tonë, çdo shenjë hatëri e qefmbetje, çdo nojmë mërzitje e qejfprishje. Me durimin, mençurinë, fjalën e ëmbël, nëpër të gjithë vallet e kuvendet, përhapte farën e paqes e të harmonisë.

Pafund ishin njerëzit që e ndalonin, e përshëndesnin dhe e përqafonin me dashuri Nuri Abdiun. Kudo që ndodhej, kudo që shkonte, malësor e miq, mësues e ish studentë, nga Puka, nga Fieri, nga Vlora e nga Shkodra, nga Prizreni e Prishtina, nga Saranda e Filati, nga Tetova e nga Shkupi, ngado ku flitej e mendohej shqip…

Profesor Nuriu zotëronte aftësi e cilësi komunikimi krejt të veçanta, sa të lindura, aq dhe të kultivuara, të cilat rrinin natyrshëm dhe i jepnin hijeshi staturës së tij prej qytetari e intelektuali. Çdo takim me të ishte impresionues, mbresëlënës. Në çdo takim dhe me këdo, asnjëherë, në të gjitha ato raste që kam patur fatin të jem i pranishëm, nuk kam parë të mungojë përkujdesja, drita e buzëqeshjes, fjala e ëmbël, e butë, plot mirësi; me këdo që takohej, apo njerëz që e ndalonin në rrugë e i kërkonin t'i dëgjonte, në të shumtën e herës për t'i qarë hallet me të…

Ishte aftësia e tij e lindur, por dhe e kultivuar si psikolog, të depërtonte e të kuptonte natyrën dhe gjendjen e çdo njeriu që takonte… por ishte mjeshtëria e tij t'i mbushte me ndjesi të mira e t'u fitonte respektin… Kishte merak njerëzit që jepnin vetëm majat e gishtave. Asnjeherë dhe askuj, i çdo rrangu shoqëror që të ishte, profesori nuk i jepte vetëm majat e gishtave, por dorën plot dhe me gjithë zemër e respekt… Bile i neveriste ato "intelektualë" që edhe dorën e japinë me kopraci, veç majat e gishtave… por kur jep dorën plot, edhe zemrën e ke plot… Profesori, të gjithëve, falë edhe memories së tij, u drejtohej me emër e mbiemër, në shenjë vlerësimi e respekti, kushdo qoftë.

Profesor ishte njeriu që luftoi deri në fund me fuqinë e mendjes dhe personalitetin e tij të frymëzojë njerëzit për punë të mira, të diskutojë e t'u kushtohet veprimtarive dhe projekteve të dobishme…duke vënë në shërbim të shoqërisë sonë të gjitha aftësitë dhe përvojat e mëdha që kishte krijuar në veprimtarinë pedagogjike, organizative e shkencore… Profesori nuk thoshte asnjëherë jo, asnjëherë nuk mundëm, asnjëherë nuk bëhet, por gjithmonë ishte sy e vesh të dëgjojë ide e mendime, t'i respektojë dhe t'i frymëzonte e ushqente ato, ngado e nga kushdo. Ai kishte shpirtmadhësinë e njeriut të urtë e të shkencëtarit të moralshëm për të respektuar e çmuar çdo punëtor të mendjes, për të vlerësuar, nxitur e frymëzuar çdo ide e projekt, të kujdo qoftë…

Profesor Nuriu kishte aftësinë e magjishme të krijonte kudo të ishte mjedis e shoqëri të mirë, atmosferë e kujtime të këndshme… Çdokush që mund ta ketë takuar qoftë edhe njeherë, patjetër që do ta kujtojë me kënaqësi kohën, orët, qoftë edhe minutat me të…

Për njerëzit që merreshin me veprimtari intelektuale Profesor Nuriu, ishte një stimul, një nxitës i lindur i mendimit intelektual… Të gjithë njerëzit e ideve dhe të mendimit gjenin tek ai një nxitës të fuqisë intelektuale… Ndaj ishte gjithmonë i kërkuar dhe i rrethuar prej tyre…

Në të gjitha veprimtaritë e mira, të shoqërisë civile e intelektuale, që bëhen në Tiranë, Dibër, Prishtinë e Tetovë, profesori ka lënë përpjekjen, kontributin dhe mendimin e tij. Ai ishte i pa lodhur deri në fund, duke lënë edhe plot ide e projekte që ne t'i realizojmë e çojmë më tej…

Përherë të parë për profesor Nuriun kam dëgjuar në Shkodër në vitin 1989. Pranverë ishte edhe atëherë, në një kafe.... Si një vizitor i ri në Shkodër po pija kafen e mëngjesit vetëm në lokalin plot. Një burrë në moshë me kërkon leje të ulet e të pijë kafen në tavolinën ku isha unë. I dhashë mirëseardhje shkodranit dhe shpejt prita pyetjen e hokat e para prej tij… "Aha mirë, kenke dibran", tha pasi rrufiti disa herë kafen. "Po çfarë llojë dibrani je, nga ato të Nuri Abdisë apo nga ato të..., dhe tha një emër dibrani tjetër me punë në Shkodër"… Pa e ditur përshtypjen që mund të krijoja, i thash se jam nga ato të Nuri Abdiut, të cilin unë atë herë as me sy nuk e kisha parë. "Epo kenke dibran i mirë", - shtoi.

Kontributi i profesorit është i madh dhe në organizimin e komunitetit dibran në Tiranë. Nën drejtimin e tij, Lidhja e Intelektualëve ka organizuar disa sesione shkencore, konferenca apo veprimtari të tjera, që lidheshin me Dibrën dhe përfaqësuesit e elitës së saj, të cilat për nga organizimi dhe cilësia kanë qenë në nivelet më të lartë dhe, padyshim, kontributi i prof. Nuri Abdiut ka qenë i pazëvendësueshëm.

“Kalorësi fisnik i historisë së psikologjisë shqiptare”

Nga **Dr. LAURANT BICA**

Puna e profesor Nuri Abdiut është puna e një njeriu të përkushtuar ndaj studimit të një fushe të zhvillimit të shkencës shqiptare, relativisht të re, siç është ajo e studimeve psikologjike. Këtë fushë, siç thanë vlerësuesit e veprës së tij, ai e bëri “të vetën” dhe u afirmua në të në sajë të një pune sistematike.



Gjatë një takimi në Komunën e Dibrës së Madhe, 2009

Nuri Abdiu është një ndër themeluesit e shkollës së sotme psikologjike shqiptare dhe një nga ata që ka përgatitur kuadro dhe për këtë shkollë, një ndihmesë kjo me vlerë kombëtare dhe më gjerë. Për gati gjysmë shekulli ai ka qenë mësues, profesor i psikologjisë dhe ka ligjëruar në Universitetin e Shkodrës, Tiranës, Prishtinës, Tetovës etj., brenda e jashtë Shqipërisë dhe është bërë një autoritet i kësaj fushe krahas akademikëve e profesorëve si: Bedri Dedja, Hamit Beqja, Pajazit Nushi, Shefik Osmani, Musa Kraja etj.

Puna e profesor Nuri Abdiut është puna e një njeriu të përkushtuar ndaj studimit të një fushe të zhvillimit të shkencës shqiptare, relativisht të re, siç është ajo e studimeve psikologjike. Këtë fushë, siç thanë vlerësuesit e veprës së tij, ai e bëri “të vetën” dhe u afirmua në të në sajë të një pune sistematike. Në sajë të saj, krahas të tjerave ai mori “Medaljen e punës” më 1968, urdhrin “Naim Frashëri” të klasit të parë më 1980, titullin “Mësues i Merituar” më 1987 dhe dy vjet më pas edhe titullin më të lartë, “Mësues i Popullit”. Një trajektore ngjitëse që flet më shumë nga gjithçka tjetër. Nga 1969, kur kumtoi për herë të parë në Konferencën I Kombëtare të Studimeve Pedagogjike edhe për H. Tahsinin e deri më sot te monografia për një vepër të tij, kemi përsëri një tjetër trajektore ngjitëse të studimeve të Nuri Abdiut për këtë rilindës, rritje kjo si sasiore, ashtu dhe cilësore. Ne kemi besimin se pas kësaj rruge ngjitëse gati 40-vjeçare, profesori do të kapë kuota të tjera më të larta... Po kështu edhe shkallët e karrierës pedagogjike e shkencore (edhe kjo një trajektore tjetër lartësuese) flasin akoma më tepër: titulli shkencor “Docent” më 1973, grada “Doktor i shkencave” më 1991 (nga të parët në fushën e psikologjisë) dhe titulli shkencor “Profesor” më 1999.

Prof. Nuri Abdiu ka meritën se ka zbuluar dhe një sërë personalitetesh që vlejnë si për mendimin psikologjik, ashtu edhe për atë filozofik shqiptar. I tillë është Branko Merxhani, Isuf Agjah Korça etj. Me këtë rast nuk mund të mos përmendim se puna e tij në fushën e psikologjisë është çmuar, duke e futur në redaksinë e Enciklopedisë Shqiptare për hartimin e zërave respektivë...

Me dekada të tëra ky njeri u rropat nëpër ravat e jetës dhe të shkencës së psikologjisë. Rezultat i kësaj pune të lodhshme ishte studimi “Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar”, Tiranë 2002. Teksa po shihja orarin më tërhoqi vëmendjen një lëndë e posaçme në degën e psikologjisë, “Kursi Special”. E pyeta profesorin dhe u gjenda para një befasie të dytë për mua. Në atë kurs jepej një lëndë e re, “Historia e Mendimit Psikologjik Shqiptar”, prej vetë autorit të saj. E urova me gjithë zemër që kjo lëndë e re kish marrë “rrugë” në programet e Universitetit “UFO” dhe ta hiqte “këmbën zvarrë” duke u dhënë në Universitetin Shtetëror të Tiranës e prej andej në mbarë universitetet shqiptare, shtetërore apo private qofshin, në tërë trojet etnike shqiptare. Dhe s‘janë pak. Numri i tyre po i afrohet me shpejtësi 40-ës dhe vitin tjetër akademik, shkollor e kalon këtë shifër...

Një etje e paduruar për arsim, kulturë e shkencë e popullit tonë, e shqiptarëve kudo që janë... Shpresoj dhe besoj që në një të ardhme të afërt “Historisë së Mendimit Psikologjik Shqiptar” të Prof. Dr. Nuri Abdiut t‘i shtohen dhe “Historia e Filozofisë Shqiptare”, “Historia e mendimit Ekonomik Shqiptar” etj., etj. Arsimi shqiptar pret “kalorësit e rinj” të këtyre shkencave shqiptare dhe njëkohësisht lëndëve mësimore të nesërme në universitetet tona të vjetra e të reja, sikurse “kalorësi i psikologjisë”, Nuri Abdiu, siç e përcakton i ndjeri akademik Prof. Bedri Dedja. Urojmë që të tillë “kalorës” të shumohen për të mirën e shkencës shqiptare, për t‘i treguar botës se në këto troje të Ballkanit jeton një popull që i ka dhënë në shekuj, i jep sot dhe do t‘i japë shkencës botërore në përgjithësi ndihmesën e vet të vyer. Detyra jonë është ta zbulojmë këtë kontribut në fusha të ndryshme të saj dhe të bëjmë të vetëdijshëm brezat e sotëm e të ardhshëm për vlerat tona si popull, si komb. Detyrë sa e vështirë, aq dhe fisnike, por dhe që të mbush me krenari. Prof. Dr. Nuri Abdiu është nga ata personalitete të shkencës sonë, që e ka përmbushur këtë detyrë qysh sot, pas dekadash të tëra pune këmbëngulëse e të suksesshme. Lënda e re në programet e universitetit “UFO” është një buqetë lulesh në këtë drejtim. Libri për “Psikologjinë e Hasan Tahsinit” është një gur më tepër në “murin” e kësaj shkence të re...

Pas rreth gjysmë shekulli që Hasan Tahsini dinte bashkë me shqipen 11 gjuhë: tre gjuhët e Lindjes, arabisht, persisht, osmanisht, greqishten e re; greqishten e vjetër e latinishten që e përvetësoi në Sorbonë; frëngjishten e italishten dhe sipas indikacioneve më të fundit që kemi mendohet të ketë ditur dhe anglishten e gjermanishten; një poliglot i vërtetë. Midis të tjerave, vepra “Shkrimet e Popujve” dhe alfabeti origjinal i tij për gjuhën shqipe janë dëshmia më e mirë për këtë...

Pas rreth gjysmë shekulli kërkimesh të studiuesve shqiptarë vjen i mirëseardhur në letrat shqiptare ky punim shkencor i profesor doktor Nuri Abdiut mbi veprën “Psikologjia apo shkenca e shpirtit” të Hoxha Hasan Tahsinit, këtij rilindësit tonë, nga më të shquarit.

Ai u drejtohet të gjithëve, është një libër i hapur për cilindo, por atë mund ta përdorin në mënyrë të veçantë studentët e degëve të psikologjisë dhe të filozofisë, specialistët e fushave respektive, pedagogët e të gjitha kategorive, mësuesit e shkollave në mbarë vendin etj. Teksti i përkthimit brilant, besnik i origjinalit të veprës të shkruar nga vetë Hasan Tahsini, është sjellë tani në dorën tonë, në dispozicionin tonë. Është një përkthim i bërë nga një mjeshtër, siç ishte orientalisti Vexhi Buharaja.

Me këtë vepër, që i vjen e shumëpritur rrethit të lexuesve shqiptarë, kudo në trojet etnike apo në diasporë, jam i bindur se profesor doktor Nuri Abdiu do të zërë një vend të shquar në kohën tonë si i pari, apo ndër të parët studiues shkencorë të profesor Hoxha Hasan Tahsinit. Ai do të numërohet si një ndër Tahsinianët e parë. Kështu, me këtë emër, do t‘i quaja studiuesit e Hoxha Tahsinit, duke filluar nga Sami Frashëri e Naim Farshëri, për të vazhduar me një Riza Tefik e Dervish Hima e të tjerë që u përpoqën, duke filluar nga Rilindja e këtej, ta nxjerrin në dritë dhe ta vënë në vendin e merituar që i takon te ne në Shqipëri dhe në botë...

Çdo mëngjes kur shkoj në punë, rrugës më tërheq vëmendjen një tabelë rruge: “Profesor Bedri Dedja, akademik, dhe jepen vitet përkatëse të jetës së tij. Ka vdekur tani vonë, para 3-4 vjetësh. Është një tabelë e thjeshtë në atë pjesë të qytetit metropol të shqiptarëve, Tiranës, rreth 1 milionëshe, që quhet Selitë. Një ditë në universitetin “UFO”, ku jap mësim duke parë orarin, ndesha ballë për ballë profesor Nuri Abdiun. Mbante në dorë librin “Nëpër ravat e jetës” (kujtime) të Bedri Dedes. E shfletova dhe midis fletëve pashë një përkushtim: “Nuri Abdiut, kalorësit të psikologjisë..., me respekt autori 29.05.2001”. Libri ka dalë në vitin 2001 në të gjallë të tij. Ishte një befasi e këndshme për mua. Shihja pedagogun Nuri Abdiu të zbardhur nga pesha e viteve, gjithë vitalitet dhe ai përcaktim i profesor B. Dedes për të më dukej më se i goditur.

Zakonisht shkrime të tilla për njerëz të shkencës është e natyrshme të mbyllen me një stil akademik. Unë do të desha t‘i largohesha një gjëje të tillë dhe ta përfundoja këtë pasthënie me një mënyrë krejt tjetër... Do t‘i krahasoja personalitetet e fushës së psikologjisë me kalorësit e mesjetës. Ka diçka fisnike, madhështore e heroike prej tyre në ta...

Rruga e Arberit, Nr. 7 (15), korrik 2007.

NJË VIT MË PARË: Lidhja e Intelektualëve Dibranë organizon me rastin e 7 Marsit, një pasdite festive kushtuar Mësuesit të Popullit, Prof.dr. Nuri Abdiu

KRONIKE

Me datën 7 mars 2013 pasdite, në Hotel Tirana International, Shoqata e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, organizoi një pasdite festive, me rastin e Festës së Mësuesit, kushtuar "Mësuesit të Popullit", Prof . Nuri Abdiu. Kishin ardhur në këtë eveniment të rëndësishëm miq e shokë të Profesor Nuriut, kolegë e ish-studentë të tij, arsimtarë e veteranë të arsimit.

Sekretari i përgjithshëm i shoqatës LID, zoti Shpëtim Cami, në fjalën e hapjes përshëndeti të pranishmit, prezantoi qëllimin e këtij aktiviteti dhe uroi profesorin jo vetëm për 7 Marsin, Ditën e Mësuesit, por edhe për përvjetorin e lindjes së tij.

Mbi jetën dhe veprimtarinë e Prof. Nuri Abdiut ndër vite foli Prof.dr.Edlira Haxhiymeri. "Nuk e kisha aspak të lehtë, - tha ajo - të qëmtoja e të radhisja këto fjalë zemre, që edhe kështu mund të jenë të varfra përpara jetës dhe kontributit të Prof. Nuriut. Jeta e tij tepër aktive, kontributet e vyera, personaliteti i tij shumëdimensional, rrethi i gjerë i bashkëpunëtorëve, numri i madh i studentëve, fisi i madh dhe lidhjet e shumëfishta për arsye njerëzore, e bëjnë figurën e profesor Nuriut të dëshirueshme për ta hulumtuar, por edhe të vështirë për ta prezantuar në një mbrëmje si kjo".

Zonja Tefta Cami, ish ministre e Arsimit, në fjalën e saj e quajti Prof. Nuri Abdiun si një misionar i ngritjes së katedrës së psikologjisë në Shkodër, ku çdo gjë e nisi nga e para."Sot e them me bindje se Prof. Nuriu e ka sfiduar moshën".

Në emër të Universitetit jo publik "Albanian University" përshëndeti rektori i këtij universitetit zoti Pavli Kondo, i cili foli gjatë mbi periudhën kur Prof. Nuri Abdiu drejtonte Departamentin e Psikologjisë në këtë universitet. "Prof. Dr. Nuri Abdiu është themelues i Departamentit të Psikologjisë së Përgjithshme dhe drejtues shkencor i Fakultetit të Shkencave Sociale të Albanian University, është dhe do të mbetet një figurë e nderuar në fushën akademike ashtu dhe në atë shkencore si dhe një emër i nderuar në arsimin jo publik në vendin tonë", - tha në fjalën e tij rektori.

Zoti Shemsi Manjani, ish drejtues i arsimit të rrethit Dibër, bashkënxënës me i Prof. Nuriun, ngriti lart figurën e profesorit dhe të familjes së tij si një element që e lartëson akoma më shumë këtë emër të nderuar, jo vetëm të Dibrës por edhe të të gjithë Shqipërisë .

Një ndjesi të veçantë këtij aktiviteti i dha muzika e bukur e interpretuar me violinë dhe organo nga muzikantet e famshëm të familjes Qerimi.

Mes cicërimave të zogjve të dala nga violina dhe tufave me lule e mori fjalën Prof. Nuriu, i cili përshëndeti dhe falënderoi të gjithë të pranishmit, Kryesinë e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, ish kolegët e tij të Universitetit të Shkodrës, të Albanian University , miqtë, shokët , familjen, dhe sponsorin e këtij aktiviteti.

Në fund, moderatori i këtij aktiviteti, zoti Shpëtim Cami, i ftoi të pranishmit për të vazhduar urimet dhe përshëndetjet në koktejin e organizuar për këtë rast, ku të gjithë së bashku tokën gotat për festën e 7 Marsit dhe përvjetorin e lindjes së Prof. Nuri Abdiut.

Kjo veprimtari, ashtu si edhe shumë të tjera të shoqatës së Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, u sponsorizua nga zv/ kryetari i Shoqatës së LID, biznesmeni Musa Rriçku. / Korresp. Rr.A.



Mësuesi i mijëra mësuesve

Nga **Prof. Dr. EDLIRA HAXHIYMERI**

I nderuar profesor Nuriu!

Të nderuar familjarë, miq, bashkëpunëtorë, studentë dhe bashkëkohës të profesor Nuriut!

Eshtë një kënaqësi e veçantë për ne, veçanërisht për mua, që të kemi sot midis nesh "Mësuesin e Popullit", profesorin dhe doktorin e shkencave psikologjike, nënkryetarin e Shoqatës Mbarëkombëtare të Psikologëve, konsulentin e revistës shkencore "European Psychologist", njeriun e dekoruar me Urdhërin 'Naim Frashëri' të Klasit të Parë, Kryetarin e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, njeriun që flet bukur, që shkruan bukur, që paraqitet kudo me fisnikëri, Prof. Nuri Abdiun. Eshtë një rast i lumtur për të gjithë ne që të kremtojmë e festojmë së bashku 7 Marsin, Ditën e Mësuesit dhe 83 vjetorin e lindjes së profesorit të nderuar.

Ne, i nderuar profesor Nuriu, vendosëm të gëzojmë së bashku në ditën tuaj të lindjes. Ju, profesor i nderuar, dukeni sot shumë më i ri, më energjik, më sfidant se kurrë i viteve që regjistrohen formalisht në pasthëniet e librave tuaj, libra të cilat koha nuk do të mund t'i zverdhë kurrë.

Të nderuar pjesëmarrës! Më duhet të nënvizoj që në fillim se nuk e kisha aspak të lehtë të qëmtoja e të radhisja këto fjalë zemre që, edhe kështu, mund të jenë të varfra përpara jetës dhe kontributit të prof Nuriut. Jeta e tij tepër aktive, kontributet e vyera, personaliteti i tij shumëdimensional, rrethi i gjerë i bashkëpunëtorëve, numri i madh i studentëve, fisi i madh dhe lidhjet e shumëfishta për arsye njerëzore, e bëjnë figurën e profesor Nuriut intriguese dhe të dëshirueshme për ta hulumtuar, por edhe të vështirë për ta prezantuar në një mbrëmje si kjo.

Megjithatë, e kemi marrë rrezikun në sy dhe shpresojmë që t'ia dalim....

Çdo njëri prej nesh do të ishte fatlum që të përjetonte një ditë të tillë të shënuar mes një auditori të tillë të nderuar e të respektuar. Kam nderin dhe emocionin e veçantë të përcjell disa nga vlerësimet që të gjithë: bashkëpunëtorët, profesorët, shkencëtarët, studentët, të afërmit dhe familjarët kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë për profesor Nuriun!

Edhe pse kontributi shkencor, profesional, por edhe shoqëror i Prof. Nuriut është i pasur dhe i gjerë, më lejoni, të nderuar pjesëmarrës, të ndalem në disa momente të rëndësishme:

Profesor Nuri Abdiu bën pjesë në atë plejadë intelektualësh që vunë gurë themeli në arsimin kombëtar dhe luftuan pa ndërprerë për ta përsosur atë - mbi 50 vjet pedagog janë një jetë e tërë në shërbim të çështjes së madhe, arsimit kombëtar.

Shkodra dhe Instituti i Shkodrës (sot Universiteti Luigj Gurakuqi) janë vatra të arsimit kombëtar që mbushën Shqipërinë me mësues e mësuese dhe ku, pa dyshim, shquhet, qysh në krye të herës, si smerald, kontributi i padiskutueshëm dhe shumëdimensional i profesor Nuri Abdiut.

Prof. dr. Vehbi Hoti, në fund të parathënies "Psikologjia e Hasan Tahsinit", përgatitur nga Prof. Nuri Abdiu, nënvizon se Prof. Nuriu është nismëtari i studimit të historisë së mendimit psikologjik shqiptar, më i angazhuari dhe më i përkushtuari.

Akademiku Bedri Dedja,në "Dy fjalë si parathënie për librin e Nuri Abdiut "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar" (deri më 1939) (Tiranë, 2001) shprehet se: "Prof. dr. Nuri Abdiu është një nga studiuesit më të shquar shqiptar në fushën e psikologjisë.... Nuri Abdiu është hartuesi i parë i bibliografisë së punimeve shqiptare në lëmin e psikologjisë. Për veprën e prof. Nuri Abdiut "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1939) akademik Dedja nënvizon se ky libër voluminoz është përfundim logjik i pasionit shkencor të autorit, si hulumtues këmbëngulës, i përqendruar seriozisht në një temë me rëndësi historike kombëtare. Ajo është ... një vepër që pasuron literaturën tonë historike dhe shoqërore; vlerat e saj nuk kanë të bëjnë vetëm me zhvillimet arsimore të vendit tonë, me njohjen e tyre, me hapat që ka bërë shkolla shqipe, nga një etapë në një tjetër, por edhe me evolucionin e përgjithshëm të mendimit shkencor shqiptar, në përgjithësi dhe të mendimit politik, social e filozofik, në veçanti. Ky libër ka krijuar të gjitha premisat që në universitetet shqiptare të trevave të Ballkanit, që historia e psikologjisë kombëtare të futet tanimë si një disiplinë e veçantë në degët e fakulteteve përkatëse.

Prof. Pajazit Nushi, zv. Kryetari i Akademisë së Shkencave të Kosovës, në një letër drejtuar prof. Nuri Abdiut me rastin e 80 vjetorit të lindjes së tij do t'i drejtohej me shumë ngrohtësi dhe intimitet : "Me një dëshirë të përzemërt unë, Esmaja, Leonora, djemtë dhe familjet e tyre, sot nderojmë jo vetëm vitin e tetëdhjetë të lindjes së njeriut të



Ethem Qerimi gjatë një interpretimi me violinë në 83 vjetorin e Prof. Nuriut

ndershëm, të mençur dhe punëtor të palodhur, por duam të nderojmë edhe rëndësinë e veprave që mbushën këto vite dhe përbëjnë hallkën më të re të zhvillimit të mendimit psikologjik ndër shqiptarët. Me jetën dhe me veprat tuaja u bëre protagonisti më i dalluar i të përpjetës së mendimit psikologjik në Shqipëri dhe ndër të gjithë shqiptarët.Ndiej krenari që në gjirin e popullit shqiptar lindi dhe arriti të afirmohet një studiues i zhvillimit të mendimit psikologjik shqiptar dhe bukurisë zhvillimore të botës shqiptare. Duke përkujtuar dhe nderuar tetëdhjetëvjetorin e jetës dhe të aktivitetit tuaj, ne nderojmë atë personalitet që bëri shumë për mendimin psikologjik dhe zhvillimin e tij, por edhe si pedagog universitar i psikologjisë që keni vënë bazat e këtij mendimi në mësimet e larta të universiteteve shqipfolëse të viteve të gjysmës së dytë të shekullit njëzet duke u bërë nismëtar i studimit të historisë së mendimit psikologjik shqiptar".Më tej, Prof. Pajaziti nënvizonte "Jeta juaj e njerëzishme tetëdhejtë vjeçare dhe puna e palodhshme, e ndershme dhe frytëdhënëse u bë jetë e historisë së mendimit psikologjik ndër ne. Me angazhimet dhe kontributet tuaja, Ju, njëkohësisht, i dhatë kuptim zhvillimit tonë të gjithëmbarshëm. ....." Pajazit Nushi, (22/12/2010)

Alma Zenellari, poete, një ish studente e profesor Nuriut, do ta uronte nëpërmjet një poezie të ndjerë. Edhe emocionet e ndjesitë e saj po i ndajmë sonte me ju:

DIPTIK

Ma merr k'të breng, merrma me vete,
Në mundesh, merrma ankthin tim..
Ti thinjëpërndritur e gojëmbël,
I urt' (si) ati im...
Në mundesh brengën time merrma,
Dhe lotin kthema, valë...
Ti thinjëpërndritur e fisnik,
Të bardhë e ke çdo fjalë...

Një fjalë magjike, të ngrohtë e pres,
E pres të rrjedh' si uj' në krua,
E di tek zemra jote e fshehur,
Një fjalë e bardhë do jetë për mua...

Sa herë që ikën të ndjek nga pas,
Një krah pëllumbi mendimi im,
Të ndjek nga pas edhe kur vjen,
Një krah i brishtë pafluturim...

Je bregliqen ku çlodhen zogjtë,
Përplasin krahët, mërgon trishtimi,
Je det i ter' mistere plot,
Je oqean i thellë mendimi...

Të uroj me gjithë zemër jetë të gjatë...

Të nderuar pjesëmarrës!

Më lejoni që pas këtyre vlerësimeve të ngarkuara me emocione të shumta, të bëj një vështrim të shkurtër të rrugës që ka përshkuar Prof. Dr. Nuri Abdiun në këto 80 vite.

FAMILJA

Kur udhëton nga qyteti i vogël i Peshkopisë drejt Veriut, atje ku sapo kalon përroin e rrëmbyeshëm të Gjelagjoshtit, që zbret thikë nga mali i Korabit, shtrihet Sohodolli, njëri nga fshatrat më të mëdhenj të rrethit të Dibrës. Kushdo që kalon asaj ane kujton se pikërisht, në këtë fshat, u lind profesor Nuri Abdiu.

Profesor Nuriu lindi në 1 shkurt të vitit 1930 në një familje që jetën e përballonte vetëm me të ardhurat që siguronte nga bujqësia e blegtoria, si të gjithë banorët e fshatit të madh të Sohodollit.

Sohodolli thirrej fshat i madh jo për shtëpitë, tokat e banorët që kishte, por figurativisht, sepse ishte një nga fshatrat më me tradita në Dibër.

Këtu jetonte edhe fisi i Abdieve. Asokohe, në fshat jetonte një burrë i zgjuar, punëtor, bujar, sedërli tejmase por edhe përkrahës i të resë e përparimit, Haziz Abdia, babai i profesor Nuriut.

Gjulja, nëna e profesorit, ishte nga Vlesha, ose Teqja e Vleshës, siç përmendet nga anët tona. Ajo ishte rritur e edukuar në një familje patriotike, nga më të mëdhatë e zonës, në familjen e Sheh Halilit, i cili kujtohet e nderohet për kontributin e dhënë në fushën e arsimit e kulturës në Dibër.

Nga martesa e Hazizit me Gjulen erdhi në jetë i pari djalë, Nuriu, një shpresë për të ardhmen e familjes, i cili, me shpirtin e tij të madh dhe vizionin e qartë për të ardhmen, do të ndihmonte pa kursim vëllezërit Ismetin, Fehmiun, Sabriun dhe motrat Shahen, Kujtimen e Mejtapen.

ARSIMI

Profesor Nuriu ka mbaruar studimet e larta në Institutin Pedagogjik Shtetëror të Moskës, në specialitetin PEDAGOGJI-PSIKOLOGJI në vitin 1958, dhe ka marrë diplomën SHKËLQYESHËM duke iu dhënë kualifikimi "Pedagog i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë për shkollat pedagogjike, inspektor-metodist për shkollat fillore".

Në vitin 1973, Komisioni i Lartë i Atestimit Shkencor pranë K.M. i ka dhënë titullin shkencor "DOCENT".

Në vitin 1991 fiton gradën shkencore "DOKTOR I SHKENCAVE" me disertacionin: "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar (deri më 1939)".

Në vitin 1999 Komisioni i Kualifikimit Shkencor pranë KM, i ka dhënë titullin shkencor "PROFESOR".

AKTIVITETI

Profesor Nuriu mbart mbi shpatulla një aktivitet intensiv në fushën profesionale, pa hequr dorë asnjëherë nga mësimdhënia. Madje, e ka filluar mësimdhënien shumë herët në jetën e tij.Tek studionte në ish Bashkimin Sovjetik, bënte edhe punën e pedagogut të gjuhës shqipe në kurset e gjuhëve të huaja të Ministrisë së Punëve të Jashtme të ish Bashkimit Sovjetik. Sapo u kthye në atdhe, ai u emërua Pedagog i Psikologjisë dhe i Pedagogjisë në Institutin Pedagogjik Shkodër - Shtator 1958- dhjetor 1962, Zv.Drejtor për anën mësimore dhe shkencore dhe përgjegjës i komisionit Psikologji - Pedagogji në Institutin e Lartë Pedagogjik Shkodër (1962-1974); Zv.Drejtor i shkollës së mesme pedagogjike "Shejnaze Juka" Shkodër (1974-1977); Pedagog i Psikologjisë në Institutin e Lartë Pedagogjik, Shkodër (1977-1980); Shef i Katedrës së Psikologji - Pedagogjisë në Institutin e Lartë Pedagogjik Shkodër dhe i degës së Mësuesisë për Ciklin e Ulët (1981-1990); Gjatë kësaj periudhe, Prof. Nuriu zhvilloi edhe një cikël leksionesh mbi historinë e mendimit psikologjik shqiptar në kursin një-vjeçar pasuniversitar për psikologji-pedagogji në Universitetin e Tiranës (1982-1988). Në periudhën 1990-1993 ka punuar si Pedagog i Psikologjisë në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër; dhe në Shkurt 1993 e nxjerrin në pension.

Por Profesor Nuriu nuk e pushon aktivitetin e tij mësimdhënës dhe kontributin në fushën e kërkimit.

Ai zhvillon leksionet e psikologjisë së përgjithshme në Fakultetin Pedagogjik dhe Filologjik të Universitetit të Tetovës (Tetor 1996- tetor 2005); dhe vazhdon të mbajë leksione të psikologjisë së përgjithshme në Universitetin e Tiranës.

Profesor Nuriu angazhohet si Drejtues i Departamentit të Psikologjisë në Universitetin jo publik Albanian University në periudhën Gusht 2006–shkurt 2012.

Në Shkurt 2012 deri në fund të vitit akademik 2011-2012 punon si Zv. Dekan për anën shkencore i Fakultetit të Shkencave Shoqërore në Albanain University.

BOTIMET

Ashtu sikurse në mësimdhënie, profesor Nuriu ka një kontribut të shquar në fushën e botimeve psikologjike e pedagogjike. Në mënyrë të përmbledhur do të përmendnim disa prej tyre si:

Vepra e tij kryesore është, pa dyshim, studimi "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptar" (gjer më 1939), botuar më 2002 dhe ribotuar më 2010, i cili përbën një kontribut të veçantë në përgjithësimin e përvojës sonë kombëtare në fushën e mendimit psikologjik shqiptar. Më 2007 botoi monografinë "Psikologjia e Hasan Tahsinit"; "Bibliografia e punimeve shqiptare në lëmin e psikologjisë", është botuar më 1986 dhe ribotuar më 2011;

Është autor edhe i disa monografive me përmasa më të vogla, të botuara në revista e përmbledhje shkencore.

Lista e punimeve shkencore, studimeve, kumtimeve shkencore dhe artikujve arrin në mbi 170 zëra.Shumë prej tyre janë botuar në organe shkencore dhe mbajtur në sesione të ndryshme shkencore, lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, si në Kongresin VI Europian të Psikologjisë (Romë 1999), në Prishtinë, Gjakovë, etj.

Është bashkautor në 7 tekste të psikologjisë, 4 për shkollat e larta, 1 për kursin pasuniversitar dhe 2 për shkollat e mesme pedagogjike;

Profesor Nuriu ka qenë dhe është anëtar i një numri të konsiderueshëm shoqatash profesionale, këshillash dhe bordesh, me të drejta vendimmarrjeje, që nga vitet e para të aktivitetit të tij.

Për gjithë kontributine tij të vyer në fushën e arsimit shqiptar emri i Prof. Nuriut është një zë i veçantë në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar (botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë - 2008). Përveç kontributeve që përmenden edhe më lart, në Enciklopedi theksohet se profesor Nuriu ka statusin e këshilltarit botues në revistën shkencore "European Psychologist" (psikologu europian).

TITUJ NDERI

Profesor Nuriu mbart edhe disa tituj nderi të akorduara nga Kuvendi Popullor si "Medaljen e Punës", të akorduar më 1968; Urdhërin "Naim Frashëri" të KLASIT TË PARË, të akorduar më 1980; titullin "MËSUES I MERITUAR", të akorduar më1987; dhe titullin "MËSUES I POPULLIT", akorduar më 1989.

Për të qenë sa më objektiv në vlerësimin e figurës shumëdimensionale të profesor Nuri Abdiut, e gjykuam të arsyeshme t'ju referohemi vlerësimeve të disa specialistëve të fushës.

KOLEGËT

Ju lutëm prof. Hamit Boriçi të na thoshte diçka për figurën e profesor Nuriut. Mes emocionesh, sigurisht të kuptueshme,nuk

(Vijon në faqen 10)



Mes familjarëve dhe kolegëve

"Personalisht pedagogu, personaliteti i të cilit ka ndikuar tek unë dhe është kthyer në modelin që dua të ndjek është ai i Prof. dr. Nuri Abdiut, pasi mbart vlera profesionale, por mbi të gjitha vlera humane, të brendësuara brenda atyre akademike, të cilat më kanë tërhequr më tepër ndaj tij. Profesor Nuriu është pedagogu që jep e kërkon, duke të respektuar njëkohësisht".

ARDIT XHAFKOLLARI, student

Mësuesi i mijëra mësuesve

(Vijon nga faqja 9)

ngurroi të shprehte kënaqësinë për organizimin e këtij aktiviteti në respekt të veprës, kontributit dhe vlerave të profesor Nuriut. Ndër të tjera, profesor Hamit Boriçi na tha: "Prof. Nuri Abdiu ka qënë dhe mbetet një nga personalitetet e fushës së psikologjisë dhe pedagogjisë, bashkëkohës dhe bashkëpunëtor i akademikëve e profesorëve të shquar Hamit Beqja e Bedri Dedja.

Me profesorët Hamit Beqja dhe Bedri Dedja, Prof. Nuriu ka konsultuar dhe vlerësuar kontributet dhe trashëgiminë e pandërprerë në fushën e psikologjisë e të pedagogjisë shqiptare. Të tre këta dijetarë kanë dalë nga e njëjta shkollë dhe kanë reflektuar idetë më përparimtare të kohës në fushën e mendimit pedagogjik dhe psikologjik, duke lënë gjurmë të thella në zhvillimin e këtyre degëve; në të njëjtën kohë si mësues, edukator, si veprimtarë në fushën e kërkimit shkencor, Prof. Nuriu mbart mbi supe kontribute të vyera e të pashlyeshme. Emri i profesor Nuriut, si edhe ai i dy profesoreve të tjerë të nderuar, janë në piadestalin e mendimit pedagogjik e psikologjik shqiptar"- do ta mbyllte vlerësimin e tij profesor Hamit Boriçi.

BASHKËPUNËTORËT

Duke kërkuar mes vlerësimeve të bashkëpunëtorëve të fushës, na ra në dorë libri i Musa Krajës "Mësuesi, pedagogu, personaliteti, etika e tyre". Faqet 3-4 i janë kushtuar profesor Nuriut. Po shkëpus pak radhë nga ky liber, ku autori e vlerëson profesor Nuriun si: "Mësues i mijëra mësuesve dhe pse jo edhe i disa dhjetëra profesorëve" (f.. 698), "Aftësitë organizative, të hershme dhe të reja, janë një provë se këto kanë qenë e janë në natyrën e profesor Nuriut, i cili aq mjeshtërisht ka tërhequr dhe tërheq opinionet, idetë dhe pikëpamjet e kolegëve në fushën shoqërore dhe profesionale. Serioziteti në punën hulumtuese, kërkimore e shkencore, as i nxituar, as i vonuar, duke zbatuar një metodologji shkencore në hulumtimet e traditës dhe të problemeve psikologjike aktuale, e ka bërë që produktet shkencore të përfunduara t'i pasqyrojë në brendinë e leksioneve dhe seminareve që drejton, me theks bashkëkohor krijues, të cilat vërehen edhe në veprat që ka publikuar vitet e fundit. ...Këto, vazhdon më tej Prof. Musa Kraja janë disa aspekte të personalitetit dhe të etikës profesionale të Profesorit Nuri Abdiut, i cili në vepren e tij aplikative mbetet një shembull ku janë ndërthurur natyrshëm tiparet themelore të etikës profesionale të një pedagogu bashkëkohor-modern, me gjithë vitet e gjata në sherbim, të cilat nuk e kanë zbehur vitalitetin e tij intelektual dhe profesional...". (f.699-700)

STUDENTËT

Studenti Ardit Xhafkollari, në një detyrë kursi, titulluar "Ndikimi i personalitetit të mësuesit dhe pedagogut tek nxënësit e studentët", në f. 7, do të shkruante: "Personalisht pedagogu, personaliteti i të cilit ka ndikuar tek unë dhe është kthyer në modelin që dua të ndjek është ai i Prof. dr. Nuri Abdiu, pasi mbart vlera profesionale, por mbi të gjitha vlera humane, të brendësuara brënda atyre akademike, të cilat më kanë tërhequr më tepër ndaj tij. Profesor Nuriu është pedagogu që jep e kërkon, duke të respektuar njëkohësisht". Më tej ai shton: "Kujtoj vitin e pare, kur fillova mësimin në universitet. Isha i topitur dhe disi i mpakur në mendimet e mia dhe gati t'i dorëzohesha fatit të keq, por personaliteti i profesor Nuriu Abdiut m'u bë mbështetje. Ndonjëherë ai i ngjan atij të mbinjeriut që nuk plaket asnjëherë.Forca dhe vitaliteti i tij më kanë dhënë kurajon që vështirësitë e jetës t'i shoh me syrin e luftëtarit. Jam krenar që e kam njohur dhe pavarësisht nëse arrij diçka në studimet e mia për psikologji, kam fituar shumë, dashurinë për jetën dhe kjo falë personalitetit të profesor dr. Nuri Abdiut".

TË AFËRMIT

Në angazhimin për të gjetur një vlerësim nga njerëz të afërt të profesorit, ju drejtuam çiftit Sami dhe Kumrie Shehu. Kumria, "Mësuese e merituar" do të nënvizonte se:"Kur bisedon me profesor Nuriun në telefon dëgjon një zë të ëmbël, të qeshur, të dashur e përkëdhelës. Nuk t'i kursen as komplimentat, të cilat i kanë aq hije. Kur është nevoja, të jep kurajë e merr prej tij një këshillë me vlerë të sinqertë. Mund të them me bindje se në rrethin tonë të gjërë familjar, Nuriu është më i vlerësuari. Ai e meriton plotësisht thënien e të madhit Tolstoi se "dashuria për të afërmit është zbukurimi më i madh i njeriut".

Në respekt të këtyre vlerave të rralla njerëzore të profesor Nuriut, do ta mbyllja këtë fjalë duke ju cituar disa vargje të Jorgo Bllacit (i njohur si Esenini shqiptar):

Askërkënd se kujtoj për keq në botë,
Në zemrën time shteg të mbyllur s'ka,
Mjafton një fjalë e urtë, fjalë e ngrohtë,
Të më bësh prap mik e prap vëlla.

Ky është profesor Nuri Abdiu!

E.Haxhiymeri

Nuri Abdiu, njeriu i përkushtur...

Nga **Prof. Dr. BASHKIM LLESHI**

Për Profesor Nuri Abdiun kam dëgjuar të flitej që në vitet gjashtëdhjetë kur punonte në Institutin Pedagogjik të Shkodrës. Unë atëherë isha student në Universitetin e Tiranës dhe vëllait tim të vogël, Zabitit, pasi mbaroi gjimnazin 3 vjeçar të Durrësit, i doli e drejta e studimit për të vazhduar në Institutin Pedagogjik të Shkodrës. Ai, që në moshë të re merrej me sportin e gjimnastikës dhe kishte dëshirë të studjonte në Tiranë në Institutin e Fiskulturës ose në degën Histori Gjeografi që u hap në Tiranë në ato vite. Meqënëse kishte dëshirë të ndronte degën e të vinte në Tiranë, xhaxhai im Shefkiu, i cili kishte dëgjuar për dibranin e shquar Nuri Abdiun që ishte në Shkodër, i premtoi nipit të tij Zabitit se do të shkonte edhe vetë në Shkodër e do të takonte profesor Nuriun për t'i ndrruar degën e për të ardhur me studime në Tiranë. Sa vajti në Shkodër, u paraqit te profesori dibran Nuri Abdiu, që e mori edhe në shtëpi dhe, pasi e dëgjoi hallin që kishte i tha se do të bënte të pamundurën që nipin e tij ta dërgonte në Institutin 2 vjeçar në Tiranë. Unë isha me pushimet e verës në Zogje kur xhaxhai Shefkiu u kthye nga Shkodra dhe fliste me një respekt të veçantë për pritjen që i kishte bërë profesor Nuriu në Shkodër. Në fillim të shtatorit erdhi përgjigja se ishte miratuar ndrimi i degës së Zabitit.

Edhe më vonë kam dëgjuar për kontributin e madh të Profesor Nuri Abdiut si pedagog i shquar e drejtues i zoti, duke u bërë një nga psikologët më të shquar të vendit tonë, duke u radhitur krahas me figurat më të shquara të vendit në fushën e Pedagogji-Psikologjisë profesorëve Hamit Beqja e Bedri Dedja.

Kontaktet direkte me profesor Nuri Abdiun i kam patur kur ai erdhi në Tiranë dhe në maj të vitit 2006 më ftoi pranë grupit organizator të krijimit të Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë", ku në mbledhjen e parë e zgjodhëm Kryetar të kësaj shoqate. Që në ditët e para vumë re tek profesor Nuriu njeriun e përkushtur për të kryer me korrektësi e përpikmëri çdo detyrë që merrte përsipër. Me shembullin e tij ai na vinte në sedër edhe ne, anëtarëve të tjerë të kryesisë së kësaj shoqate që të aktivizoheshim.

Nga fundi i vitit 2006 unë i propozova profesor Nuriut që të përgatisnim një aktivitet shkencor për sensibilizimin e opinionit qytetar e shtetëror për fillimin e punës për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, rrugës aq të dëshiruar të dibranëve në shekuj. Ai menjëherë mblodhi kryesinë e shoqatës dhe ia filluam nga puna për përgatitjen e një Kuvendi Tekniko-Shkencor, të cilin e mbajtëm në muajin maj të vitit 2007. Nën drejtimin e profesor Nuriut e organizuam këtë kuvend tekniko-shkencor ku u aktivizuan shumë studiues e intelektualë dibranë e jo dibranë dhe referuan për historinë dhe leverdishmërinë e ndërtimit të kësaj rruge.Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe organi i saj në vitet e para gazeta "Rruga e Arbërit" kanë dhënë një konrtibut të veçantë për fillimin në vitin 2008 dhe vazhdimin më vonë të ndërtimit të disa segmenteve të Rrugës së Arbërit. Përpjekjet për vazhdimin e punës në Rrugën e Arbërit ai nuk i ndau deri në fund të jetës së tij. Edhe një muaj para ndarjes nga jeta ai nënshkroi së bashku me kryetarin e Shoqatës "Nisma Dibrane", Bujar Karoshin një peticion të cilin e dërguan në qeveri e ministrinë përkatëse ku propozonin për disa përmirësime që duhen bërë në projektet e veprave kryesorë të kësaj rruge, si tunelet e urat që vazhdimi i punimeve në këtë rrugë t'u përgjigjet kërkesave bashkëkohore të ndërtimit të një rruge europiane.

Që në ditët e para vumë re tek profesor Nuriu, njeriun e përkushtur për të kryer me korrektësi e përpikmëri çdo detyrë që merrte përsipër. Me shembullin e tij ai na vinte në sedër edhe ne, anëtarëve të tjerë të kryesisë së kësaj Shoqate që të aktivizoheshim.

Përpjekjet për vazhdimin e punës në Rrugën e Arbërit ai nuk i ndau deri në fund të jetës së tij. Edhe një muaj para ndarjes nga jeta ai nënshkroi një letër, të cilën e dërguam në qeveri e ministrinë përkatëse, ku propozonin për disa përmirësime që duhen bërë në projektet e veprave kryesorë të kësaj rruge, si tunelet e urat që vazhdimi i punimeve në këtë rrugë t'u përgjigjet kërkesave bashkëkohore të ndërtimit të një rruge europiane.

Fjala e mbajtur në hapjen e Kuvendit Tekniko-Shkencor,
Tiranë më, 26. 05. 2007

Të gjithë së bashku për begatimin e Dibrës

Nga Prof. Dr. NURI ABDIU*



Të gjithë së bashku për të diskutuar për Rrugën e Arbërit, për perspektivën që i hap ndërtimi i saj zhvillimit dhe begatimit të njërës nga krahinat më vitale të Kombit me një histori shumë të vjetër dhe shumë të pasur, Dibrës sonë, zhvillim ky që paraqet interes të veçantë dhe do të rrezatojë në të gjitha trevat përreth.

Qëllimi kryesor i këtij Kuvendi, është argumentimi i domosdoshmërisë për fillimin e ndërtimit të kësaj rruge, sa të jetë e mundur më parë. Është sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i mëtejshëm, gjithëpërfshirës i shoqatave, i deputetëve e pushtetarëve, i intelektualëve e biznesmenëve dibranë, duke praktikuar me efikasitetin e duhur të gjitha rrugët dhe mjetet demokratike. Ne sot mendojmë të miratojmë edhe një rezolutë, që do t'ia dërgojmë Qeverisë, ku të kërkojmë që t'i jepet e drejta që i takon popullit të qarkut të Dibrës dhe të gjitha krahinave, nëpër të cilat ajo do të kalojë, për të udhëtuar normalisht; e drejta për zhvillim, prosperitet, etj.

Ndjehem tepër i nderuar që në emër të Kryesisë së Shoqatës LID dhe të shoqatave të tjera dibrane, që kanë marrë pjesë në organizimin e këtij kuvendi të rëndësishëm, t'ju uroj mirëseardhjen.

Kuvendi ynë Tekniko – Shkencor, që po mbajmë, nuk është caktuar rastësisht për në ditën e sotme. Kjo ditë përkon me njëvjetorin e promovimit të shoqatës sonë Lidhja e Intelektualëve Dibranë, që u bë më 27 maj të vitit 2006.

Siç e shihni, ne sot përkujtojmë edhe njëvjetorin e saj. Periudha njëvjeçare, flet për atë që LID ka një histori të shkurtër, por, LID ka një parahistori më të gjatë dhe një veprimtari të shënuar. Ka një parahistori më të gjatë, sepse, grupi nismëtar për themelimin e saj e kishte filluar veprimtarinë e vet që në muajin maj të vitit 2004.

Gjithashtu, jo rastësisht edhe gazetës sonë të pavarur ia kemi vënë emrin "Rruga e Arbërit". Dhe ajo këtë emër po e justifikon dhe e meriton plotësisht, sepse që në nr. 1 të saj që doli më 27 maj 2006 e në vazhdim, i ka bërë jehonë Rrugës së Arbërit. Gjithashtu, dhe fillimin e punës për ndërtimin e saj, që ka qenë, e deri më sot mbetet ëndrra shekullore e dibranëve, e konsiderojmë si detyrën më kryesore, jo vetëm të Shoqatës sonë, por si një shqetësim mbarëdibrane. Prandaj, për organizimin bashkërisht të këtij Kuvendi, ftuam edhe shoqatat e tjera dibrane, të cilat edhe më përpara, kishin dhënë kontributin e tyre për sensibilizimin e opinionit qytetar e shtetëror, për ndërtimin e kësaj rruge. Ju shprehim falënderime, si për pjesëmarrjen, ashtu dhe për sugjerimet e mendimet e tyre të vyera.

Qëllimi kryesor i këtij Kuvendi, është argumentimi i domosdoshmërisë për fillimin e ndërtimit të kësaj rruge, sa të jetë e mundur më parë. Është sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi i mëtejshëm, gjithëpërfshirës i shoqatave, i deputetëve e pushtetarëve, i intelektualëve e biznesmenëve dibranë, duke praktikuar me efikasitetin e duhur të gjitha rrugët dhe mjetet demokratike. Ne sot mendojmë të miratojmë edhe një rezolutë, që do t'ia dërgojmë Qeverisë, ku të kërkojmë që t'i jepet e drejta që i takon popullit të qarkut të Dibrës dhe të gjitha krahinave, nëpër të cilat ajo do të kalojë, për të udhëtuar normalisht; e drejta për zhvillim, prosperitet, etj.

E veçanta e Kuvendit tonë është se me nismën e intelektualëve dibranë, nga të dyja anët e kufirit, mblidhemi të gjithë së bashku për të diskutuar për Rrugën e Arbërit, për perspektivën që i hap ndërtimi i saj zhvillimit dhe begatimit të njërës nga krahinat më vitale të Kombit me një histori shumë të vjetër dhe shumë të pasur, Dibrës sonë, zhvillim ky që paraqet interes të veçantë dhe do të rrezatojë në të gjitha trevat përreth.

Ky Kuvend, përveç të tjerash është edhe dëshmi e vitalitetit të intelektualëve tanë, e vetëdijes së tyre profesionale, e përkushtimit atdhetar dhe e idealeve të tyre kombëtare.

Në të, jo vetëm marrin pjesë, por japin dhe ndihmesën e tyre të vyer, specialistë të studimit dhe të ndërtimit të rrugëve si nga Gostivari e Tetova, ashtu dhe nga Dibra e Madhe, etj; për të ndriçuar e vërtetuar shkencërisht, domosdoshmërinë e ndërtimit dhe vlerat e kësaj rruge, si për Republikën e Shqipërisë, ashtu dhe për Republikën e Maqedonisë e më gjerë.

Organizmi i këtij tubimi shkencor, padyshim, përbën një ndërmarrje serioze dhe nuk mund të realizohej pa ndihmën e madhe të biznesmenëve dibranë që kanë sponsorizuar përgatitjen dhe mbajtjen e tij, nuk mund të realizohej dhe pa ndihmën e specialistëve dibranë, që kanë përgatitur materialet e këtij kuvendi. I falënderojmë për ndihmesën dhe punën cilësore që kanë bërë!

Në mënyrë të veçantë falënderojmë specialistët nga Tetova, Shefki Aliti e Llazo Cakar, që pranuan ftesën tonë dhe do të referojnë në këtë kuvend, për vazhdimin e kësaj rruge në territorin e Maqedonisë; studiuesin e vjetër, Prof. Dr. Valter Shtyllën, që do të referojë për lashtësinë e kësaj rruge, Dr. e shkencave, Inxh. Farruk Kabën, që do të paraqesë një përmbledhje të Studimit të Fizibilitetit të kësaj rruge, të miratuar në Këshillin Kombëtar të Rrugëve, që në korrik të vitit 2004, si dhe gjithë grupin e Studimit të Fizibilitetit, e në veçanti Inxhinjerin e vjetër Piro Bedo, specialistin Edmond Alite, anëtarë të këtij grupi, si dhe specialistët dibranë, që kanë marrë pjesë në këtë grup studimi, Bashkim Lleshin, Orhan Sakiqin dhe Tefik Jegenin, gjeologun matjan Agim Shenjatari, që do të referojë për Resurset (prurjet) e Matit që vihen në lëvizje me ndërtimin e rrugës së Arbërit, gjeologët dibranë Vesel Hoxha, Ilir Alliu, Naim Karaj e Sefedin Shabani që kanë përgatitur Referatin për zhvillimin që do të marrin pasuritë e rajonit të Dibrës me ndërtimin e kësaj rruge dhe gjeologun e vjetër dibran, Avni Dibra, që ka marrë pjesë në përgatitjen e referatit për zhvillimin që do të marrë turizmi malor, veror e dimëror dhe ai historik.

Falënderojmë, gjithashtu, anëtarët e Komisionit Qendror organizues të këtij kuvendi, Komisionit Tekniko – Shkencor, sponsorët kryesorë , biznesmenët: Rakip Suli, Sadri Abazi, Musa Riçku, Shaban Bitri, Preng Doçi dhe, gjithë biznesmenët e tjerë që i kemi shënuar në ftesë dhe në banderolën e këtij aktiviteti; operatorin e palodhur Sami Selishta, që ka përgatitur dokumentarin për Rrugën e Arbërit; kryeredaktorin e gazetës "Rruga e Arbërit" Shaqir Skarra, nismëtarin dhe organizuesin kryesor të tij, specialistin e vjetër dibran Bashkim Lleshi, e djalin e palodhur e të talentuar të Dibrës Bujar Karoshi, të cilët, kanë përgatitur, redaktuar e sistemuar për botim e referim të gjitha materialet e Kuvendit, si edhe gjithë dibranët e tjerë që na kanë ndihmuar për mbarëvajtjen e këtij Kuvendi.

Ndërtimi i rrugës së Arbërit, do të përbëjë një hop të vërtetë në jetën e rajoneve nga do të kalojë edhe shumë më gjerë.

Duke ju falënderuar të gjithëve edhe për vërejtjet, sugjerimet e mendimet me vlerë që do të na jepni, në emër të kryesisë së LID në Tiranë, i uroj këtij Kuvendi punë të mbarë!

Të nderuar pjesëmarrës, dhe tani, para se të fillojmë me kumtesat e përgatitura, më lejoni t'u prezantoj mysafirët tanë që na kanë nderuar me praninë e tyre në këtë kuvend:

NGA MAQEDONIA: z. Agron Buxhaku, deputet në Kuvendin e Maqedonisë, ish ministër i transporteve, z. Argëtim Fida, kryetar i Komunës Dibër, z. Nizamedin Prapaniku, kryetar i këshillit komunal të Dibrës, z. Shehat Marku, kryetar nderi i Shoqatës "Votra dibrane" në Dibër të Madhe, zShefki Aliti, projektues gjenaral i autostradës "Rruga e Arbërit" dhe autostradave kryesore në Maqedoni, z. Turhan Rusi e Z. Arben Rusi, etj., si dhe deputetët: z.Sali Shehu, z Sadri Abazi, z. Rrahim Kaleci, z. Xhafer Seiti, Prefekti i Dibrës, , Z. Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë së Peshkopisë, z. Roland Keta, kryetari i Bashkisë së Bulqizës, z. Adil Neziraj, drejtorin e përgjithshëm te gjeologjisë, etj.



"Dibra do të dijë të mbetet përherë Universitet"

Fjala e kryetarit të LID, Prof.Dr. Nuri Abdiu, mbajtur në Sesionin Shkencor "Dibra me sytë e të huajve"

"Dibra jonë me historinë e saj, me gjuhën dhe dialektin, folklorin dhe të folmen e saj karakteristike, me gjeografinë dhe konfiguracionin, me etnokulturën dhe etnopsikologjinë e saj, me burimet, veçoritë e saj ekonomike dhe modalitetet e mjeshtëritë e shfrytëzimit të tyre. Veçmas, Dibra me mençurinë e saj karakteristike, Dibra e nëntë maleve, shtatë teqeve, shumë xhamive, kishave dhe vlerave të tjera unikale të saj, ka joshur e tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve të vendeve të ndryshme të botës, që nga shekulli V p.e.s, kur historiani i Greqisë së lashtë Herodoti përmend fisin e doberëve (dmth të dibranëve) e deri te misionarët anglezë Rexhinald Hiberti, Julian Emeri, etj., që kaluan nëpër shumë vise të Dibrës gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Edhe Dibra, kjo nënë e rreptë trimash, madje trimash të mençur e të ditur, ashtu si shumë treva të tjera shqiptare, ka qenë gjithnjë vlera e kërkuar, për njohjen dhe fitimin e së cilës janë përpjekur shumë burra të ditur të kombeve të huaja.

Shpresa e njohjes dhe më pas e zotërimit të saj, jo rrallë ka ngjallur ambiciet dhe ka ndezur zilitë e tyre, të cilat kanë pasur deri në përpjekjet e vazhdueshme në lëmin e tregtisë, të diplomacisë dhe deri në luftë për të siguruar pushtimin e saj.

Fati i një territori me rëndësi strategjike e vlera të tjera... si Dibra, në të cilën banorët e maleve përmes shekujve kanë qenë mbrojtur nga natyra e thyer dhe e ashpër e truallit të tyre, nuk kish si të mos u interesonte dhe të mos ishte forcë tërheqëse për studiues, arkeologë, gazetarë, etnografë, e të tjerë, vizitorë nga shumë vende të Evropës e më gjerë.

Të gjitha ata që kaluan nëpër Dibër e që ishin jo pak, por disa dhe që vinin nga Gjermania, Austria, Italia, Serbia, Hungaria, Franca, Anglia, Rusia, Bullgaria, vendet e Lindjes së Mesme, etj., nuk i solli rastësia, nuk kaluan nëpër vendin tonë dhe nuk u fokusuan në Dibër për "tebdil hava", si i thonë fjalës, por për realizimin e qëllimeve dhe të detyrave që u ishin ngarkuar.

Shumë prej tyre vëzhguan e hulumtuan me mençuri, aftësitë dhe virtytet dibrane, trimërinë, zgjuarsinë e mprehtësinë e tyre që shpalosej, veçmas odave e sofrave, kuvendeve e takimeve, në festa, dasma e morte, në ditë besëlidhjesh e falje gjaqesh.

Ata i testuan dibranët dhe, në përgjithësi i vlerësuan, me dashamirësi e objektivitet.

Madje, mjeshtërisht, shënuan e përshkruan, përgjithësuan me vërtetësi dhe botuan e pasqyruan në veprat e tyre gjithçka që panë, perceptuan, konceptuan e interpretuan, natyrisht, secili sipas profesionit, prirjeve dhe interesave të tyre intelektuale, për studime të ndryshme gjuhësore, ekonomike, sociale, etnografike, etnopsikologjike, etj.

Përfitoj nga ky rast, që në emër të LID, në shenjë mirënjohjeje të thellë e të përhershme, t'u shpreh ndjenjat e konsideratës së lartë dhe nderim të veçantë kujtimit të të gjithë atyre udhëtarëve misionarë, studiuesve specialistë të fushave të ndryshme, që në vëzhgimet e botimet e tyre, pasqyruan drejt dhe saktë gjithçka që panë (dhe prekën) në Dibër me sytë e tyre dhe për gjithçka që ata mësuan prej odave auditorë të "Universitetit" dibran dhe prej "ojnave" e ojnakëve, dhe prej gjithë hapësirës gjeo dhe etnokulturore ekzotike dibrane.

Dibra do të dijë të mbetet përherë Universitet për të huajt, tamam ashtu siç e ka cilësuar z.Julian Emeri (Ameri), i deleguari i Qeverisë Angleze gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, i cili, në një intervistë dhënë në RTSH, me 1 tetor 1991, ndër të tjera është shprehur: "Dibra ishte veçanërisht shumë interesante. Unë kam studiuar në Oksford. Por Dibra ishte për mua një universitet tjetër, më i rëndësishëm. Në Dibër mësuam politike më tepër se kudo..."

Në përgjithësi, dibranët, sipas tyre, ashtu si dhe bashkëkombas të tjerë, kanë treguar gjatë gjithë jetës se janë të zotët, edhe me kordhë, edhe me penë, edhe me trimëri, edhe me mend e me dituri. Dibra ka nxjerrë shumë njerëz të shquar e me nam të madh.

Pikërisht për këtë, në jubileun e dytë të veprimtarisë së saj, Shoqata jonë LID, e shtyrë nga ndjenja e përgjegjësisë dhe vetëdija profesionale, për të pasqyruar në mënyrë sa më të plotë edhe këtë tablo të kontributit të dibranëve në zhvillimet historike-kulturore mbarëshqiptare, për të nxjerrë në pah disa nga veçantitë, specifikat e historisë, kulturës dhe trashëgimisë etnokulturore të kësaj treve, organizon sot këtë sesion shkencor me temë: "Dibra me sytë e të huajve".

Në këtë sesion ne synojmë që të krijojmë edhe një lidhje e komunikim sa më të ngushtë e cilësor midis brezave të ndryshëm të dibranëve, kudo që ata jetojnë e punojnë në kushtet e globalizimit bashkëkohor.

E veçanta e këtij sesioni është përpjekja e bërë, që rikrijimin e imazhit të Dibrës dhe të dibranëve, mendësive dhe kulturës së saj ta bëjmë në mënyrë sa më të paanshme, duke lënë që ta flasin dokumentet dhe studimet e jodibranëve dhe të të huajve.

Të nderuar pjesëmarrës! Veprimtaria që zhvillojmë sot dhe pjesëmarrja në të dëshmon se ne të gjithë e shohim Dibrën nënë edhe me sytë tanë, me sytë e dibranëve.

Organizimi i këtij sesioni, që përbën një veprimtari serioze, nuk mund të realizohej pa ndihmën e madhe të biznesmenëve dibranë që kanë sponsorizuar përgatitjen dhe mbajtjen e tij. Nuk mund të realizohej dhe pa ndihmën e specialistëve që përgatitën kumtesat, historianëve, antropologëve, etnologëve, filozofëve, muzikologëve, gjuhëtarëve të njohur e të tjerë. Të gjithë këta i falënderojmë thellësisht për ndihmën bujare dhe për punën cilësore që kanë bërë."

GAZETA "RRUGA E ARBERIT", NR. (6)26, QERSHOR 2008

Respekt për delegatët e Kongresit

Përshëndetje e Prof. Nuri Abdiut në Akademinë Solemne, organizuar në Dibër të Madhe më 23-24 Korrik 2009, me rastin e 100-vjetorit të Kongresit të Dibrës (1909-2009)

Dibranët gjatë përpjekjeve të tyre të pareshtura, luftërave heroike për të mbijetuar, për ruajtjen e identitetit etnik, kombëtar krijuan edhe kulturën e traditën e vet. Burrat e ditur të Dibrës, duke mësuar nga përvoja e mendimi shkencor i vendit të tyre dhe i vendeve të tjera, janë përpjekur e kanë dhënë kontributin e tyre modest edhe në zhvillimin e kulturës dhe të dijes kombëtare dhe më gjerë.

Dihet se vlerat e një populli nuk mund të maten vetëm me kriteret materiale apo formulat e zhvillimit ekonomi dhe të ardhurat e njerëzve. Vlerat e një populli qëndrojnë po aq edhe tek historia e traditat e përcjella në brezat; kultura e pasur dhe figurat e tij.

Kështu ndodh edhe me vlerat e një krahine, siç është Dibra jonë e shtrenjtë, Dibra e Nëntë Maleve, e Shtatë Teqeve dhe Katër Oxhaqeve, e cila, në pozicionimin verilindor të Shqipërisë thonë se përbën një mrekulli të natyrës dhe një kështjellë të historisë. Ajo u shpalos si një nga trevat e nxehta të atdhedashurisë, kulturës kombëtare dhe zhvillimeve progresive në shekuj, në ditët tona dhe në vijim.

Dibranët i kanë pasur dhe i kanë në traditën e tyre tubimet, kuvendet, besëlidhjet e kongreset. E një ndër to është edhe Kongresi i Dibrës që na ka mbledhur sit në këtë Akademi Solemne, në të cilën, unë kam nderin të përshëndes në emër të Shoqatës LID në Tiranë dhe t'ju sjell urimet e tyre më të përzemërta në këtë ditë të shënuar me rëndësi historike, jo vetëm për Dibrën tonë, por për mbarë Kombin Shqiptar.

Kongresi i Dibrës, i mbajtur 100 vjet më parë, pikërisht në këtë qytet, në djepin e dijes e të trimërisë legjendare, të cilës edhe në ditët e sotme i këndohen këngët që mbajnë erë baroti e që ruajnë gjurmë gjaku; që dibranët nuk e kursyen asnjëherë në luftërat e tyre për liri e pavarësi. Kongresi i Dibrës, ndër të tjera, vuri në rend të ditës realizimin e vendimeve të Kongresit të Manastirit për gjuhën dhe për shkollën shqipe, shpalli kërkesat që do të çonin në jetësimin e autonomisë së vendit; kërkesat për nëpunës që dinin gjuhën shqipe dhe që njihnin e respektonin zakonet shqiptare, etj.

Unë, në emër të Shoqatës LID, nga kjo foltore e nderuar, përulem me respekt të veçantë në kujtim të emrave të të gjithë delegatëve të Kongresit, që e treguan veten shqiptarë të vërtetë dhe qëndruan pa u epur përballë reaksionit xhonturk dhe atyre që e përkrahën atë. Me këtë rast, më lejoni të shpreh përnderime dhe homazhe për delegatët e atij Kongresi që nuk ishin nga Dibra, si: Hafis Ali Korça, Abdyl Ypi, Qenan Manastiri dhe gjithë të tjerëve.

GAZETA "RRUGA E ARBERIT", NR. (7)39, KORRIK 2009

cyan magenta yellow black



Duke folur në një veprimtari të organizuar nga LID me rastin e Ditës së Mësuesit, (7 Mars 2010)



Në mbledhjen themeluese të shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë



Së bashku me anëtarë të kryesisë së LID, gjatë një takimi me kampionin e botës, Ismail Keta



Duke folur në Asamblenë e Përgjithshme të LID, dhjetor 2009

NAIM PLAKU

Nuri Abdiut

Shkodra të njohu dhe të nderoi
Vite me radhë,
një jetë të tërë, o Profesor,
dhe prapë ai zëri yt i ëmbël
kumbon në auditor.
Eh, sa mësues në qindra shkolla
shpërndarë nëpër atdhe.
-Përse,
pse jeni kaq të mirë, vallë?-
u themi ne.
Dhe vënë buzën në gaz,
e çelin fytyrën si ylberi pas shiut,
e të thonë me krenari:
-Jemi nxënësit e Profesor Nuriut?

Baladë nga Mevlud Buci

Dritë e diturisë - Nuri Abdiu

Dhe Korabi i lashtë - dhimbjen e përcolli
dhe Drini i Zi më fort oshëtiu
u nda nga jeta një bir Sohodolli
Korifeu i arsimit - Nuri Abdiu...

Me dritën e shpirtit na fali mirësinë
me dritën e mendjes na fali dije ne
në gen e pati ai psikologjinë
Hasan Tahsini i kohës së re.

Hasan Tahsini i kohës së re
ndër breza do t'i ndriçojë penda
o bir i Dibrës - Profesor Korife
përmallim e dritë na ndez tek zemra.

Përmallim e dritë na ndez tek zemra
u ndriçon epokave - ishte shpirt njeriu
breznive do t'u flasin veprat, penda
drit'e diturisë, o Nuri Abdiu!

Takimi i fundit me shokët e fëmijërisë

Takim i brezit të vuajtjeve, sakrificave dhe ëndrrave



Janë nxënësit e shkollës unike të Peshkopisë të vitit 1946. Një vit më parë, më 1945-sën ishte hapur shkolla unike. Ndërsa këtë vit, shkolla u bë më konvikt dhe mblodhi nxënës nga gjithë Dibra dhe Mati. Në këtë takim pas 67 vitesh janë të paktë. Nga 35 nxënës të klasës, në takimin e nëntorit kanë ardhur vetëm 8: Nuri Abdiu, Riza Lika, Fiqrete Shehu, Nusrete Shehu, Ismet Bellova, Shemsi Manjani,Rexhep Klosi dhe Mendu Dema.

Para 67 vitesh janë takuar për herë të parë. Atëherë ishin fëmijë. Tani mosha dhe hallet i kanë lodhur pak, por një dritë mirësie i ndez nga brenda. Takohen në një kafe në fillim të Rrugës së Durrësit, dhe pastaj ulen në një lokal, larg zhurmës dhe rrëmujës. Ndërsa pyesin për familjet dhe fëmijët e njëri-tjetrit, porosisin kafe dhe ujë. Pastaj kujtohen për ekspresin e fortë dhe ndërrojnë mendje: "Më mira na i bëj makiato more djalë!"

Janë nxënësit e shkollës unike të Peshkopisë të vitit 1946. Një vit më parë, më 1945-sën ishte hapur shkolla unike. Ndërsa këtë vit, shkolla u bë më konvikt dhe mblodhi nxënës nga gjithë Dibra dhe Mati. Në këtë takim pas 67 vitesh janë të paktë. Nga 35 nxënës të klasës, në takimin e nëntorit kanë ardhur vetëm 8: Nuri Abdiu, Riza Lika, Fiqrete Shehu, Nusrete Shehu, Ismet Bellova, Shemsi Manjani,Rexhep Klosi dhe Mendu Dema.

Nuriu ka marrë nga shtëpia pak raki. Asnjëri nuk e pi. Rizai e ka lënë që kur është dehur njëherë kur ishte me studime në Rusi.

Në fillim pyesin për shëndetin e njëri-tjetrit, për fëmijët, të shumtët i kanë jashtë. Malli për ta dhe brengat e prindërve për fëmijët, megjithëse nuk shprehet, ndjehet. Por shprehin edhe gëzimin që ëndrrat e tyre janë realizuar, deri diku. Fëmijët e tyre janë të suksesshëm në fushat ku punojnë dhe jetojnë, dhe për këtë, megjithëse i kanë larg, gëzohen!

E veçanta e këtij takimi është Fiqreti. Ajo ka qenë vetëm një vit në klasën e tyre, pastaj iku për të vazhduar jetën diku në Durrës.

Nuriu ka marrë me vetë disa fotografi, mes të cilave, një foto e klasës së tyre në vitin 1949. "Po bëj apelin, thotë Nuriu dhe lexon emrat në fotografi (foto më lart): Poshtë (nga e majta në të djathtë), ulur tre vajzat e klasës; Hava Shehu, Vera Nura (Muça) dhe Nusrete Shehu (Haxhiymeri). Në rreshtin e dytë: Rremzi Dema, Nazmi Tafaj, Shemsi Manjani,Shefqet Uka, Menduh Dema, Ibrahim Dervishi, Bashkim Kukeli. Në rreshtin e tretë: Ahmet Alliu, Ismet Bellova, drejtori i shkollës Mehmet Çadri, mësuesi kujdestar Islam Vani, Selami Muglica, Mehdi Kaba, Hasan Dervishi dhe Ramazan Muça. Ndërsa në rreshtin e katërt Zenel Kazhani, Riza Lika, Riza Manjani, Mehmet Ceni, Izet Bajrami, Nuri Abdiu, Rexhe Klosi, Esat Caka dhe Mithat Shehu.

Në këtë foto mungojnë Fiqrete Shehu, Bardhyl Cami, Ali Koçeku, Ismet Neziri, Xhavit Spata, Haki Ndreu, Lutfi Mehmeti dhe Riza Fejza.

Pas bërjes së apelit, një minutë heshtje është homazhi dhe respekti për shokët e tyre që nuk jetojnë më...

Ndërsa lexohen emrat, si në apel dikur, secili kujton një detaj nga shokët e klasës, dikush nuk kujton ndonjë emër, për ndonjërin nuk kanë dëgjuar për vite me radhë. Kujtojnë Bardhyl Camin nga Dibra e Madhe, i cili me mbylljen e kufirit më 1948 iku te familja e tij dhe nuk u panë më. Nuri Abdiu thotë se Bardhyli ishte nxënësi më i mirë i klasës. I vazhdoi studimet në ish-Jugosllavi dhe u bë drejtor i gjimnazit në Dibër të Madhe. Pastaj kujtojnë Xhavit Spatën, Ali Koçekun, Hava Shehun, të cilët pasi mbaruan semimaturën, klasën e tretë, filluan punë si mësues dhe krijuan profilin e tyre të suksesshëm në arsim, duke edukuar dhjetëra breza. Fiqretia kujton lënien e shkollës dhe vazhdimin e një jete të re, po ashtu si Lutfi Mehmeti dhe Riza Fejza. Ndërsa Haki Ndreu iku në Amerikë.

Në këtë takim nuk mbetën pa u kujtuar edhe mësuesit. Drejtorin e parë të unikes Edip Tërshana, drejtorin e tyre Mehmet Çadri. Po ashtu edhe mësuesin Hysni Merkaj që jepte lëndët e gjuhës shqipe, historisë dhe gjeografisë; Martin Jakovën, mësuesin shkodran të vizatimit; Luigj Bojanin, gjithashtu nga Shkodra, mësuesin e fiskulturës; Islam Vanin dhe Muharrem Toncin, mësuesit e historisë dhe gjeografisë; Hasan Rrapin dhe Mustafa Shahinajn, mësuesit e gjuhës shqipe. Nuk lënë pa kujtuar edhe mësuesit që kanë patur në klasën e II-të, Kadri Kajni (matematikë), Ded Gajtanin (shkencat biologjike), Fadil Hafizin, (histori), Reshit Kasharin (matematikë) apo edhe drejtorin e parë të pedagogjikes Rexhep Kadzadej nga Elbasani që u mësonte Kimi. Sigurisht, nuk lënë pa kujtuar edhe drejtorin e konviktit, korçarin Nuri Përrenjasi.

Kujtimet kanë brenda nostalgji, dhimbje, mall, naivitet fëmijëror. "Ishim fëmijë, kujton Shemsi Manjani. Ne iknim nga shkolla bashkë më një shokun tim, dhe të nesërmen babai na kthente sërish në shkollë, vendosur në kosha të kalit..." "Mbi 75 përqind e fëmijëve vinin nga fshati, nga gjithë Dibra dhe Mati. Konvikti ishte i vështirë. Ushqimi ishte me racion. Familjarët na sillnin ndonjëherë ushqime nga shtëpia. I ndanim mes shokëve..."

Kjo klasë ka nxjerrë personalitete të njohura. Shumë prej tyre studiuan jashtë. Në Moskë vazhduan studimet Riza Lika për Ekonomi, Nuri Abdiu për Psikologji - Pedagogji, Izet Bajrami për Histori. I ndjeri Riza Manjani studioi në Bullgari për histori. Kujtojnë me mall edhe Vera Muçën, Ramzan Muçën, Xhavit Spatën, të cilët patën një karrierë të suksesshme në fushat e tyre të punës. Kjo klasë ka nxjerrë edhe dy profesorë doktorë, Nuri Abdiun dhe Ismet Bellovën, të cilët janë nderuar edhe me titullin "Mësues të Popullit", apo edhe Hava Shehun, Mësuese e Merituar. Nga kjo klasë kanë dalë mjekët e njohur Rexhep Klosi, Ahmet Alliu dhe Zenel Kazhani.



Ne foto: Nga e majta në të djathtë: Ismet Bellova, Mendu Dema, Rexhep Klosi, Nusrete Shehu, Nuri Abdiu, Fiqrete Shehu, Riza Lika dhe Shemsi Manjani. Foto: B.Karoshi

Shemsi Manjani është njëri nga organizatorët e takimit. Tregon shkurtimisht për jetën e tij, sidomos për 20 vitet e fundit. Humbjen e bashkëshortes e kujton me hidhërim, por ndjehet gëzimi në sukseset e fëmijëve, Sokolit dhe Teutës. Shemsiu ka qenë për rreth një dekadë shef i drejtorisë arsimore të Dibrës, drejtor i gjimnazit dhe pedagogjikes si dhe kryeredaktor i gazetës lokale "Ushtima e Maleve".

Pas tij flet Riza Lika. Ai jeton në Amerikë. Si në pleqëri, ka kohë dhe merret me veprimtari atdhetare. Drejton atje shoqatën "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", por jetën familjare e ndan mes Neë Yorkut dhe Moskës, ku jetojnë dhe punojnë djali dhe vajza.

Për jetën e tyre, flasin edhe Fiqrete Shehu - vajza e tregtarit dhe dibranit të mirënjohur Ymer Maliqit; Nusret Shehu, e shoqja e Tahir Haxhiymerit, docent dhe pedagog në fakultetin e inxhinierisë.

Doktori Rexhep Klosi më shumë mundohet ti kuptojë shokët e tij nga mimika dhe lëvizja e buzëve, pasi dëgjon më vështirësi. Ndërsa bisedës i jep ton të lartë Ismet Bellova, i cili pas çdo shqiptimi të fjalëve të kujton fushat e futbollit. Ismeti dhe Bashkim Kukeli pas unikes ndoqën shkollën dhe institutin e fizkulturës, duke e lidhur kështu karrierën përjetësisht me fushat e blerta.

Tetë shokët e shkollës unike e pinë makiaton e ftohtë në këto ditë nëntori. Filxhani dhe biskotat mbi tavolinë ishin vetëm një zbukurim i tavolinës, sepse ngrohtësia, kujtimet, respekti dhe dashuria për njëri-tjetrin i ngrohu më shumë se çdo gjë. Duke dëshmuar se ata ishin jo vetëm një brez i vuajtjeve dhe sakrificave, por edhe një brez i ëndrrave plot shpresë!

Bujar Karoshi

Nuri Abdiu ka dhënë një kontribut të papërsëritshëm në fushën e psikologjisë

Nga TEFTA CAMI*

I nderuar profesor Nuri Abdiu!

Të nderuar të pranishëm, familjarë, kolegë, miq e bashkëpunëtorë të profesor Nuriut!

Ndjehem e nderuar që më jepet fjala, por jam edhe e ndrojtur nëse do të mund të flas ashtu siç e meriton me të vërtetë për kontributin e shquar që ka dhënë profesori i papërsëritshëm i psikologjisë Nuri Abdiu. Me punën e kontributin e tij ai është e do të jetë një institucion shkencor e pikë reference për të gjithë studiuesit në fushën e psikologjisë brenda e jashtë vendit.

Plejada e profesor Nuri Abdiut qe me fat. U arsimuan dhe u përgatitën nga ana shkencore jashtë shtetit, siç qe edhe vet prof. Abdiu në BS dhe kryen me dashuri e profesionalizëm misionin e madh e të vështirë të ngritjes nga e para të institucioneve të larta arsimore e shkencore, siç qenë edhe katedrat e pedagogjisë e të psikologjisë dhe institutet e larta pedagogjike e deri tek Universiteti Shtetëror i Tiranës. Prandaj do ta vlerësoj Prof. Abdiun në radhët e misionarëve të parë të ngritjes nga e parë të katedrës së pedagogji-psikologjisë dhe të Institutit të Lartë Pedagogjik katër vjeçare " Luigj Gurakuqi " të Shkodrës si dhe të zhvillimit të procesit të arsimimit, të specializimit e kualifikimit pasuniversitarë të qindra e qindra specialistëve në fushat e psikologjisë.

Si ndër misionarët e parë në fushat përkatëse Prof. Nuriut i takoi detyra që ta fillonin çdo gjë nga e para, siç qenë hartimi i programeve e leksioneve, i teksteve të psikologjisë e pedagogjisë për shkollat e mesme e të larta, si dhe për kualifikimin e mësuesve dhe specializimet pasuniversitar në Universitetin e Shkodrës dhe në Universitetin e Tiranës.

Vlerësohet si hartuesi i parë i Bibliografisë së punimeve shqiptare në fushat e psikologjisë dhe si hartuesi i historikut të mendimit psikologjik shqiptar deri në vitin '39, duke studiuar grumbulluar mendimin shkencor psikologjik më të përparuar shqiptar me metoda shkencore bashkohore, duke shtruar një trase të gjerë e të pasur të mendimit psikologjik shqiptar.

Mendimi e kontributi në fushat e psikologjisë i përfshirë në shumë botime u ka shërbyer e u shërben studentëve e specializantëve shqiptarë të të gjitha Universiteteve shqiptare brenda e jashtë kufijve të RSH, të RK dhe të viseve të tjera shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi dhe të Preshevës e Bujanovcit dhe të Medvegjës, duke u udhëhequr nga motoja se jemi një komb dhe kemi një psikologji kombëtare dhe duhet te kemi një formim e edukim psikologjik kombëtar e bashkëkohor europian të brezave të rinj, duke ecur në rrugën e gjithëpërfshirjes të mendimit bashkëkohor psikologjik shqiptar e europian dhe duke ruajtur karakterin e individualitetin tonë kombëtar edhe në kuadrin e integrimeve rajonale e europiane, si dhe të zhvillimeve globale e nomandizimit të shoqërisë njerëzore.

Profesor Nuriu është vlerësuar me shumë tituj e medalje si dhe me titullin më të lartë në fushën e arsimit shqiptar "Mësues i Popullit". Ligjësitë e metodologjinë shkencore në fushat e psikologjisë e të pedagogjisë i ka aplikuar në praktikë gjatë veprimtarisë mësimore e shkencore, duke eksperimentuar e pasuruar në praktikë me vlerat më të shquara të kombit shqiptarë. Të gjitha studimet e prurjet shkencore pasqyrojnë ecurinë e botës psikologjike të kombit tonë në ato nivele intelektuale, saqë mund të pohojmë,se ka ardhur koha që nuk mund të përdoret më kombi shqiptar si mish për top, për t'u ngjallur frikën fqinjëve, sepse kemi qenë dhe jemi një nga popujt që kemi aspiruar e aspirojmë paqe e stabilitet. Prandaj prioritet, si gjithmonë, kanë synimet e studimet që të vlerësohen e afirmohen vlerat më të shquara intelektuale të të gjitha fushave të kulturës e të shkencave, sepse njihemi si kombi më i lashtë në gadishullin Ilirik dhe në Europë.

Profesor Nuriun e çmojmë dhe e vlerësojmë së bashku me familjen e tij. Familja e Prof. Nuriut është e njohur si një familje fisnike dhe e shquar në krahinën e Dibrës. Prof.Nuriu është i lindur e i rritur nga prindër të fjalës e të besës, me vëllezër e motra të arsimuar e të ngritur nga ana kulturore e shkencore, me znj. Fitnet, një bashkëshorte të përzgjedhur ideale e të kujdesshme, e cila pa mëdyshje është bashkëpunëtorja e natyrshme dhe efektive në të gjithë veprimtarinë Tuaj mësimore e shkencore profesor Nuriu. Është meritë e trashëgimisë familjare dhe e përkujdesit familjarë si të bashkëshortes e të fëmijëve tuaj të mrekullueshëm, si dhe e pasionit e vullnetit tuaj, që vazhdoni të jeni aq vital e krijues në veprimtaritë mësimore e shkencore si dhe në aktivitetet shoqërore. Ju e keni sfiduar moshën dhe, me siguri, do të vazhdoni ta sfidoni e të punoni edhe në të ardhmen. Prandaj dëshiroj t'ju uroj jetë të gjatë dhe veprimtari sa më aktive në shërbim të familjes dhe të shkencës së psikologjisë e të shkencave të tjera sociale! Ju uroj të gjithëve 7 Marsin, Ditën simbolike të Mësuesit e të arsimit tonë kombëtar!

** Ish ministre e Arsimit dhe e Kulturës së Shqipërisë. Përshëndetje e mbajtur në takimin e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, në Hotel International Tiranë, më 7 mars 2013*



Studentët tuaj dhe Dibra të kanë vendosur në krye të vendit

Nga SHEMSI MANJANI *

Të nderuar pjesëmarrës!

Kam kënaqësi të veçantë që në këtë 7 Mars mua, mësuesit veteran të Dibrës, më jepet rasti të uroj për ditëlindje shokun tim të fëmijërisë dhe të gjithë jetës, të mirënjohurin, Nuri Abdiu.

Është urim për 80-vjetorin, urim I veçantë për çdo njeri me jetëgjatësi për t'u admiruar, me bilance të shumta, për rastin konkret, me bilance e kontribute të pasura e të njohura nga unë, nga opinioni i shëndoshë shoqëror, të cilin pretendoj se e njoh, siç e njihni gjithashtu dhe ju, të nderuar pjesëmarrës.

Është urim për shokun e mikun tonë Nuri Abdiu, i cili, të gjitha moshat, fazat e momentet e jetës i kaloi me një shkëlqim të veçantë. Me shkëlqim si fëmijë, nxënës e student në shkollë, pedagog e drejtues në universitet. I veçantë e i rrallë është rasti, kur dhe 80-vjetori i lindjes, mosha e katërt, e gjen Nuriun tonë pedagog e drejtues në një nga universitetet më me emër në vendin tonë. Me shkëlqim si prind e familjar, si bashkëshort e vjehërr, si shok e mik me të gjithë ata që pati rastin të njihet.

E kam njohur Nuriun e dashur që kur ishim në të njëjtën klasë, klasën e parë unike, konviktorë në Peshkopi, në vitin 1946. Njohur e lidhur ngushtë si fëmijë. Që kur u krijua organizata e pionierit, e ne të dy anëtarë të shtabit, Nuriu udhëheqës me mendje, zemër e sjellje të dallueshme, të harmonizuara këto dhe me pamjen tërheqëse, harmonizim që e vërejmë dhe sot që e kemi përpara në moshë 80-vjeçare.

Vit pas viti u përballuam me konsideratat e opinionin e mirë për të në Dibër, Shkodër, më shumë në Tiranë, ku jemi më pranë, në disa raste dhe në disa vende fqinjë. Konsideratë do ta quaja unë rastin që kur planifikonim e dilnim për shëtitje, dështonim në biseda nga ndërprerjet që na bënin hap pas hapi kalimtarët, ish studentë të tij, për të takuar e përqafuar gjithë dashuri, pasion e përzemërsi Nuriun, përzemërsi e vërejtur dhe ndaj meje, sapo mësonin në prezantim nga Nuriu se isha dibran, shoku i tij i ngushtë i fëmijërisë. U kënaqem duke biseduar e duke kujtuar me Nuriun ngjarje nga e kaluara, shokët e shoqet, një pjesë e mirë e tyre të ndarë nga jeta prej vitesh. Shkurt, të mbetur në këtë moshë si lisa të gjatë, të rralluar, shumë të përmalluar, pa shokët e larguar. Nuriu – iniciator për të kujtuar e takuar ata që janë gjallë.

Nuk mund të mbyllet urimi pa uruar në këtë përvjetor të veçantë si festë familjare pjesëtarët e familjes, bashkëshorten shumë të nderuar, me të cilën kaluan e kalojnë jetën në harmoni të plotë, që lindën, rritën e edukuan fëmijë, bashkëshorten që me siguri ka ndikuar më shumë se kushdo te Nuriu, për të qenë ai që është sot. Uroj vajzat shumë të dashura e të kujdesshme ndaj prindërve deri në fund, dhe me më shumë dashuri në pleqëri, siç kemi provuar dhe ne të tjerët këtë dashuri e përkujdesje të veçantë. Nga kjo veçanti e vajzave, mençuria popullore është shprehur me fjalët: "Kush nuk ka vajzë, zëre se nuk ka fëmijë". Urime djalit të Nuriut! Për djalin dhëndër. Gjithashtu, siç e kemi provuar e mësuar nga mençuria e njerëzve të urtë: "Kush ka dhëndër të mirë, ka fituar një djalë, kush e ka të keq, ka humbur dhe vajzën!".

Uroj vëllezërit, motrat e Nuriut me fëmijët e tyre. Vëllezërit shumë të njohur prej meje, së afërmi. Të kujton ky fakt thënien e shkrimtarit me famë botërore, Gëte, në një nga veprat e tij: "Njerëzit formohen vetëm nga njerëzit, të mirët nga të mirët".

Urime të veçanta për të gjithë ju, shokët e miqtë e Nuriut që ndodheni këtu, jo vetëm si shokë e miq të tij, por dhe si të njohur e si njerëz me kontribute e virtyte.

Përfundoj duke iu drejtuar shumë shkurt drejtpërdrejt personit që na nderoi duke na ftuar e duke na bashkuar në këtë ceremoni të gëzueshme:

Nuri i dashur,

Urime të përzemërta, shumë të përzemërta, të përqendruara e të drejtuara tek shëndeti yt! Të tjerat i ke të sigurta e të siguruara vetë! Të jesh shumë krenar për jetën që ke bërë e po bën. Jetë që kaloi përmes virtytit, jetë që nuk i bëri keq askujt. Synime këto e të tjera të rëndësishme të jetës si te rrallëkush. Po ta theksoj me bindje të plotë se Dibra të ka vendosur në krye të vendit. Dhe jo vetëm Dibra, por dhe shumë ish-studentët tuaj, mësues apo në punë të tjera, të shpërndarë brenda apo jashtë vendit, të tjerë shokë e shoqe. Në krye të vendit ty të parafytyron dhe të kujton gjithkush. Madhështia jote ka për të spikatur gjithmonë në jetë të jetëve, sepse madhështia jote është madhështi larg alibive politike, larg vlerave false, që shkatërrojnë çdo komb, vlera false që nuk i pamë tek ti asnjëherë. Të lumtë!

Urime! Edhe 100 vite të tjera plot shëndet e mbarësi!

** Ish drejtor i arsimit në Dibër. Përshëndetje e mbajtur në takimin e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, në Hotel International, Tiranë, më 7 mars 2013*

Një vepër dinjitoze për historinë e mendimit psikologjik



Nga **Prof.Dr. VEHBI HOTI**

Prej vitesh kemi pasur rastin të nji hemi dhe të ndjekim punimet e Prof. Dr. Nuri Abdiut në fushën e historisë së mendimit psikologjik shqiptar. Ai është nismëtari i studimit të kësaj fushe në vendin tonë, më i angazhuari e më i përkushtuari , nga studiuesit shqiptarë për problemet e historisë së mendimit psikologjik.

Me një punë intensive e pasionante prej rreth katër dekadash ai ka çarë një rrugë të parrahur më parë nga studiues të tjerë, ka hedhur dritë mbi një traditë të hershme të mendësisë e të mendimit psikologjik shqiptar si pjesë përbërëse dhe e pandarë e kulturës dhe e jetës shpirtërore të popullit tonë, si tregues i vitalitetit i individualitetit të tij. Kjo ka qënë një ndërmarrje e madhe dhe e vështirë nga autori sepse ato janë realizuar në kushtet e një mungese pothuajse të plotë të studimeve të kësaj fushe, i është dashur të zgjedhë mjaft probleme si ato të gjetjes e të evidentimit të punimeve shqiptare të mirëfillta psikologjike ose me karakter psikologjik, të periodizimit të zhvillimit të këtij mendimi psikologjik, të terminologjisë së përdorur e interpretimeve përkatës, të ballafaqimeve me mendimin psikologjik bashkëkohor botëror, etj. Si studiues e kërkues këmbëngulës, Prof. Dr. Nuri Abdiu, porsi një bletë punëtore, ka arritur të mbledhë, të klasifikojë e të periodizojë, të studiojë e të sistemojë tërë trashëgiminë kombëtare në fushën e mendimit psikologjik, të publikuar në mbi 150 zëra me artikuj, referate, botime e kumtime brenda e jashtë vendit, duke filluar që nga viti 1969 me "Një vështrim historik mbi punimet shqiptare në fushën e psikologjisë", e duke ardhur tek monografia "Kontribute themelore në historinë e mendimit psikologjik shqiptarë (gjer më 1939)", botuar pak kohë më parë.

Tani ai po na prezantohet me një monografi tjetër "Psikologjia ose Dituri mbi shpirtin" të Hasan Tahsinit. Është një vepër e gatuar ndër vite, është rrjedhim i një pune shumëvjeçare, i formimit të gjerë psikologjik dhe i kulturës profesionale të tij, i dashurisë së thellë dhe i respektit të veçantë për atdhetarin e dijetarin e madh të Rilindjes sonë Kombëtare. Monografia përfaqëson studimin e parë serioz, të thelluar e tërësor të "Psikologjisë" të Hasan Tahsinit dhe përbën një ndihmesë të çmuar vetjake të autorit në studimet tona historikopsikologjike. Ajo mbart vlera të shumanshme, ndër të cilat po veçojmë disa prej tyre:

Së pari, "Psikologjia" e Hasan Tahsinit, ndonëse një vepër me përmasa të vogla, ajo përmban vlera të mëdha, të cilat, i ka trajtuar e paraqitur me mjaft mjeshtëri e kompetencë shkencore autori gjatë tërë monografisë. Për këto vlera të mëdha të saj mjafton të theksojmë argumentet e autorit se "Psikologjia" e H.Tahsinit është dokumenti dhe burimi i parë i mirëfillte dhe autentik psikologjik me të cilin zë fill psikologjia dhe historia, jo vetëm e psikologjisë shqiptare por edhe psikologjia e historia e psikologjisë në Perandorinë Osmane në gjysmën e dytë të shek. XIX.

Autori argumenton drejt e qartë se "Psikologjia" e H.Tahsinit megjithëse është shkruar në gjuhë të huaj, ajo përfaqëson një kontribut të shquar në historinë e psikologjisë shqiptare. Në monografi theksohet se mendimi psikologjik shqiptar i kultivuar që në hapat e para të tij, ka ecur me kohën,

ka ndjekur e përqafuar arritjet më bashkëkohore europiane. Aq më tepër e ka realizuar një gjë të tillë H.Tahsini i cili e njohu nga afër jetën, kulturën e shkencën perëndimore në një nga qendrat më përfaqësuese të saj, në Paris të Francës. Qoftë edhe vetëm për evidentimin dhe argumentimin e këtyre fakteve, monografia është e mirëpritur dhe shënon një kontribut të shquar për shkencën e psikologjisë shqiptare, për kulturën tonë kombëtare dhe më gjerë.

Për të arritur në hartimin e kësaj monografie ka ndikuar së tepërmi përvoja e gjatë e autorit si pedagog i lëndës së psikologjisë në disa universitete si në atë të Shkodrës, të Tiranës, të Tetovës, e së fundi edhe në një universitet jo publik, njohja e thellë e problemeve teorike të shkencës së psikologjisë dhe të historisë së saj, si në rrafshin kombëtar, ashtu dhe në atë botëror, kultura e gjerë psikologjike e shkencore që ai zotëron.

Së dyti, autori na ka dhënë përmasat e shquara e tepër të spikatura atdhetare e shkencore të personalitetit të H.Tahsinit. Në një sintezë elokuente na paraqitet H.Tahsini si një pjesëmarrës aktiv në lëvizjen çlirimtare shqiptare të kohës, nismëtar i krijimit të shoqatave atdhetare për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të shqiptarëve, përpjekjet e tij për zhvillimin e gjuhës shqipe, ngritjen e përhapjen e arsimit, si një nga hartuesit e Alfabetit të Stambollit. Njëherit, H.Tahsini na paraqitet si një dijetar i madh, erudit me interesa të gjëra shkencore, filozof, gjuhëtar, psikolog, krijues letrar, njeriu që e thoshte me kompetencë fjalën e vet në shumë fusha të shkencave natyrore, që kishte përvetësuar, jo vetëm kulturën e lindjes e filozofinë arabe por edhe kulturën europiane. Siç na informon autori, njohësit e studiuesit e kanë veçuar H.Tahsinin si një dijetar "më i lartë ndër të lartit" si "më i zoti filozof dhe dijetar i shek XIX", si një nga "mjeshtërit më të shquar të penës në fushën e poezisë", në Perandorinë Osmane, si "Lomonosovi i Turqisë", etj.

Por, veçoritë më thelbësore të personalitetit shkencor të H.Tahsini na i ka lënë të skalitura nxënësi i tij një figurë tjetër madhore atdhetare e shkencore e Rilindjes sonë, Sami Frashëri, kur në veprën e tij 'Enciklopedia" theksohet se H.Tahsini "Është një nga dijetarët e kohëve të fundit që njihte mirë shkencat pozitive dhe tradicionale si dhe shkencat e reja në gjuhët e lindjes e të perëndimit" edhe se "Jetën e tij e kaloi midis librave të shumtë dhe instrumenteve shkencorë, duke studiuar dhe duke dhënë mësim. Nuk u martua dhe nuk u mor me asgjë tjetër në botë përveç shkencës" Me cilësitë e larta shkencore e njerëzore, H.Tahsini u afirmua si një figurë madhore e kulturës e shkencës

shqiptare dhe njëherit si një nga përfaqësuesit më të shquar të shkencës turke dhe të arsimit të lartë të Perandorisë në shek. XIX, duke qenë edhe Rektori i parë i Universitetit të parë të Stambollit.

Së treti, Hasan Tahsini në veprën e vet ka trajtuar problemet më themelore të shkencës së psikologjisë në përgjithësi dhe, të shkencës së psikologjisë së përgjithshme, në veçanti. Këto probleme, autori i monografisë i ka organizuar, sistemuar e klasifikuar në disa drejtime, siç janë ato mbi objektin e psikologjisë e raportet e saj me filozofinë e logjikën, kuptimin mbi bazat materiale fiziologjike të psikikës të

lidhura ngushtë me funksionet e sistemit nervor e të organeve të shqisave, kuptimin mbi njeriun dhe ndryshim e tij nga kafsha, trajtimin e disa proceseve psikike, problemet mbi gjuhën, si një nga dukuritë shoqërore dhe raportet e saj me të folurit e të menduarit.

Në monografi argumentohet, drejt e saktë, fakti se H.Tahsini i ka trajtuar problemet themelore të psikologjisë përgjithësisht mbi baza natyrore e materialiste, se ai ka meritën e padiskutueshme se i dha psikologjisë që në fillimet e saj një orientim të qartë shkencor duke u mbështetur në të dhënat më të fundit të shkencave biologjike, anatomisë e të fiziologjisë së sistemit nervor. Një gjë e tillë nuk ishte e lehtë për H.Tahsinin ai gjendej përballë pushtetit teokratik të Perandorisë Osmane, përballë ideologjisë e botëkuptimit fetar që i jepnin tonin gjithë jetës shtetërore, arsimore e shoqërore. Në një masë të caktuar, në një farë mënyre, ai ishte, si të thuash, edhe përballë vetvetes, sepse nuk është plotësisht i liruar nga ndikimet fetare, aq më tepër po të kemi parasysh edhe faktin se për disa kohë e, në periudha të caktuara, H.Tahsini ushtroi edhe detyrën e hoxhës apo të imamit të xhamisë.

Në këto kushte të propagandoje dije të sakta mbi njeriun, ndërtimin e trupit të tij dhe prejardhjen shtazore nga "majmunët që u ngjajnë njerëzve", mbi raportin e shpirtit me sistemin nervor dhe psikikën si funksione të trurit, mbi rolin e mekanizmave nervore në lidhjen e trupit me botën e jashtme dhe rolin e shqisave në pasqyrimin e njohjen e botës, mbi aftësitë e jashtëzakonshme të njeriut, për të menduar e arsyetuar, për t'u bërë "zot mbi kafshët dhe për të vendosur pushtetin mbi natyrën", ta trajtosh gjuhën si një dukuri shoqërore dhe si një mjet komunikimi në mes njerëzve "për të shprehur atë që njeriu ka në mëndje e në zemër", etj; përbënte një akt të madh shkencor. Jo vetëm kaq. Të jesh hartues i një vepre që i bie ndesh filozofisë e botëkuptimit sundues të një perandorie të tërë, ishte edhe një akt tepër i guximshëm, vetëmohues, civilizues e revolucionarizues i mendimit shkencor në përgjithësi dhe i shkencës së psikologjisë, në veçanti. Dhe një të tillë e ka arritur në shkallën më të mirë të mundshme për kohën dijetari ynë Hasan Tahsini apo siç njihet gjerësisht me emrin Hoxhë Tahsini. Në mënyrë mjeshtërore, Prof.Dr. Nuri Abdiu ka arritur t'i nxjerrë e t'i argumentojë këto arritje e vlera të "Psikologjisë" së H.Tahsinit.

Së katërti, monografia dallohet për kulturën shkencore e kulturën gjuhësore me të cilën është shkruar. Autori ka arritur të na japë një botim të nivelit akademik në kuptimin e plotë të fjalës. Jo vetëm për kriteret mbi të cilat është hartuar, por edhe për faktin se jepet për herë të parë në mënyrë të plotë vepra "Psikologji" e H.Tahsinit në përkthimin e orientalistit të mirënjohur Vehxhi Buharaja, e shoqëruar me origjinalin e botimit në osmanisht.

Së pesti, monografia transmeton, (mbart) vlera të mëdha edukative që lidshhen me argumentimin e traditave shkencore e kulturore shqiptare, me kontributet e shquara shkencore që kanë dhënë dijetarët shqiptarë apo meorigjinë shqiptare edhe në fusha kaq të vështira e pak të lëvruara edhe në vendet europiane të shek XIX, siç është ajo e psikologjisë, se studiuesit tanë janë bërë edhe nismëtarë të studimeve e lëvrimeve shkencore edhe për vendet e tjera. Këtë bëri H.Tahsini me veprën "Psikologjia" në Perandorinë Osmane. Po këtë gjë, në të njëjtën kohë me të bëri në Itali, shkencëtari me origjinë shqiptare, arbëreshi Gabriel Bukola, mjek e psikiatër me famë botërore, i cili konsiderohet si themeluesi i psikologjisë eksperimentale në Itali. Kontributet psikologjike të G. Bukolës e plotësojnë dhe e bëjnë me interes të veçantë monografinë dhe i bëjnë më të spikatura vlerat e saj. Nuk ka se si të mos jesh krenar për faktin se studiuesit shqiptarë kanë qenë tepër të ndjeshëm ndaj arritjeve më të mira shkencore botërore, i kanë përvetësuar ato në mënyrë aktive e krijuese, i kanë transmetuar ato në dobi të shkencës e të kulturës njerëzore, qoftë asaj shqiptare, qoftë asaj të vendeve ku kanë jetuar e punuar. Dhe si shembulli më i mirë në këtë drejtim na paraqitet H.Tahsini. Vepra e tij është shprehje e qartë e rrezatimit kulturor, shkencor e intelektual të dijetarëve të shquar shqiptarë në kulturat e vëndeve të tjera.

Së gjashti, autori i monografisë është tepër i entuziazmuar nga vepra e H.Tahsinit dhe si të thuash i dashuruar pas saj. Ajo sikur e ka përpirë të tërin. Nuk kishte si të mos ishte i tillë, duke marrë parasysh kohën kur u shkrua "Psikologjia" e H.Tahsinit, vendin ku u botua, rrugën që hapi në një shkencë

Bibliografi e punimeve shqiptare të fushës së Psikologjisë

Puna studimore kërkon një mbështetje të fuqishme në burime të shumta të literaturës së botuar dhe në gjithë dokumentacionin tjetër shkencor, kërkon përvetësimin e gjithë atij bagazhi të madh njohurish dhe atij trashëgimi kulturor dhe shkencor që ka përpunaur njerëzimi, kërkon organizimin e një informacioni shkencor sa më të përsosur.

Realizimit të kësaj detyre të rëndësishme, mendojmë se do t'i shërbejë sadopak edhe plotësimi e ribotimi i kësaj bibliografie, e cila do të përbëjë një hallkë tjetër në tërë sistemin e informimit shkencor mbi të rejat dhe arritjet në shkencën e psikologjisë shqiptare.

Veçanërisht të mëdha janë detyrat që na dalin, lidhur me problemin e organizimit dhe të përsosjes së informacionit shkencor për bibliotekat e kategorive të ndryshme, si institucione kryesore bibliografike dhe departamenteve të psikologjisë e të punonjësve shkencorë për plotësimin e atyre mangësive që vihen re në këtë drejtim, për t'i ushqyer studiuesit e ndryshëm, pedagogët, mësuesit dhe studentët me burime bibliografike të panjohura, për t'i ndihmuar në punën kërkimore – shkencore të ndërmarrë prej tyre.

Punë më e gjerë dhe më e kualifikuar duhet bërë edhe për informacionin, nëpërmjet botimeve të ndryshme bibliografike retrospektive dhe bashkëkohore sipas profileve.

Bibliografia e psikologjisë, si çdo degë tjetër e bibliografisë, ka objektin e vet. Ajo studion zgjedhjen, përshkrimin, klasifikimin, sistemimin, metodikën e hetimit dhe të gjetjes, si dhe të zbulimit të përmbajtjes me anën e shënimeve dhe referimeve. Ajo është degë e dijes që merret me parimet, me kriteret dhe metodat e këtij përshkrimi e klasifikimi të veprave, punimeve, studimeve dhe artikujve nga rrafshi i dijes së psikologjisë, të botuara në organe të ndryshme ose si vëllime më vete.

Në veprimtarinë praktike, bibliografia e psikologjisë është pjesë e pandarë e punës studimore, me rëndësi të madhe njohëse dhe edukuese.

Në këtë bibliografi, siç shihet edhe nga përmbajtja, janë përfshirë edhe punime me aspekte të ndryshme nga fusha e gjerë e psikologjisë së përgjithshme, moshore, pedagogjike, të psikologjisë shoqërore, të psikologjisë kombëtare të popullit tonë (etnopsikologjisë) etj. Janë përfshirë gjithashtu përkthime dhe përshtatje të autorëve të huaj, të mirëfillta ose që lidhen me fushën e psikologjisë dhe degëve të saj, si dhe recensione, vlerësime kritike për tekste dhe punime të ndryshme psikologjike, etj.

Në këtë bibliografi, që është e para në llojin e vet, nuk pretendojmë se kemi bërë një paraqitje krejtësisht të plotë dhe shterues të punimeve që lidhen me problemet e psikologjisë.

> Kjo bibliografi do të ndihmojë departamentet, studiuesit tanë, veçanërisht ata të fushës së psikologjisë e të pedagogjisë dhe degëve të shumta të tyre, studentët dhe punonjësit e bibliotekave, që të gjejnë me lehtësi dhe në mënyrë sa më të plotë materialet dhe të dhënat që u nevojiten për studimet, punimet dhe botimet e tyre në këtë fushë.

> Bibliografia e punimeve shqiptare të fushës së Psikologjisë deri në vitin 2000 është një botim i plotësuar. Botimi i parë për përdorim të brendshëm, titulluar "Bibliografi e punimeve psikologjike e për psikologjinë, të botuara në vendin tonë para dhe pas Çlirimit" deri më 1985, është bërë nga Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës më 1986, me përkujdesjen e çmuar të z.Vili Kamsi

Shkalla e kërkimeve dhe e njohjes së dokumenteve dhe burimeve bibliografike nga ana jonë, si dhe paraqitja e klasifikimi i tyre nëpër treguesit përkatës, është në një nivel që lë ende për të dëshiruar e diskutuar.

Gjithashtu, nuk mund të mos theksojmë se dokumentacionin dhe burimet bibliografike të periudhës 1990-2000, nuk kemi mundur ta sigurojmë dhe ta shfrytëzojmë në masën e duhur, për çka i kërkojmë falje lexuesit.

Jemi të ndërgjegjshëm se lexuesit e kësaj bibliografie, sidomos specialistët e fushës së psikologjisë e të pedagogjisë, nuk mund të mos kenë sugjerime, vërejtje dhe kërkesa edhe në lidhje me klasifikimin dhe vendosjen e zërave të ndryshëm në këtë ose atë nënndarje.

Gjer më tani, një pjesë e punimeve dhe botimeve nga fusha e psikologjisë janë pasqyruar në vepra të ndryshme bibliografike, si në ato për problemet e zhvillimit të mëtejshëm të shkollës, ashtu edhe në ato të karakterit të përgjithshëm, të botuara në vendin tonë, qoftë para, qoftë edhe pas vitit 1944. Le të përmendim disa prej tyre, si: Manek-Pekmezi-Stotz (1909), E.Legrand (1912), H.Guys (1938), J.Kastrati (1955), ato të F.Tabakut, M.Fezgës, P.Dakës, V.Barutit, F.Lulit si dhe në "Bibliografia e librit shqip në fondet e Bibliotekës Kombëtare (1913-1944)" (2010), hartuar nga Maksim Gjinaj, Margarita Mele, Myrvete Elmazi etj. Punime dhe botime nga fusha e psikologjisë janë pasqyruar në mënyrë të veçantë në bibliografinë e periodikut e të librit shqip, si dhe në disa revista e botime të veçanta që, për vetë drejtimin e tyre, kanë botuar më shumë materiale të psikologjisë, si "Revista pedagogjike", "Edukimi parashkollor", etj.

Kjo bibliografi do të ndihmojë departamentet, studiuesit tanë, veçanërisht ata të fushës së psikologjisë e të pedagogjisë dhe degëve të shumta të tyre, studentët dhe punonjësit e bibliotekave, që të gjejnë me lehtësi dhe në mënyrë sa më të plotë materialet dhe të dhënat që u nevojiten për studimet, punimet dhe botimet e tyre në këtë fushë.

Bibliografia do të ndikojë gjithashtu edhe në zgjerimin e shkallës së njohjes në drejtim të asaj tradite të pasur edhe në fushën e mendimit psikologjik e të studimeve psikologjike shqiptare.

Kjo bibliografi është rezultat i punës shumëvjeçare që ka bërë dhe vazhdon të bëjë autori i saj mbi temën "Kontribute themelore në zhvillimin e mendimit psikologjik shqiptar gjer më 1939" si dhe i studimit "Mbi punimet shqiptare në fushën e psikologjisë pasçlirimit", etj.



Një vepër dinjitoze për historinë e mendimit psikologjik

të panjohur në Perandorinë Osmane dhe në Shqipëri, si dhe për problemet që trajton dhe nivelin e interpretimit të tyre. Me gjithë këtë ai është shumë i matur, tregohet rigoroz, përpiqet të jetë sa më objektiv, ta vërë veprën e H.Tahsinit në kohën e vet, në vendin e në nivelin e vet, me arritjet më të mira shkencore, por edhe me ndonjë kufizim, pasaktësi apo njëanshmëri në momente e probleme të caktuara.

Kështu gjatë monografisë vihet në dukje ndonjë mangësi trajtimi në krahasim me arritjet e sotme të psikologjisë shkencore, një farë ngushtimi a kufizimi të objektit të psikologjisë, ndonjë mangësi në trajtimin e funksioneve pasqyruese të psikikës, ndonjë moment lëkundjeje lidhur me natyrën e njeriut apo shfaqje të inkosekuencës filozofike që lidhej edhe me faktin se H.Tahsini nuk është plotësisht i lirë nga botëkuptimi dhe nga pikëpamjet fetare. Një gjë e tillë ka rritur karakterin dhe nivelin shkencor të monografisë dhe njëherit dëshmon qartë për seriozitetin dhe objektivitetin e autorit të saj.

Monografia e Prof.Dr Nuri Abdiu mbi psikologjinë e H.Tahsinit është një mesazh, përbën një apel për intelektualët shqiptarë, për rininë tonë që të rendin pas dijes, pas shkencës, pas të së vërtetës, me guxim e vetëmohim, për t'i vënë ato në shërbim të atdheut, të shoqërisë, synimeve e përpjekjeve për demokratizimin dhe europianizimin e Shqipërisë.

Prof. Dr. Nuri Abdiu, me monografinë që paraqet i bën një shërbim të rëndësishëm një rrethi të gjerë lexuesish e studiuesish, jo vetëm të fushës së psikologjisë por edhe të filozofisë, të sociologjisë, të gjuhësisë e të kulturës së popullit tonë, përgatitjes profesionale e ngritjes së kulturës psikologjike të mësuesve tanë. Aq më tepër sot, me rritjen e botimeve psikologjike, me ngritjen e degëve universitare të përgatitjes së psikologëve të mirëfilltë dhe organizimin e studimeve pasuniversitare në këtë fushë, ajo do të shërbejë për formimin më të mirë shkencor e psikologjik të të gjithë atyre që duan t'i përkushtohen psikologjisë, dijeve e kërkimit psikologjik.

Gazeta "Rruga e Arberit", Nr.5 (13), Maj 2007.



Vështrim gjeostrategjik i **Rrugës së Arbërit**

Nga **AZIS KETA**

HYRJE

Që kur lindi njeriu mbi tokë, në vartësi të kushteve dhe mjeteve, doli nevoja dhe domosdoshmëria për rrugë.

Në kushtet e Shqipërisë, në zonat rurale veçanërisht, transporti me kafshë, ishte dhe mbeti përcaktues nga antikiteti deri në Luftën e Dytë Botërore. Kjo, për mungesë burimesh e mjetesh për të përballuar nevojat e lëvizjes për kohë paqe e lufte.

Rrjeti rrugor automobilistik, deri në shek. XIX, ishte tepër i kufizuar, i pa mirëmbajtur, me mungesa të theksuara në shumicën e pjesëve të territorit.

Krejt ndryshe, vlerësimi dhe zhvillimi i rrjetit rrugor në lashtësi. Ndoshta, nevoja për mbijetesë, lëvizje, zhvillim dhe mbrojtje, solli atë mrekulli logjistike të kohës që e gjejmë në bosht të Rrugës Arbërit, aq sa, vihemi në dyshim: Mos vallë, mendja njerzore, edhe se në kohë moderne, krahasuar me kushtet dhe rrethanat e kohëve, ende, nuk e ka arritur atë shkallë zhvillimi intelektual të lashtësisë?

Mbështetur në këto burime, brenda fushës së ngushtë të profesionit dhe përvojës, jam përpjekur të gjej, lexoj, sitemoj, të bëj analizë, me synimin e ndonjë përfundimi modest se, cila është e vërteta midis asaj që propagandohet dhe faktit të rrugës Arbërit.

RUGA E RE ARBËRIT, NUK KA FILLUAR ASNJË CENTIMETER!

Opinioni publik, ka rënë viktimë e "planit mashtrimit" qeveritar të llogaritur deri në detaje, si aviacioni në Luftën e Dytë Botërore, që merrte maketet e topave si pozicione reale të artileriesë dhe bombardonte në drejtim të gabuar. Ruga e re Arbërit, nuk ka filluar asnjë centimeter!

Opinioni publik, i bombarduar me " artileri mashtrimi", ka marrë "Rrugë të Re Arbëri" një rrugë të rikostruktuar keq nga Bulqiza në Bllatë dhe një tjetër, paralel me ekzistuesen, që ju shërben fshatrave të Tiranës nga Brari në rrethina e Krujës, por ende jo, asnjë centimetër Dibrës.

Rruga e Arbërit, e reja, ajo vetëm 27 km, e kërkojnë tre rrethe të Shqipërisë: Dibër, Mat e Bulqizë, plus Dibra e Madhe shqiptare, Radika shqiptare, Dy Rekat shqiptare, Kërçova shqiptare, Gostivari shqiptar, Tetova dhe Ohri shqiptar, bashkë me rrethina Shkupi me shumicë shqiptare, por ende nuk ka filluar asnjë centimeter.

Një neglizhencë 50 vjeçare e sistemit që shkojë dhe mbi 20 vjeçare e kohës demokracisë, 12 vjet e premtuar, por asnjë centimeter e realizuar, as nga qeveritë e majta, as të djathta.

Kjo neglizhencë, deri në kufitë e absurdit që po i afrohet shekullit, ka patur dhe vazhdon të ketë pasoja komplekse.

RRUGA E ARBËRIT, "ATDHE I PARË" PËR TRE RRETHE TË SHQIPËRISË

Rruga e Arbërit, para se të jetë faktor gjeopolitik i kombit, vazhdon të mbetet "Atdhe i Parë" për Dibrën, Matin e Bulqizën, për Kërçovë, Ohër e Gostivar, deri në Shkup, ku ka me shumicë shqiptarë! Ura e Qytetit të Valikardhës, me arkitekturë të ngjashme dhe të lokalizuar në kohë me Urën e Vezirit (Bunguri); Ura e Vashës dhe Grazhdani i famshëm; kalatë në bosht, nga "Ohri i Dibrës" deri në Rodon, një provë më shumë pse kishim shtet dhe Rrugë Arbëri.

Traseja e rrugës Arbërit në dy akse paralele, kaq e maskuar, kaq e shkurtër në distance, kaq e fortifikuar, jo vetëm me "kështjellat qytete", por edhe me banesën "kullë, objekt banimi, objekt fortifikimi" (500 Vjet Fortifikim në Shqipëri) ishte mrekullia logjistike, magjia që krijon vetëm Rruga e Arbërit, me kaq shumë rrugë lokale, kryq e tërthor, që Skënderbeu, i shfrytëzojë mrekullisht dhe mori maksimumin prej tyre. Ndaj dhe: Në bosht të Rrugës Arbërit, Skënderbeu, do të mbrohej, sa herë i kërkohej koka. Se aty ishte më i sigurtë. Se aty kishte shtetin e vet. Se aty, ishte drejtimi më i shkurtër i kërthizës Abërisë, që lidhte Perëndimin me Lindjen. Me vetëm 80 km lidh Durrësin me Dibrën; 70 km Krujën me Dibën; 100 km, Durrësin me "Ohrin e Dibrës". Dhe kjo mrekulli logjistike rrugore e kohës Skënderbeut, mund të realizohet prapë, vetëm me 27 km, "Rrugë të Re Arbëri"!

Rruga e Arbërit, ju shërbejë më shumë shqiptarëve për të mbrojur detin, se sa të huajve që sulmuan nga deti. Arbëri, duke sjellë forca nga thellësia e territoreve të veta në "shpinë të Durrësit", e mbrojti Durrësin, Rodonin, Shufadanë dhe Krujën, për sa kohë nuk i kishte Venediku.

Arbëri, po aq sa nga deti, ishte i rrezikuar dhe nga toka. Serbia, ishte armiku historik, shekullor. Gjithnjë, serbët, synonin Adriatikun. Boshti i rrugës Arbërit, ai i kurrizeve veçanërisht: Dibër-Valikardhë-Ballenjë- Qafë Priskë- Tiranë – Durrës, ishte drejtimi më i shkurtër dhe më i preferuar për serbët. Sepse Rusia dhe Serbia, ende mbeten faktor destabilizues.

"Thema e Durrësit" sipas Shufllait, viset qëndrore të saj, ishin drejtimi bazë për zgjerim territori nga ana e Serbisë, një synim konstante në shek. XII-XIV, aq sa, viset qëndore të Themës Durrësit ishin "rregullator të marrëdhënjeve dinamike midis Lindjes dhe Perëndimit".

RRUGA E ARBËRIT NË PERIUDHËN E LUFTËS FTOHTË

Po kjo klasë politike, me mendësinë "të çojmë investimin tek populli" dhe jo "cili ivestim na kursen më shumë", që ka "efekt vetshlyerje më të shpejtë", u bënë gabime në vlerësimin ekonomik të "Rrugës Arbërit", deri kufijtë e të pabesueshmes, deri në absurd.

Nëse do zbatoheshin ato "projekt- ide" që hidheshin në stëvitjet e nivelit strategjik nga elita intelektuale ushtarake, ku propozonte bosht të rrugës Arbëri, edhe se pa zënë në gojë fjalën Arbër, neglizhoheshin ato. Për rrjedhojë, patëm pasoja fatale: Nuk do kishim ato 27 km "Rrugë të Re Arbëri", dhe do bënim plot 50 vjet, trefish një rrugë më gjatë, duke humbur kohë, pasuri dhe energji, deri në ç'menduri. Të tjera absurditete, po me "Rrugë Arbëri": Kromi i Bulqizës, nuk pasurohej në Bulqizë, në bosht të Rrugës Arbërit por, transoprtohej 27 km më larg, deri në Burrel.Vetëm me kurimet e këtij transpoti të panevoshëm, mund të ndëroheshin ato 27 km. shtesë "Rrugë e Re Arbëri".

Vetëm për 27 km shtesë "Rrugë të Re Arbëri", mbi 50 vjet, transportuam mbi 10.5 milion ton krom e mermer, nga 135- 180 km deri në Durrës, kur kjo mund e duhej të bëhej me 50- 80 kilometra. Po të ishin ndëruar ato 27 km në kohë diktature, ajo rrugë shtesë, do e kishte shlyer veten kush e di sa here.

Me ato kursime, sa punë më të dobishme se fortifikimi mund tëkishim bërë? Mos, kursimet do ishin aq të mëdhaja, sa dhe nga Komani, Fjerza e Vau i Dejës, që pati leverdi me ç'vendosur gjithë Kukësin e vjetër? Mos, vetëm ato 27 kilometra rrugë shtesë, po të ishin bërë në kohë, vetëm nga kursimi i një zëri të vetëm, "diferencë transporti, nga 5 minierat "hidrocetrale" në bosht të Rrugës Arbërit (Bulqizë, Batër, Thekën, Tërnovë, Klos), plus tre Fabrika Pasurimi dhe një Metalugji, a nuk do të kishim kursyer aq shumë sa mund të sillnim tre rrethe me shtëpi në Tiranë, dhe prap bilanci të ishte aktiv?!

NË BOSHT TË RRUGES ARBËRIT, "HIJA" E SKËNDERBEUT

Në bosht të "Rrugës Arbërit", populli, nëpërmjet "gojëdhanës amanet", ka sjellë dhe "mallkimet e Skënderbeut!".

Një besimtar në Buqlizë, me shtëpi afër "Teqes Madhe", na befasojë në një mortje në Koçe, kur përditësoj mallkimin e Skënderbeut, me një ngjarje konkrete, po me "Rrugë Arbëri": Ishte mallkimi i Skënderbeut ndaj atyre që hoqën fondet e rrugës së shtetit të tij, nga " Rruga e Arbërit në Tunel Elbasani" që e paguan jo vetëm me kosto politike por dhe jetë.

Rrugë e Arbërit, ka "tolosun" të rendë. Ka hijen e Skënderbeut! Mjer kush merr mallkimin e saj! Se Skënderbeu, nuk fal më "tradhëtitë e mëdha!" as nga "të vetët".

RRUGA E ARBËRIT, ELEMENT I SIGURISË KOMBËTARE

Të gjitha kështjellat qytete (aty dhe rezervat logjistike); kështjellat vend drejtimi dhe pika të përparuara (aty dhe rezervat e përparuara logjistike), nuk viheshin as në fushë,

(Vijon në faqen 19)

opinion

(Vijon nga faqja 18)

as larg boshteve ku kalonin rrugët e mëdha ushtarake dhe tregëtare. Se, tek e fundit, kështjellat dhe rrugët, ishin pjesë të njëra tjetrës. Faktori logjistik, krijonte kushtet që shteti të futej në luftë. Ishte lufta ajo që do mbronte logjistikën e shtetit.

Pa këtë analizë gjeostrategjike të ndërsjelltë, që e sudjon "Logjistika Shkencë" (Torp & B. Azis), nga lashtësia deri në kohë komunizmi, nuk mund të kuptojmë pse gjithë ajo ngjeshje kalashë në bosht të Rrugës Arbërit.

Dibër- Bizë- Qafë Shkallë Tiranë, Tujan (aty dhe Bazorelika e ruajtur nga ushtria), Brarë aty dhe Uzina e Artilerisë), Surrel (aty spitali më modern, me disa pavjone, të tunelizuara, sterilizuara, me disa salla opëracioni për ndërhyrje kirurgjikale të specializuara; një segment i "Rrugës Arbërit" që mban emrin "Mylim Keta", nga Uzina e Artilerësi deri tek kryqëzimi "Rruga- Ura", ku kishim një varg uzinash, makineri e paisje, rezerva të gjitha llojeve, për kohë paqe dhe lufte; për të vijuar në Surrel ku kishim dhe furra buke stacionare, që funksiononte me dru zjarri, qymyr dhe solar. Këto furra stacionare, veç atyre të lëvizëshme, përballuan furnizimin me bukë të Tiranës dhe gjithë Shqipërisë, në kohë krizash, përfshi dhe atë kosovare (kishte planifikim logjistik dhe për këtë, madje, objekt i kërkimit shkencor); Qafmolla, (më gjigandja ku kishte gjithçka për luftë) dhe Linosi, pika e përparuar në nivel strategjik e drejtimit verilindor, bashkë me " Rezervat e Shtetit", po në Linos.

Me gjithë këtë mrekulli logjistike të kohës, edhe se me dhimbje tragjike, mbyllinin përfundimisht mbështetjen logjistike të "Boshtit të Rrugës Arbërit".

TË VENDOSIM NISHANE TË SKËNDERBEUT NË RRUGE TË ARBËRIT

Po të kishte lëshuar Skënderbeu këto territore, nuk do të kishim Ohër të Dibrës dhe as Ematia -Maqedoni dhe Maqedonia- Shqipëri. Nuk do kishim as veprën unikale të Nikoll Kesës, "zbulim i madh" (Buda) për "origjinën pellazgjike të shqiptarëve të Maqedonisë" (Skiroj), ku dhe ai ishte pjesë, nga Gostivari, i biri i Kol Ketës. Po në Maqenoninë shqiptare, Ohri i Dibrës, Dy Rekat e Dibrës, Rrethinat e Shkupit me shumicë të cilësuar shqiptarë, Gosivari tërësisht shqiptar, etj.

E, ndërsa Gjeorgjevski, shton buste për të sajuar diçka që i mungon nga etnia maqedonase në Shkup e Ohër, dhe përdhos bustin e Skëndeerbeut dhe Nënë Terezës, ne heqim Skënderbeun me gjithë territore dhe beteja nga Ohri i Dibrës dhe rrethina Shkupi me shumicë shqiptarë! A nuk jemi të marrë? Dhe "Rrugën e Arbërit", nuk e çojmë me studim fesibiliteti deri aty ku ishte dhe e kishim, deri në Ohër të Dibrës, aty ku bashkohej me Egnatian me një segment edhe nga Krajka (Kaca), dhe segmentin në territoret shqiptare të Maqedonisë t'ja kërkonim Maqedonisë, po me aq forcë, siç po kërkojmë ujrat e Radikës, hartat tona të rrugës Arbërit, i mbyllim, o në Bllatë, o në Homezh? Pse? Duket pakujdesi e vogël, por, atë që shkruan lapsi, nuk e shkul kazma!

E shikoni ç'po heqim nga një laps zgjatimi i Rrugës Arbërit, dhe duhet korrigjuar sa nuk është vonë, ketë "njollën" në harta topografike, aty ku e kishim dhe se kemi, por nesër do e kemi Durrës – Tiranë- Grykë Bulqize- Dibër – Ohër të Dibrës! Kjo është rruga reale e Arbërit, që rivihet në efiçencë, me vetëm me 27 km rrugë të re makine. Dhe rruga e Arbërit, është nishan i Skënderbeut në trojet shqiptare.



Më shumë informacion mbi veprimtaritë për lobimin për Rrugën e Arbërit lexoni në faqen 24.

Komente në faqen e peticionit **change.org**

Rrugë e Arbërit është zemra e vendit

Alma Cinari TIRANA, ALBANIA: Kemi nevojë për këtë rrugë, pas rrugës së Kosovës, është e rëndësishme për zhvillimin ekonomik. Shpresoj të mbarohet kjo rrugë.

Etmond Lala KAMëZ, TIRANA, ALBANIA, ALBANIA: Për zhvillimin e kësaj zone, sepse një dibrani i duhen 6 orë për të ardhur në Tiranë, gjithashtu rruga shkurton distancën, dhe nuk i bie nga Kina, por del drejt.

Suela Gazidedja PESHKOPI, ALBANIA: Është një hap pozitiv për qytetin tonë ...

Amelda Hyka BULQIZë, ALBANIA: sepse jam banore në zonën e Dibrës dhe kam nevojë të udhëtoj më shpejt për në Kryeqytet

Greta Bresho DURRËS, ALBANIA: Është Shqipëria ime

Jahjush Ahmeti FERIZAJ, SERBIA: kjo është domosdoshmëri e kohës, edhe pse jemi shumë të vonuar...

Arli Lika BULQIZë, ALBANIA: Kjo është mënyra më e mirë për të zhvilluar pjesën verilindore të shqipërisë!!!

Gerta Sazani TORONTO, CANADA: Shumë e rëndësishme për Shqipërinë.

Ilir Copja ELBASAN, ALBANIA: Ky ndërtim do të ndihmojë shqiptarët.

Pranvera Rama TIRANA, TIRANA, ALBANIA, ALBANIA: Dëshiroj me gjithë shpirt të bëhet Rruga e Arbërit, do jetë një nyje shumë e rëndësishme, për njerëzit që jetojnë atje si dhe do u jap mundësinë të tjerëve të investojnë atje, dhe mundësinë që mund t'i jepet kësaj zone për zhvillimin e turizmit malor, si do ndihmoj për të zhvilluar bujqësinë.

Gledis Kaja BULQIZë, ALBANIA: Sepse ja di vlerat dhe të mirat :)

Zenepe Xhelollari TIRANA, TIRANA, ALBANIA, ALBANIA: Mendoj se do të sillte një zhvillim ekonomik në lidhje me marrëdhënien Maqedoni-Shqipëri.

Saimr Tola, TIRANA, TIRANA, ALBANIA, ALBANIA: Pasi dëshiroj ta shikoj të zhvilluar vendlindjen time

Elsa Broën, BRIGHTON, UNITED KINGDOM: Për njerëzit mirëqenie më e mirë

Maldina Shkjau DURRëS, ALBANIA: Zhvillim i ekonomisë

Erald Baqoshi TIRANA, ALBANIA: Dibra është një nga zonat me pak të zhvilluara të Shqipërisë. Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën me pjesën tjetër të vendit për të dhënë nxitjen e nevojshme për ekonominë lokale. Rruga gjithashtu do të jetë një lidhje e re mes Tiranës dhe Maqedonisë duke përmirësuar konsiderueshëm infrastrukturën e kësaj pjese të Ballkanit.

Eldion Isaku DURRëS, ALBANIA: Sepse jam nga Dibra, dhe Rruga e Arbrit do të lidhë Dibrën me pjesën tjetër të vendit, për një shtysë për ekonominë e ekonomisë lokale.

Dileman Sulkurti DURRëS, ALBANIA: Zhvillimin e dua

Aurel Luku CARDIFF, UNITED KINGDOM: Për Dibrën

Drilon Toci DURRëS, ALBANIA: Na lehtëson shumë tregun Rruga e Arbrit

Denis Hoxha TIRANA, AL: Sa më shpejt në Maqedoni dhe në Greqi

Albano Xhaferi DURRES, ALBANIA: Sepse unë udhëtoj shpesh në këtë rrugë.

Tim Puci TIRANA, ALBANIA: Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Besi Hoxha TIRANA, ALBANIA: Është në interesin kombëtar.

Arbër Lloshi ELBASAN, ALBANIA: Ndihmon ekonominë e Shqipërisë.

Bujar FETAI ZURICH, SËITZERLAND: E dua Dibrën dhe e dua rrugën e shpresës

Omar Noka Al Islam TIRANË, ALBANIA: Sepse më mirë të shkojnë fondet në një rruge se në xhepat e pushtetarëve mbipeshë, të pa moral e mashtrues

Beqir Sita TIRANA, ALBANIA: Kjo rrugë do të ndihmojë shumë ekonominë e Shqipërisë.

Igli Kaca TIRANA, ALBANIA: Sepse jam lindur në Dibër :)

silvana cara PESHKOPI, ALBANIA: Sepse dua ta shof një vend të zhvilluar dhe me ritëm Peshkopinë time

Elena Papa TIRANA, ALBANIA: Izolimi deri më sot nuk na ka sjellë asgjë përveç injorancës prandaj rrugët janë të rëndësishme për mirëqenien në të gjitha aspektet

Albana Kociaj TIRANA, ALBANIA: Është vendlindja ime e dashur

Ervin Kuci TIRANA, ALBANIA: Kjo është vendlindja.

Marenglen Iskurti ITALY: Kjo rrugë i jep shumë vlera vendit tonë dhe një jetë tjetër për dibranët bëhet me këtë rrugë

Ahmet Balliu TIRANA, ALBANIA: Rruga është shumë e rëndësishme për të gjithë banorët e Dibrës.

Islam Nika TIRANA, TIRANA, ALBANIA, ALBANIA: Përfundoni ndërtimin e rrugës së Arbrit.

Afrim Veseli TIRANA, ALBANIA: Po duhet të bëhet sa më parë se Dibra mban Shqipërinë me kromin e saj.

Arber Kukaj HAS, ALBANIA, ALBANIA: Më intereson kjo rrugë sepse udhëtoj shpesh për në Dibër sepse jam student në UAMD. Por kjo nuk është e vetmja, rrugët duhen ndërtuar në mbarë vendin sepse një vend pa rrugë nuk ka jetesë dhe të ardhme.

Avni Gjeleshi TIRANA, ALBANIA: Sepse sjell lehtësim në transportin si të njerëzve ashtu dhe e mallrave të ndryshëm, lidh Maqedoninë me Tiranën në një periudhë kohë shumë më të shkurtër duke sjell rritjen e turizmit e shumë të tjerave duke ndihmuar në ekonominë e vendit tonë, Rruga e Arbërit jo vetëm një e mirë e banorëve të Dibrës por një e mirë e gjithë Shqipërisë.

RILIND DAUTI PESHKOPI, ALBANIA: Ndërtoni sa më shpejt dhe me standarde Rrugën e Arbërit

Fisnik Mani DRAMMEN, NORËAY: Kjo është e rëndësishme për mua si qytetar i Dibrës dhe të gjithë Shqipërinë na përmison jetën!

Ergis Riveni TIRANA, ALBANIA: Mendoj që është shumë e rëndësishme për njerëzit e Dibrës dhe banorët e Ballkanit, për t'i lidhur ata në të gjitha situatat. Unë bie dakord me këtë peticion!

Ilir Hoxha TIRANA, ALBANIA: Duhet të bëhet

Franc Bushati SHKODËR, ALBANIA: Duhet

Xhuli Geziqi MISSISSAUGA, ON, CANADA: Kjo është e rëndësishme për të ardhmen e vendit dhe do të ndihmojë njerëzit që jetojnë atje.

Sali Bollati STATEN ISLAND, NY: Për të ndihmuar shqiptarët.

Aida Ymeri TIRANA, ALBANIA: Është një nga rrugët më të vjetra të Shqipërisë, e cila shkurton distancën jo vetëm të dibranëve e matjanëve me Tiranën po shkurton distancën Shkup-Durrës, rrugë e cila përdoret për interesa tregtare e turistike. Pse jo, është



Punimet pranë Urës së Vashës. Foto: © B.Karoshi

një rrugë që do ndihmojë edhe në uljen e ndotjes atmosferike, si dhe në uljen e kostove të transportit.

Sokol Abazi TIRANA, ALBANIA: Sepse kjo rrugë është krenaria e Shqiptarëve.

Fiqri Kullafi LUSHNJë, ALBANIA: Jane bërë dhe po bëhen punime capitëse - sa rregullohet një segment prishet një tjetër e për disa nga pjesët më të rëndësishme nuk janë gjetur ende fondet. Ka që në 1998 që është nisur puna për këtë rrugë dhe vetëm po zvarritet, pavarësisht se cili krah politik është në pushtet. Prandaj shpresoj që ky peticion të firmoset nga të gjithë shqiptarët e Dibrës, të qyteteve përreth dhe të Maqedonisë, që zëri ynë të ngrihet. Nuk duhet që të lejojmë më zvarritjen e këtij projekti minimal, krahasuar me ato ç'ka janë bërë në gjithë Shqipërinë. Nuk duhet të lejojmë që të na shfrytëzojnë shpresën e besimin tonë sa herë afrohen zgjedhjet me premtime boshe e afate të gënjeshtërta!

Franco Lever ITALY: Shumë e rëndësishme

Lumturi Balliu FREISING, GERMANY: Duhet të ndërtohet Rruga e Arbrit. Kështu mund të shkoj më shpejt në shtëpi.

Erikson Aga MALTA, MALTA: Për të gjithë Dibrën

Neri Ismaili TIRANA, ALBANIA: Sepse unë jetoj këtu dhe është shumë e vështirë për mua të udhëtoj 5 orë për në Tiranë dhe rruga është e rrezikshme.

arjan jaupaj TIRANA, ALBANIA: Për të lidhur Dibrën me pjesët e tjera të shqipërisë, për të mirën e biznesit, turizmit etj.

Saimir SULAJ TIRANA, ALBANIA: Ndërtimi i Rrugës së Arbërit, veç dhënies së një hovi për zhvillimin e rajonit verilindor të Shqipërisë, do të ndikonte në zhvillimin ekonomik të të gjithë vendit. Rruga e re do të shkurtonte distancat me Maqedoninë dhe do të lehtësonte lëvizjen e mjeteve dhe mallrave që vijnë ose shkojnë deri në zonat e Detit të Zi.

Adil Xhelili GJIROKASTER, ALBANIA: Për të mirën e kombit.

Rudens Rexhaj KUKëS, ALBANIA: Sepse infrastrukturë do të thotë zhvillim.

Armand Mjolli TIRANA, ALBANIA: Kjo rrugë për mendimin tim mund të jetë arteria kryesore në trupin e atdheut tonë.

Argen Cibaku TIRANE, ALBANIA: Sepse është një dritare e madhe që hapet për atë zonë, që është edhe zona ime gjithashtu!

Reme Xhani DURRëS, ALBANIA, ALBANIA: Sepse shkoj shpesh në qytetin e Peshkopisë....

Alba Zeqja PESHKOPI, ALBANIA: Për gjithçka: edukimin, punësimin, emergjencat etj.

Rudina Dema DEBAR, MACEDONIA (FYROM), MACEDONIA: Unë mendoj se është shumë e dobishme kjo rrugë edhe për Dibrën në Maqedoni, sepse edhe ky qytet i lënë mbrapa do të gjallërohet .

Halim Shini DIBËR, ALBANIA: Sepse është e rëndësishme për qytetin tim. Kemi nevojë të përfundojmë Rrugën e Arbrit.

Niazi Zollumi PESHKOPI, ALBANIA: Të realizohet ky projekt se ky projrekt është e ardhmja jonë.

N. Skarra GERMANY: Sepse është e rëndësishme për të gjithë rajonin.

Anduela Gjurra TIRANA, ALBANIA: Sepse është vendi im..

Fjona Karalliu VLORë, ALBANIA: Sepse thjesht është!

Vilson Kuci TIRANË, ALBANIA: Kjo rrugë do ta rilindë Dibrën

Bill Ndreu BRIDGEPORT, CT: Kjo është shumë e rëndësishme jo vetëm për mua, për familjen time dhe të afërmeve të mi, por edhe për çdonjeri në Shqipëri.

Blend Cera STOKE ON TRENT, UNITED KINGDOM: Sepse lidh veriun me pjesën tjetër të vendit.

Erli Burnazi TIRANA, ALBANIA: Sepse do të ndihmojë njerëzit në Dibër.

Dorjan Bodini TIRANA, ALBANIA: Pse Dibra duhet kaq larg Tiranës kur në fakt i ndan vetëm një mal. Pse Tirana duhet të jetë kaq larg Dibrës ku bazat e kulturës Tiranase vijnë nga Dibranët e rrugës së Dibrës në Selvi

Tomor Kadriu BURLINGTON, ONTARIO, CANADA: Bashkimi ekonomik, social i Shqiptarëve në të gjithë trojet e bën kombin më të fortë në përballimin e erërave që fryjnë ndaj kombit tonë, kjo duhet kuptuar dhe nga politikanët. Duhet ta kenë të qartë që Shqipërinë e bëjnë vetëm shqiptarët e askush tjetër. Kjo e bën të domoshdoshme ndërtimin e kësaj rruge. Këtu duhen parë interesa strategjike që ka vendi.

Dukagjin Turkeshi DEBAR, MACEDONIA: Sepse kjo rrugë është zemra e vendit.

Dario Sula BULQIZë, ALBANIA: Sepse unë e bëj shkollën në Tiranë dhe e bëj shpesh rrugen Tiranë-Bulqizë që zgjat rreth 3 orë e 30 min, ndërkohë që me rrugën e Arbërit mund ta bëj për 40 min maksimumi..

Arsen Xhemali MAQELLARë, ALBANIA: Ndërtimi sa më i shpejtë i Rrugës së Arberit

Petro Luarasi TIRANA, TIRANA, ALBANIA, ALBANIA: Në artikullin "Pema tek pragu i udhës së Arbërit", të publikuar më 12 prill 2012 nga mediat drini.com, prishtinapress.info apo "Rruga e Arberit" shkruaja se ndër mendjet e begata udha e Arbërit "rrezaton vlera madhore historike, kulturore e strategjike, që nga periudha e lashtë romake." Ky është korridori i dytë strategjik kombëtar, i cili duhet të ndërtohet sa më shpejt, me çdo lloj sakrificë, pasi: ridimensionon nga ana kombëtare, ekonomike e politike faktorin e shqiptarëve në Maqedoni dhe i jep Shqipërisë potencën e duhur strategjike si nyje lidhëse e Lindjes me Perëndimin. Ky magjistral, meqë paraqet leverdi ekonomike edhe për Maqedoninë, Bullgarinë, Italinë e më tej, do t'i japë më tepër vlera portit të Durrësit. Akoma më mirë do të ishte të ndërtohej e të vihej më tepër në efiçencë rrjeti i linjave hekurudhore për transportin e mallrave, krijimi i zonave të lira dhe magazinave të mëdha tregtare me partnerë nga e gjithë bota. Veçse kjo strategji kërkon politikanë kurajozë të cilët të jenë të përgjegjshëm për interesat kombëtare. Po, porti i Selanikut do të dilte me humbje. Mezi po pres të përfundojë ky magjistral i mrekullueshëm dhe të shoh se kush do të nxitojë për ta patur sa më parë partner Shqipërinë.

Lorana Sadikaj PESHKOPI, ALBANIA: Se rruga Peshkopi Tiranë është shume e lodhshme

Ervin Gazidede TIRANA, ALBANIA: Zhvillim ekonomik për zonën e Dibrës.

Lorenc Lazimi PESHKOPI, ALBANIA: Rruga e Arbërit është si Drini lidh shqiptarinë

GAQO APOSTOLI TIRANA, ALBANIA: Rruga e Arbrit është konsideruar si një degëzim i rëndësishëm i korridorit të 8-të. Marrëveshja respektive u nënshkrua nga Shqipëria, Maqedonia, dhe përfaqësues të Bullgarisë, e po ashtu edhe nga përfaqësues të ambasave amerikane në këto vende, që nga viti 1998...

Manuela Hoti TIRANA, ALBANIA: Rruga e Arbrit është një ndër rrugët më të vjetra në Shqipëri. Është një rrugë me shumë histori brenda, aq e vjetër sa vetë Dibra. Jam mbesë Dibre dhe jam krenare. Iu bëj thirrje të gjithë të rinjve shqiptarë të solidarizohen me bashkëmoshatarët e tyre dibranë, që ta nënshkruajnë peticionin online për përfundimin sa më parë dhe me standarde të Rrugës së Arbrit.

Elio Qalliu MALLAKASTER, ALBANIA: Për pushimet.

Abderrahmane Bensalama ITALY: Sepse shkurton largësinë.

Idaije Nurce PESHKOPI, ALBANIA: Është më e sigurtë.

Klodian Vranici PESHKOPI, ALBANIA: Dhe kjo është rrugë kombi. Lidh shqiptarët e Maqedonisë me Shqipërinë.

Majlinda Xhelili PESHKOPI, ALBANIA: E bëj çdo javë këtë rrugë...është shumë e lodhshme....

Shpend Kola PESHKOPI, ALBANIA: Sepse pa "Arbëri-n" ndjehem i lodhur.

Leli Kovaçi TIRANA, ALBANIA: E dua Dibrën.

Alma Mikli PESHKOPI, ALBANIA: Është rruga që të çon më mes të tokës së shqiptarëve.

Sokol Dovolani DIBER, MACEDONIA: JETIKE

Mergime Ajdini DEBAR, MACEDONIA: Lidhje.

RUDINA BATKU DEBAR, MACEDONIA: Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Vebi Gazidedja PESHKOPI, ALBANIA: Është shumë e rëndësishme për t'i shërbyer kominitetit dibran.

Endri Leka PESHKOPI, ALBANIA: Ndërtimi sa më i shpejtë i Rrugës së Arbrit!!

Ilva Toska TIRANA, ALBANIA: Sepse më duket se kjo rrugë kombëtare është shumë e rëndësishme. Politika e ka shtyrë këtë rrugë për një kohë të gjatë. Është koha të bëjmë diçka për të ndryshuar:)

FISNIK PEPA ALEXANDRIA IMATHIAS GREECE, GREECE :Sepse është vendlindja ime.

Blerim Elezi GERMANY: Që e ardhmja jonë dhe fëmijëve tanë të jetë më e mirë dhe më e sigurt, respekt të gjithëve.

Ermir Rexhepi BULQIZë, ALBANIA: Është e rëndësishme për të gjithë.

Erjon Isaku TIRANA, ALBANIA: Is the best

Xhelil Ahmati GOSTIVAR, MACEDONIA: Duket si përgjigja e duhur për hartën tonë.

Dorina Xhelili PESHKOPI, ALBANIA : Për zhvillim ekonomik dhe social.

Erjola Kaçi PESHKOPI, ALBANIA: Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Kolonja Hasani PESHKOPI, ALBANIA: Sepse rruga e Arbërit është e ardhmja e krahinës së Dibrës.

Razie Dibra PESHKOPI, ALBANIA: Për krijimin e standardeve sa më të mira të jetesës..

Ardit Muca TIRANA, ALBANIA: Është rruga më e shpejtë për ne dibranët dhe me rrugë të re turizmi do të rritet.

Imer Begu PESHKOPI, ALBANIA: Sepse unë jam një student dhe këtë rrugë e bëj shumë shpesh, është një lodhje shumë e madhe rruga e vjetër e kjo do të largonte këtë gjë. Është e rëndësishme sepse do të kishte një përfitim i gjithë qarku i Dibrës në këtë rrugë, do kishte lehtësi në transport dhe shumë lehtësime të tjera.

Oltion Çemalli PESHKOPI, ALBANIA: Nuk është e rëndësishme vetëm për mua por për gjithë vendin tim.

Muhamet Hoxha TIRANA, GREECE: Sepse shumë aksidente ndodhin nga rruga e vjetër që është.

Lireta Çerpja DURRëS, ALBANIA: Është vendlindja ime.

Kujtim Lleshi TIRANË, ALBANIA: Ndërtimi i rrugës është detyrim i qeverisë

Dibra e Madhe dhe Peshkopia me projekt të përbashkët

Menaxhimi tejkufitar cilësor me resurset ujore

Problemet që paraqiten nga mungesa e ujit të pijshëm sidomos gjatë muajve të verës dhe paralajmërimet e ekspertëve të kësaj fushe se në të ardhmen këto probleme edhe mund të shtohen janë rrethanat për hartimin e këtij projekti.

Partnerë në këtë projekt janë Qendra Rajonale e mjedisit jetësor për Evropën Juglindore me seli në Shkup, Komuna Dibra e Madhe në Maqedoni dhe Bashkia e Peshkopisë në Shqipëri.

Ky projekt kap vlerën prej 196.566 euro, prej tyre donacion nga Bashkimi Evropian nga Programi IPA për bashkëpunim ndërkufitar 166.984 euro, Komuna Dibër e Madhe merr pjesë me 19. 872 euro dhe REC- QRMEJ (REC) 9.700 euro.

Gazmend Cami, bashkërendues i këtij projekti na tha se, "Zanafilla e këtij projekti është e kahershme, ndërsa qëllimi kryesor i këtij projekti është të nxisë bashkëpunimin ndërkufitar për çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor, përkatësisht me sferën e resurseve ujore si pasuri natyrore. Diskutimi për problemet, shkëmbimi i përvojave dhe ekspertiza profesionale mund të sjellin gjer te idetë dhe mundësitë për qasje praktike dhe racionale për zgjidhjen e problemeve lidhur me furnizimin cilësor dhe menaxhim te qëndrueshëm të sistemeve të ujësjellësve. Mbi bazën e gjendjes dhe të dhënave aktuale mund të konstatojmë se në sferën e furnizimit me ujë të pijshëm problemet nga dy anët e kufirit në disa pika janë të natyrave të ngjashme, por edhe ndryshojnë . Këtu mund të përmendim sistemet e vjetërsuara të ujësellësave qe krijojnë rrjedhje dhe humbje te ujit, harxhimet e pakontolluara nga lidhjet e paligjshme, humbjet nga mosfunksionimi i orëmatësve, humbja teknike, humbja nga llogaritja afrofe e harxhimit të ujit etj.

Një ndër qëllimet e këtij projekti, shton Cami, "është të identifikojë dhe të japë përgjigje për problemet themelore lidhur me cilësinë dhe sasinë e furnizimit me ujë, efikasitetin e sistemeve të furnizimit me ujë, dhe të krijojë planveprimet që do të kontribuojnë në vendosjen e praktikave për menaxhim të qëndrueshëm me resurset ujore në dy Dibrat".

Gazmend Cami, më tej thotë se, " qëllimet e projektit do të arrihen përmes rritjes së kapaciteteve teknike dhe njerëzore-menaxhuese të komunave/ ndërmarrjeve të ujsëllësave, por paralelisht duhet të realizohen aktivitete për rritjen e vetëdijësimit te të githa grupet e interesit dhe banorëve në tërësi, me



çka do të thellohet dialogu mes partnerëve dhe përfaqësuesve të komunitetit".

I pyetur për rezultatet e pritshme të projektit Gazmend Cami thekson se, " Me këtë do të arrihet përmirësimi i efikasitetit të sistemeve te ujësjellësve dhe ritja e kapaciteteve të ndërmarrjeve publike dhe komunave/ bashkive. Rritja e kapaciteteve në lidhje me menaxhimin të integruar me resurset ujore sipas kërkesave dhe normativave përkatëse.

Lidhur me aktivitetet e realizuara të këtij projekti Cami shprehet se, " Në kuadër të projektit deri tani janë realizuar këto aktivitete: Në vitin 2012 Është përgatitur studimi për vlerësimin e sistemit të ujësjellësit për qytetin e Dibrës së Madhe Është furnizuar softweri për modelim hidraulik të ujësjellësit në Dibër të Madhe. Janë bërë aktivitete lidhur me përcaktimin dhe identifikimin e humbjeve në sistemin e ujësjellësit. Pas instalimit të modelit hidraulik, është realizuar trajnim 7 ditor për shfrytëzimin e sofwtuerit për modelim, ku kanë marrë pjesë përfaqësues të ndërmarrjeve të ujësjellësave nga Dy Dibrat. Janë bërë matje të rrjedhjes dhe presionit në pika të caktuara kritike të ujësjellësit, ku përfaqësuesit e ndërmarrjes publike u njoftuan me pajisjet dhe mënyrën e matjes së ujit. Është hartuar raporti i analizës së punës së modelit hidraulik dhe janë dhënë rekomandime dhe propozime për përmirësimin dhe modernizimn e sistemit të ujësjellësit. Janë realizuar takime dhe kumunikime të rregullta mes partnerëve të projektit. Më 13 dhe 14 dhjetor 2012 u realizuan tryeza të rrumbullakëta në Dibër të Madhe dhe Peshkopi ku merrnin pjesë ekspertë përkatës të kësaj fushe. Më 17 dhe 18 dhjetor 2012 u organizua punëtori rajonale ku u diskutua për menaxhimin e integruar ndërkufitar me resurset ujore dhe zvogëlimin e humbjeve në sistemet e ujësjellësave. Në vitin 2013 u përpilua projekti themelor për përcaktimin e pikave për matjen e rrjedhjes së ujit dhe krijimi i Qendrës SCADA që tani paraqet vetëm fazën fillestare. U realizua prokurimi publik për rikonstruimin e pusetave kryesore që do të shërbejnë si pika kontrolli të shpërndarjes së ujit në rrjetin e ujësjellësit. Janë realizuar takime të rregullta të grupeve punuese. Në vitin 2014 u realizua tenderi për furnizim me paisje për Qendrën SCADA me pikat matëse për lexim nga largësia të sistemit të ujësjellësit në Dibër të Madhe. Nga 1-3 prill 2014 u organizua punëtoria e dytë rajonale në temë " Përmirësimi i gjendjes së furnizimit me ujë në nivel lokal", si dhe u realizua vizita studimore në Korçë, ku pjesëmarrësit u njoftuan me shembujt dhe përvojat pozitive dhe me sistemet bashkëkohore për menaxhim të qëndrueshëm me ujësjellësat. Në përfundim janë punët për riparimin e rezervuarit të vjetër të ujit, rikonstiuimin e pusetave si dhe instalimi i pajisjeve në këto puseta për vendosjen në funksion fazën e parë të sistemit SCADA . Në muajt e ardhshëm si vazhdimësi e këtij projekti me burime financiare na Banka Evropiane, do të punohet në rikostruimin dhe riparimin e 6 pusetave te ujësjellësit në Dibër të Madhe, me ç'rast do të instalohen pajisje për rregullimin/ balancimin e shpërndarjes së ujit, duke e ndarë rrjetin e ujësjellësit në 3 zona, si edhe do të riparohen 26 puseta dytësore të ujësjellësit.

Ndërkaq në Peshkopi do të zhvillohen trajnime të ekspertëve dhe të punonjësve ne ujësjellësat për shpërndarjen më cilësore dhe të balancuar të ujit në zonat e qytetit", tha në fund Gazmend Cami, bashkërendues i këtij projekti.

Rexhep TORTE

Gjergj Driloni BRUXELLES, BELGIUM: Të mësohemi të meremetojm, e jo të shkatrrojmë!

Oni Macka TIRANA, ALBANIA: Duhet bërë rruga me patjetër për dibranët që i bien si magelani gjithmon. E kanë lënë qytetin me tradita dhe zakone të mrekullueshme në meshir të zotit.flm

Ardit Velica DEBAR, MACEDONIA: Sepse e shkurton rrugën shumë.

Eldit Muja TIRANA, ALBANIA: Kam familje në Dibër.

Luftim Skara MAQELLARë, ALBANIA: Kjo rrugë është e rëndësishme për të gjithë shqiptarët, brenda dhe jashtë vendit, jo vetëm për dibranët, por ndihmon edhe shqiptarët e Maqedonisë të afrohen më shumë me Tiranën.

Nexhmi Myftari ITALY: Për ekonominë, për gjithçka është shumë e rëndësishme..

ALBI SHEHU TIRANA, ALBANIA: Sepse jetoj në Dibër.

BASHKIM LUCA TIRANA, ALBANIA: Rruga Arbrit

Ender Mushllari ELBASAN, ALBANIA: Te shkurtohen distancat.

Neshat NDREU TIRANE, ALBANIA: Sepse kam një shtëpi në Dibër dhe të afërmit e mi. Dua që Dibra të zhvillohet.

Mevlan Hoxha Μόναχο, GERMANY:

Imran Memetaj SKOPJE, MACEDONIA: Sepse jemi në 2014, dhe të gjithë duhet të jetojnë me rrugë

Redion Xhepa TIRANA, ALBANIA: Është një rrugë që i shërben gjithë kombit e jo vetëm dibranëve.

Myrtezan Demiri TETOVO, MACEDONIA: Thjeshtë na duhet më shpejt edhe nga Tetova të mbrim në Tiranë....

Ernest Alia PESHKOPI, ALBANIA: Kjo rrugë është për zhvillimin e qytetit tim.

Eduart Bardhushi KORçë, ALBANIA: Dibra është një nga krahinat më të pazhvilluara në Shqipëri. Rruga e Arbërit do të lidhë Dibrën me rajonet e tjera të vendit duke i dhënë një shtytje shumë të nevojshme ekonomisë lokale. Rruga do të lidh edhe Tiranën me Maqedoninë duke përmirësuar ndjeshëm infrastrukturën në këtë pjesë të Ballkanit.

Ermir Bajraktari TIRANA, ALBANIA: Është një segment kyç, që do të krijonte shumë lehtësira, por edhe përfitime ekonomike. Është një "arterie" që i mungon vendit tonë.

Tahir Karaj BIRMINGHAM, UNITED KINGDOM: Është e rëndësishme për të gjithë dhe do të jetë një përfitim i madh për Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Roland Shehu PESHKOPI, ALBANIA: Sepse përmirësohet infrastruktura, zhvillohet turizmi malor, këto sjellin zhvillim ekonomik etj

Dritan Miftari TIRANA, ALBANIA: Është e rëndësishme për mua për shumë arsye, shkurtimi i rrugës nga Tirana në Dibër dhe anasjelltas, zhvillimi ekonomik investimet në bujqësi tregtia me Dibrën e Madhe (Maqedoninë) dhe shumë faktorë të tjerë të cilat s'po më bien ndërmend.

Elidon Koxha DURRëS, ALBANIA: Që të lëvizim më shpejt

Denis Bara TIRANA, ALBANIA: Është me rëndësi për mua sepse atje kam vendlindjen dhe gjithçka që dua me zemër.



Kontribuo për vendlindjen duke u pajtuar në gazetën

RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin PDF ose kopjen print.

Për informacion shkruaj: rrugaearberit@gmail.com



Rruga e Arbërit nr. 96

Më 11 prill 2014, në Shkup u mbajt konferenca me temë "Projektet hidroenergjetike kundër natyrës", nga e cila u iniciua edhe fushata për mbrojtje të parkut kombëtar Mavrovë, "Save the blue heart of Europe". Ashtu si edhe konferenca, edhe fushata u organizuan nga shoqatat ndërkombëtare që veprojnë për mbrojtje të ambientit jetësor, "Euronature" (Gjermani), "Riverwatch" (Austri) dhe "Ekosvest" (Maqedoni).

Projektet hidroenergjetike kundër natyrës

Më 11 prill 2014, në Shkup u mbajt konferenca me temë "Projektet hidroenergjetike kundër natyrës", nga e cila u iniciua edhe fushata për mbrojtje të parkut kombëtar Mavrovë, "Save the blue heart of Europe". Ashtu si edhe konferenca, edhe fushata u organizuan nga shoqatat ndërkombëtare që veprojnë për mbrojtje të ambientit jetësor, "Euronature" (Gjermani), "Riverwatch" (Austri) dhe "Ekosvest" (Maqedoni).

Në këtë konferencë një vëmendje e posaçme iu kushtua pikërisht projekteve elektroenergjetike Fusha e Llukovës dhe Ura e Boshkut.

"Natyra e Maqedonisë është ndër më të bukurat, mbase edhe më e bukura në Evropë. Rreth 80% e lumenjve janë edhe më tej në gjendje të mirë. Për dallim, në Gjermani kanë mbetur vetëm 10% e tyre në gjendje të mirë. Prandaj, Ju, duhet të ruani natyrën dhe të mos bëni gabimet e shteteve të zhvilluara të Evropës, si Gjermania, Austria e të tjera", tha drejtori i "Euronature", Gabriel Schwaderer.

Në konferencë më tej u bë i ditur lajmi se strategjia e vendeve Ballkanike është ndërtimi i 573 hidrocentraleve te vogle edhe pse momentalisht janë rreth 273 të tilla që funksionojnë, tha drejtori i "Riverwatch", Ulrich Eichelmann, ndërsa në total prej Sllovenisë e deri në Maqedoni, përfshi këtu edhe Shqipërinë, pritet të ndërtohen gjithsejt rreth 4000 hidrocentraleve të vogla. Kjo do bënte ndikime dhe dëme të mëdha negative në ambientin jetësor kudo që ata do të ndërtohen, dhe ky është sinjal për skandal më të rëndë i cili do i bëhet natyrës. Sot në Evropë, sipas strategjisë për revitalizim të lumenjve Unioni Evropian ka përcaktuar një vlerë prej 1.1 miliardë euro për të bërë ringjalljen e lumenjve dhe kthimin e tyre në shtretërit natyrorë për periudhën 2014-2017. Z. Eichelmann shtroi pyetjen se si do i sigurojë gjithë këta mjete për të rregulluar gabimet e sodit në Maqedoni e vogël.

Përfaqësuesi i IUCN, (International Union for Conservation of Nature), Andrej Sovinc, tha se me ndërtimet e hidrocentraleve të Urës së Boshkut dhe Lukovës do të thyenin konventat ndërkombëtare, Ankesi II, dhe këtë nuk mund ta bëjë veçse një shtet në të cilin nuk sundon ligji dhe normat, apo shtete të ashtuquajtura "Republika Banane". Ndërtimi i këtyre hidrocentraleve, sipas tij, padyshim që do jetë problem për Maqedoninë në rrugën e saj drejt BE-së.

MAVROVA ME 16 HIDROCENTRALE TË VEGJËL

Nga diskutimet tjera është me rëndësi të potencojmë diskutimin e profesorit universitar, Ljupço Melovski, i cili konstatoi se dëmi në Mavrovë veç ka filluar me ndërtimin e tre hidrocentraleve të vogla në Galiçicë, ndërsa me projektimin e 13 të tjerave, ku 2 janë të projeksioneve milionëshe, sipas Melovskit, Mavrova rrezikon mjaft ne biodiversitet dhe ekosistem.

Në konferencë morën në njërin nga panelet morën pjesë edhe kryesuesi i Këshillit komunal të Dibrës, z. Bashkim Mashkulli dhe përfaqësuesi nga Reka, Samet Abduli, si edhe shumë aktivistë të njohure në mbrojtje të çështjes së Radikës

Korresp. "Rruga e Arbërit"



Ruaj Radikën, për të ruajtur qenien tënde

PLANET ENERGJETIKE TË QEVERISË TË RM

Qeveria e RM përmes resorëve të saj në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministria për ambient jetësor, planifikon ndërtim të disa hidrocentraleve në disa faza në zonën e parkut kombëtar "Mavrovë". Në fazën e parë, planifikohet ndërtimi i dy hidrocentraleve (HC), "Fusha e Llukovës" dhe ai në "Urë të Boshkut"; ndërsa në fazën e dytë duhet të ndërtohen edhe 11 hidrocentrale të tjera me kapacitete më të vogla.

AKUMULIMI "FUSHA E LLUKOVËS" DHE HC "GURI I ZI" ("CRN KAMËN")

SHA. ELEM, në vitin 2010 ka përpiluar versionin e fundit të projektit "Fusha e Llukovës" që përfshin kapjen e ujërave të Korabit, ndërtimi i pendës (akumulimit) në fushë të Llukovës dhe ndërtimi i hidrocentralit "Guri i zi". Akumulimi "Fusha e Llukovës" ndodhet në kufirin mes Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës dhe do të furnizohet me ujë nga kapja e ujërave të Korabit dhe përrenjve të cilët ndodhën në atë zonë, duke e dërguar atë përmes tubacioneve dhe tuneleve me gjatësi 20 km.

Akumulimi do të mundësojë prodhim të rrymës elektrike përmes HC "Guri i zi" (me fuqi instaluese 6MW) një sasi prej rreth 18.71 GWh në vit.

Sipas matjeve të realizuara nga 1945 – 2007, sasia mesatare vjetore e ujërave të Radikës është rreth 30m3 ujë/s. Siç dihet, Radikës, në vitet '60, gjatë ndërtimit të hidrocentralit të Mavrovës i është marrë një sasi prej rreh 9 m3 ujë/s, (bazuar në këta numra, Radika sot duhet të ketë rreth 21 m3 ujë/s)

Sasia e planifikuar e ujit të merret nga rrjedha e Radikës, për tu dërguar në Fushë të Llukovës (për të vazhduar më tej rrjedhën e saj përmes Vardarit në Egje), nuk dihet saktë pasi, SHA "ELEM", në opinion ka dalë vazhdimisht me shifra të ndryshme, prej 2 e deri më 8 m3 ujë/s, por duke bindur (lexo: gënjyer) opinionin se Radika sot disponon me jo më shumë se 15 m3 ujë/s. Shtrohet pyetja, ku vallë u zhdukën edhe 6 m3 ujë/s nga sasia e mbetur prej 30m3 ujë/s? A thua vallë ELEM-i përmes këtij plani prej 8 m3 ujë/s (bazuar në konventën e ndërshtetërore mes Shqipërisë dhe ish Jugosllavisë nga viti 1948) tenton të përfitojë duke vjedhur edhe 6 m3 ujë/s të cilat askush nuk i përmend apo kalkulon?

PASOJAT NGA PROJEKTI "FUSHA E LLUKOVËS"

Ndikimi ekonomik, ekologjik dhe social i këtij projekti në: shoqëri, në Parkun Nacional të Mavrovës dhe në lumin Radikë, është krejtësisht negativ, ndërsa nga ana tjetër, përfitimet financiare nga prodhimtaria e energjisë elektrike (të cilat edhe ashtu janë shumë të vogla), nuk mund të krahasohen fare me impaktin negativ që bart ky projekt.

Mare parasysh vlerat aktuale të shitjes së energjisë elektrike në bursën evropiane (rreth 0.15 €/KWh) dhe sasinë e prodhimtarisë vjetore të HC "Guri i zi" prej reth 1.870.000,00 KWh, kalkulohet se përfitimi vjetor është rreth 280.000,00 euro, e kjo krahasuar më investimin prej rreth 83 milion euro, atëherë është e qartë se nuk ka leverdi ekonomike.

Për t'u realizuar projekti "Fusha e Llukovës", brenda parkut kombëtar Mavrovë, parashihet: ndërtimi i 4 rrugëve; 5 kaptazha (mini penda) për kapje të ujërave; tubacion prej 20 km prej të cilave 3 km përmes dy tuneleve; dhe ndërtimi i pendës duke bërë përmbytjen e një sipërfaqe të madhe - areal i një shumëllojshmërie të botës bimore e shtazore shumë të rrallë. Të gjitha këta intervenime inxhinerike brenda parkut, do të kenë ndikim ekologjik negativ, me rrezikim deri në zhdukje të shumë specieve endemike siç janë: pyje të paprekura qindravjeçare, lloje të ndryshme të bimëve endemike, disa lloje të kafshëve e posaçërisht Rrëqebulli i Balkanit, specie posaçërisht të rrezikuar, pasi parku kombëtar Mavrovë është habitati i fundit ku ai ka gjet kushtet e volitshme për shumim, (sot numërohen vetëm edhe rreth 40 familje të këtij lloji të familjes së maceve të egra), mbi 140 lloje të shpendëve, (prej të cilave disa janë nëpër regjistrat botërore si specieve të mbrojtura ndërkombëtarisht.

Bifurkacioni i ujërave të Radikës me sasi prej 8 m3 ujë/s, (vlerë oficiale nga dokumentet zyrtare te ELEM-it) dhe 6 m3 ujë/s, të fshehura (jo oficiale), ose total prej 14 m3 ujë/s, përbën rreth 66,67% të vlerës totale

Organizatat joqeveritare ekologjike nga Maqedonia, të bashkuara nën Platformën e përbashkët "Maqedonia e Gjelbërt"

Platforma "Maqedonia e gjelbër"

PREAMBULA

Ne, organizatat joqeveritare ekologjike nga Maqedonia, të bashkuara nën Platformën e përbashkët "Maqedonia e Gjelbërt":

- të shqetësuara për rrethin tonë dhe mjedisin jetësor në përgjithësi;
- të bashkuara rreth problemeve dhe sfidave të përbashkëta të cilat janë pjesë integrale e jetës së njeriut;
- të interesuara për prosperitetin ekonomik të vendit tonë, të bazuar në marrëdhënien dhe qëndrimet pozitive ndaj mjedisit dhe tiparet e tij të vlefshme;
- me bindje se me vullnet të përgjithshëm dhe përpjekje të përbashkëta do të arrijmë rezultate më të mira në mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit në kontekst të përpjekjeve për të zgjidhur problemet e nxehta ekologjike në vend.

Vizioni ynë është qëndrimi i përbashkët i të gjitha organizatave: KËRKOJMË nga TË GJITHA partitë politike të prononcohenlidhur me pikat/problemet dhe rekomandimet të cilat i theksuamsi problematike, e që janë pjesë e kësaj Platforme, si vijojnë:

1. Zgjidhja e ndotjes historike në Veles, si rezultat i ndotjes 30-vjeçare nga Shkritorja

REKOMANDIM:

- Nevojitet zhvendosja e mbeturinave të skories (zgjyrës) qëgjendet pas Shkritores në Veles, e cila paraqet një burim të ndotjes së vazhdueshme në qytet.

- Dekontaminimi i tokës në Veles – dozat e larta të metaleve të rënda në tokë paraqesin rrezik për banorët, veçanërisht për fëmijët të cilët më së shumi kanë kontakt me tokën e kontaminuar.

- Nevojitet ndërrimi i dheut nëpër çerdhet dhe shkollat ose dekontaminimi përmes procesit tëfitoremediacionit.

- Dekontaminimi me plan idheutnë të gjitha atosipërfaqe bujqësore rreth qytetit nëtë cilat prodhohen produkte bujqësore ushqimore.

2. Zgjidhja e problemit të ndotjes industriale nëKavadar, Tetovë, Shkup, Manastir dhe Kërçovë

REKOMANDIM:

- Është i nevojshëm kontroll i rregullt i emetimeve të gazrave të dëmshme nga kapacitetet industriale rreth komunave dhe qytetit të Shkupit. Të vihen në funksion të gjitha stacionet matëse ekzistuese si dhe të bëhet furnizimi me stacione të reja monitoruese të cilat do të ndjekin dhe paraqesin gjendjen reale të mjedisit jetësor.

- Të kufizohet puna e të gjitha kapaciteteve industriale të cilatrealisht nuk i plotësojnë standardet për A - lejen e integruar ekologjike.

- Të bëhet analizë e dheut dhe të ndërmerren masat për dekontaminimin e saj nëpër komunat dhe qytetin e Shkupit, si dhe në sipërfaqet bujqësore përreth kapaciteteve industriale.

3. Mbrojtja e parkut kombëtar të Mavrovës dhe lumit Radika

REKOMANDIM:

- Të respektohet qëndrimi i qytetarëve dhe organizatave joqeveritare, vendimet e marra nga Këshilli i Komunës së Dibrës, si dhe mendimet e më shumë se 100 ekspertëve botëror të cilët dorëzuan peticion nëQeverinë eRM-së;

- Të ndërpriten të gjitha aktivitetet ndërtimore në zonën e Parkut Kombëtar të Mavrovës të lidhura me ndërtimin e objekteve hidro-energjetike, veçanërisht "Fusha e Llukovës" dhe "Ura e Boshkut";

- Tëpërpilohet një ligj i ri për Parkun Kombëtar të Mavrovës, me të cilin do tërikthehet ndryshimi i kundërligjshëm i kategorizimit të zonave, respektivisht tërikthehet statusi - zonërreptësishtë e mbrojtur;

4. Zvogëlimi i prerjeve të pyjeve në Republikën e Maqedonisë

REKOMANDIM:

- Ndryshim dhe plotësim i Ligjit për pyjet;

- Të ndërmerren masa rigoroze kundër prerjes ilegale të fondit pyjor të Republikës së Maqedonisë;

- Mbikëqyrje rigoroze në prerjen legale dhe aplikim të mekanizmave për zvoglimin e keqpërdorimit të pyjeve nga ana e koçensionerëve të pyjeve;



- Stimulim të shfrytëzimit tëbio-mbetjev për ngrohje;

5. Ruajtja e liqeneve dhe biodiversitetit të tyre

6. Shpallja e Malit Sharr dhe masivit malor Mokra për park kombëtar

REKOMANDIM:

- Mbrojtja e biodiversitetit dhe monumenteve kulturore historike në malin Sharr,Jakupicë, Dauticë, Karaxhicë dhe Goleshnicë.

7. Dhënia prioritet themelimit dhe shpalljes së rrjetit ekologjik Natura 2000 në RM; Mbrojtja e diversitetit kulturor

8. Plotësimi i Ligjit për mjedisin jetësor,me të cilat do të ndalohej ndërtimin e kapaciteteve industriale në distancë më të vogël se 5 km nga vendbanimet dhe raritetnatyrore në vend.

9. Zvogëlimi ndotjes së lumit Vardar dhe degëve të tij

REKOMANDIM:

- Vendosja e menjëhershme e stacionit për pastrim në qytetin e Shkupit;

- Vendosja e stacioneve pastruese tek të gjithëndotësit potencial dhe emetuesit e mbeturinave organike dhe joorganike;

- Kontroll i rregullt dhe në kohë në rast tëkatastrofave ekologjike dhe dënime rigoroze për ndotësit e lumenjve në Republikën e Maqedonisë.

10. Përfundimisht zbatimi ligjeve për menaxhim me mbeturinat.

Në emër të Platformës "Maqedonia e gjelbër"

Lëvizja e ekologjistëve të Maqedonisë; Aleanca rinore - Tetovë; ShE Treska-Mak. Brod; ShELipa - Komanovë; 4x4x4 Urat balkanike - Shkup; KOR-Shkup; ShE Deshat - Dibër; ShE Ylberi – Shtip; GE ГринПауер-Veles; Global – Manastir; Koalicioni rural - Kumanovë; ORT – Shkup; Eko-svest - Shkup; ShE Natyra - Likovë; QVE - Tearcë; Grashnica - Ohër; ShE Biosfera - Manastir; RAC - Deçevë; ShE Eko-Jetë – Kavadar; ShEKalinka - Valandovë; ShEKladenec - Pehçevë; ShEZdravec 2002 – Makedonska Kamenica; Front 21/42; ShE Vila Zora – Veles.

Ruaj Radikën, për të ruajtur qenien tënde

(21 m3 ujë/s) me të cilën Radika sot duhet të disponojë. Pra, Radika si pasojë e devijimi të ujërave në "Fushë të Llukovës" do të varfërohet për së paku 66,66% më pak ujë, ujë i cili do shkojë në lumin Vardar për të përfunduar në detin Egje.

AKUMULIMI DHE HC "URA E BOSHKUT"

Hidro akumulimi "Ura e Boshkut" përfshin ndërtim të pendës me lartësi 33 m. në rrjedhën e epërme të "Lumit të vogël" (pranë Dibrës), kapje dhe devijim të ujërave të "Lumit të vogël" ("Mala reka") dhe disa përrenjve tjerë me tubacione (11,2 km.) dhe tunele (8.74 km) dhe devijimin e tyre në akumulim, hidrocentral me kapacitet 68 MW, përmbytje të një hapësire prej rreth 200 ha, prodhimtari vjetore prej 118 GWh, dhe investim prej 84 milion euro. Karakteristika kryesore e tij është se ky HC do të punojë vetëm rreth 5 orë në ditë dhe atë gjatë periudhës së kërkesës maksimale ditore për energji dhe e tërë prodhimtaria është e dedikuar për eksport. Gjatë atyre 5 orë prodhimtari, nga penda do rrjedhin 22 m3 ujë/s, ndërsa gjatë periudhës tjetër lumi i vogël do të ketë një sasi shumë të vogël të ujit, e cila do pasojë më përmbytje të rrufeshme 5 orëshe për çdo ditë.

PASOJAT NGA NDËRTIMI I PENDËS DHE HC "URA E BOSHKUT

Njëjtë si me projektin Fusha e Llukovës, edhe këtu kemi të bëjmë me impakt negativ ekonomik, ekologjik dhe social.

Njëjtë si në rastin e projektit "Fusha e Llukovës", projekti nuk ka leverdi ekonomike, pasi prodhimtaria e energjisë elektrike është shumë e vogël, do ketë prodhimtari vetëm 5 orë në ditë, dhe ajo energji është e dedikuar për eksport, që do të thotë nuk do ketë asnjë impakt në zvogëlim të nevojave për energji elektrike në Maqedoni, pra qëllimi ndërtimit është vetëm leverdia financiare e kompanisë ELEM përmes parave popullore.

Ndikimet negative ekologjike nga realizimi i këtij projekti janë të shumta: prishje e ekosistemit të parkut si rezultat i ndërtimeve inxhinerike në kufijtë e parkut nacional të Mavrovës (zonë e mbrojtur me ligj); dëmtim/prishje të ekosistemit të shumë bimëve endemike, shtazëve dhe shpendëve të cilat duke jua prish ekosistemin detyrohen të largohen në zona tjera; ndikim të drejtë për drejtë në ekosistemin ujor të "Lumit të vogël" dhe "Radikës" (posaçërisht ndaj troftës së njohur të Radikës dhe peshqve tjerë) përmes zvogëlimit të sasisë së ujit në këta dy lumenj; ndërsa rreziku më i madh vjen nga përmbytja dhe shpëlarja e bregut të "Lumit të vogël" gjatë periudhës 5 orëshe të funksionimit të centralit.

Ky projekt gjithashtu do ketë ndikim negativ edhe në rrjedhën e Radikës, duke e zvogëluar dhe çrregulluar sasinë me të cilën furnizohet sot Radika dhe liqeni i Dibrës, pasi Lumi i vogël është gjithashtu njëra nga degët e cila e furnizon sot Radikën.

Ndikimi negativ ekologjik dhe social i projekteve "Fusha e Llukovës" dhe "Ura e Boshkut" për liqenin e Dibrës, për Dibrën dhe rajonin e Rekës

Ndikimet e këtyre dy projekteve për liqenin e Dibrës, për dibranët dhe për rekasit, nuk mund të jenë përveç se kryekëput NEGATIVE. Do përmendim vetëm më të rëndësishmet:

Radika për liqenin e Dibrës është arteria kryesore e cila e furnizon atë me ushqim dhe ujë të pastërt. Pa Radikën liqeni i Dibrës për një periudhë të shkurtë do të shndërrohet në një kënetë gjigante e mbuluar me alga si rezultat i ndotjeve që vinë nga Ohri dhe Struga (si rezultat i mosfunksionimit të qendrës për pastrim të ujërave fekale në Vranishtë të Strugës), nga ndotjet/derdhjet fekale direkte nga fshatrat përgjatë rrjedhës së Drinin e Zi (përfshi këtu edhe ndotjet fekalet nga fshatrat e komunës Zhupë).

Zvogëlimi e sasisë së ujit të Radikës, me rrezik potencial deri në tharjen e saj, (po qoftë ajo e përkohshme apo vetëm sezonale), shkakton pasoja shkatërruese ekologjike për liqenin e Dibrës, por në të njëjtën kohë edhe reaksione sociologjike si rezultat i lidhjes emocionale që kanë banorët e Dibrës dhe zonës së Rekës me Radikën.

Problemet e këtilla ekologjike të zvogëlimin i sasisë së ujit të Radikës dhe liqenit të Dibrës, gjithashtu do të shuajë edhe ëndrrën dibrane për shfrytëzim të ujit të liqenit për vaditje të fushës së Dibrës apo për shfrytëzim të ujit të liqenit për nevoja teknologjike.

MBI TË GJITHA RADIKA KA VLERË HISTORIKE DHE SOCILOLGJIKE PËR TËRË ZONËN.

AS DIBRANËT E AS BANORËT E REKËS KUR NUK DO TË PAJTOHEN ME HUMBJEN E RADIKËS.



NJOFTIM PUBLIK

Ne, intelektualët dibranë, që iniciuam peticionin për Rrugën e Arbërit më 18 Mars 2013, do të organizojmë një numër veprimtarish në disa zona të Shqipërisë nga data 4-9 Maj 2014, në kuadrin e lobimit që po bëjmë për të sensibilizuar opinionin publik për rëndësinë lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare të kësaj vepre.

Aktivitetin e parë do ta organizojmë në Peshkopi më 5 maj në orën 11:00 te QEK (Qendra e Edukimit dhe Komunikimit, Pallati i Kulturës).

Aktivitet tona në Tiranë do të zhvillohen nga data 6-8 Maj.

Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë se gjatë qëndrimit në Tiranë ne do të pritemi nga Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani, Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, dhe Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës z. Edmond Haxhinasto. Po kështu, në Tiranë do t'ju japim intervista disa nga televizioneve më kryesore në vend.

Qëllimi kryesor i vizitës tonë në Shqipëri është që t'i dorëzojmë formalisht peticionin z. Edi Rama në përputhje me premtimin që bëmë para zgjedhjeve. Gjatë qëndrimit tonë në atdhe shpresojmë të dëgjojmë nga Zyra e Kryeministrit në lidhje me kërkesën që kemi bërë për një takim me z. Rama.

Në takimet me drejtues të shtetit ne do të theksojmë:

- se peticioni, i cili deri tani është nënshkruar nga mbi 6000 njerëz online dhe në letër, nuk duhet shikuar si një nismë një-vjeçare, por si një etapë e re në përpjekjet e intelektualëve dibranë, të cilët për afro 20 vjet, po theksojnë se ndërtimi i Rrugës së Arbërit do të mundësojë fillimin e rimëkëmbjes ekonomike të Dibrës;
- se ky do të mbetet deri në fund një peticion jo politik
- rëndësinë e depolitizmit të çështjes së Rrugës së Arbërit.

Një veprimtari e rëndësishme që do të organizojmë në Tiranë është edhe Tryeza e Rrumbullakët për Dibrën. Të ftuar në këtë veprimtari janë 6 deputetët e Dibrës si dhe një numër deputetësh me origjinë dibrane nga i gjithë spektri politik, drejtues të shoqatave dibrane në Tiranë dhe Dibër të Madhe, përfaqësues të pushtetit lokal në Bulqizë dhe Peshkopi, aktivistë të shoqërisë civile në Tiranë, si dhe përfaqësues të mediave qendrore në Tiranë, Prishtinë dhe të mediave në diasporë.

Në emër të kolegëve të mi, kam kënaqësinë t'ju ftoj të merrni pjesë në Tryezën e Rrumbullakët që do të zhvillohet ditën e Mërkurë, më 7 Maj 2014, nga ora 15:00-16:00 në Librarinë "Tirana Times", Salla "Europa", në Rrugën "Andon Zako Çajupi", ngjitur me shkollën "Edith Durham" (ish-"11 Janari").

Tryeza a Rrumbullakët fillon në orën 15:00 dhe përfundon në orën 16:00, një orë para dhe një orë pas kësaj veprimtarie ne do të jemi të gatshëm të bisedojmë me përfaqësuesit e mediave që do të ndjekin aktivitetin.

Së fundi, dëshirojmë të theksojmë se Tryeza e Rrumbullakët do të përqendrohet vetëm në çështjen e Rrugës së Arbërit dhe peticionin për të. Shprehim bindjen se ky aktivitet është një rast shumë i mirë për të shkëmbyer mendime se si kjo vepër e rëndësishme të përfundojë sa më shpejt dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Ju lutem na njoftoni nëse do të jeni në gjendje që të merrni pjesë në këto veprimtari duke i dërguar një mesazh në kontaktet e mëposhtme:

E-mail: **rrugaearberit@gmail.com**

SMS në tel: **068 65 08 441**

cyan magenta yellow black